



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Vlerësimi i shtyllës së kapitalit njerëzor të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim të Kosovës (2016-2021)

Komisionuar nga:
Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS)
e Zyrës së Kryeministrit (ZKM) dhe UNICEF

RAPORTI I VLERËSIMIT

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-------------------------------------|
| PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE | V |
| 1.0 HYRJE | 1 |
| PËRSHKRIMI I KONTEKSTIT | 1 |
| SUBJEKTI I VLERËSIMIT: SKZH 2016-2021 | 5 |
| 2.0 TIPARET E VLERËSIMIT | 10 |
| QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E VLERËSIMIT | 10 |
| PYETJET E VLERËSIMIT TË TER | 11 |
| METODOLOGJIA E VLERËSIMIT | 13 |
| 3.0 GJETJET E VLERËSIMIT | 15 |
| VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM | 15 |
| RËNDËSIA..... | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| EFEKTIVITETI DHE NDRYSHIMI AFATGJATË | 20 |
| PERFORMANCA E MASAVE DHE AKTIVITETEVE | 20 |
| KONTRIBUTET KOMBËTARE..... | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| EFIKASITETI | 29 |
| SINERGJIA ME KORNIZAT E JASHTME..... | 31 |
| QËNDRUESHMËRIA ME KORNIZAT E BRENDSHME..... | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| PENGESAT E QËNDRUESHMËRISË | 33 |
| 4.0 PËRFUNDIMET | 35 |
| VËZHGIMET KRYESORE | 35 |
| MËSIMET E NXJERRA | 37 |
| 5.0 REKOMANDIMET | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| 6.0 SHTOJCAT | 43 |
| SHTOJCA 1: TERMAT E REFERENCËS | 43 |
| SHTOJCA 2: BIBLIOGRAFIA | 57 |
| SHTOJCA 3: PËRMBLEDHJA E SKZH-SË TË KOSOVËS | 62 |
| SHTOJCA 4: ARRITJET E AKTIVITETIT TË SKZH-SË | 71 |
| SHTOJCA 5: MATRICA E VLERËSIMIT | 88 |
| SHTOJCA 6: METODOLOGJIA | 96 |
| SHTOJCA 7: MJETET PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE | 110 |
| SHTOJCA 8: ANALIZA E AKTERËVE | 126 |
| SHTOJCA 9: PERSONAT E INTERVISTUAR | 1 |
| SHTOJCA 10: GRUPI REFERUES I VLERËSIMIT..... | 3 |

LISTA E TABELAVE

| | |
|--|-------------------------------------|
| TABELA 1: STATISTIKAT KRYESORE TË VËSHTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS | 2 |
| TABELA 2: KOSTIMI I SKZH-SË PËR SHTYLLË..... | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| TABELA 3: MASAT E SHTYLLËS SË KAPITALIT NJERËZOR..... | 8 |
| TABELA 4: PERFORMANCA TREGUESVE MAKRO TË SKZH-SË..... | 8 |
| TABELA 5: PIKETAT E RËNDËSISHME NË SKZH 2016-2021 | 9 |
| TABELA 6: NËNPTYETJET E TeR SIPAS DIMENSIONIT | 12 |
| TABELA 7: PËRMBLEDHJE E PUNËTORIVE MËSIMORE | 13 |
| TABELA 8: MASAT E SKZH-SË - PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATEVE | ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED. |
| TABELA 9: AKTIVITETET E SKZH-SË – PROGRESI I TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS | 21 |
| TABELA 10: NDIKIMI I SKZH-SË - PROGRESI I TREGUESVE MAKRO | 27 |
| TABELA 11: REKOMANDIMET | 39 |

LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|-------|--|
| ADAP | Programi për Zhvillimin dhe Pjesëmarrjen e Adoloshentëve |
| UA | Udhëzim Administrativ |
| MF | Mbrojtja e Fëmijëve |
| KDF | Konventa për të Drejtat e Fëmijëve |
| MDF | Monitorimi i të Drejtave të Fëmijëve |
| KDPAK | Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara |
| OShC | Organizata e Shoqërisë Civile |
| ECARO | Zyra Rajonale e Evropës dhe Azisë Qendrore (UNICEF) |
| ZhFH | Zhvillimi në Fëmijëri të Hershme |
| MV | Menaxher i Vlerësimit |
| SMIA | Sistemi i Menaxhimit të Informatave të Arsimit |
| ARE | Agjenda e Reformës Evropiane |
| GRV | Grupi Referues i Vlerësimit |
| EV | Ekipi i Vlerësimit |
| BE | Bashkimi Evropian |
| IHD | Investim i huaj direkt |
| FDMC | Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multi-etnik |
| BPV | Bruto Produkti Vendor |
| GFCF | Formimi Bruto i Kapitalit Fiks |
| KNj | Kapitali njerëzor |
| IKNj | Indeksi i Kapitalit Njerëzor |
| IZhNj | Indeksi i Zhvillimit Njerëzor |
| SMIAL | Sistemi i Menaxhimit të Informatave të Arsimit të Lartë |
| PAA | Programi i Angazhimit në Atdhe |
| MF | Misioni fillestar |
| RF | Raporti fillestar |
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| QAK | Qendra Arsimore e Kosovës |
| IİK | Intervistë me Informatorë Kyç |
| TKP | Tregues Kyç të Performancës |
| AFP | Anketa e Fuqisë Punëtore |
| IP | Inspektorati i Punës |
| M&V | Monitorimi & Vlerësimi |
| MDIAS | Ministria e Diasporës |
| MASHT | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë |
| MICS | Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishhtë |
| MPMS | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale |
| MF | Ministria e Financave |
| MPJ | Ministria e Punëve të Jashtme |
| MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MSPM | Ministria e Sigurisë Publike dhe Menaxhimit |
| KASH | Korniza Afatmesme e Shpenzimeve |
| MRKS | Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit |
| OJQ | Organizata joqeveritare |
| SKZH | Strategjia Kombëtare e Zhvillimit |
| ZQM | Zyra për Qeverisje të Mirë |
| ZKM | Zyra e Kryeministrit |
| OSBE | Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë |
| PISA | Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve |
| PRIS | Sistemi i Informacionit Gjyqësor |
| RBM | Menaxhimi i bazuar në rezultate |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizim Asociimit |

| | |
|--------|--|
| SADD | Të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe moshës |
| OZHQ | Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm |
| KSE | Këshilli Socio-Ekonomik |
| ZPS | Zyra e Planifikimit Strategjik |
| TOC | Teoria e Ndryshimit |
| ZhPM | Zhvillimi profesional i mësimeve të mësimdhënësve |
| VPM | Vlerësimi i performancës së mësimeve të mësimdhënësve |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| UNDP | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim |
| UNHCR | Komseriati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët |
| UNICEF | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët |
| AAP | Arsimi dhe Aftësimi Profesional |
| QAP | Qendrat e Aftësimit Profesional |

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. Ky Raport mbi Vlerësimin është për vlerësimin e fundit të ciklit të Shtyllës së Kapitalit Njerëzor¹ të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim të Kosovës 2016-2021 (KNj1 e SKZH-së). Ky vlerësim është komisionuar nga Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) të Kosovës dhe mbështetet nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë dhe do të mbulojë periudhën nga 2016-2021. Koha e realizimit të këtij vlerësimi synon të informojë Institucionet e Kosovës dhe Zyrën e Kryeministrit si dhe palët e tjera të interesit mbi progresin e SKZH KNj1, mësimet e nxjerra si dhe të paraqesë rekomandime për informimin e dizajnimin dhe zhvillimit të ciklit të ardhshëm të SKZH (2022 -2030) KNj1.
2. Përdoruesit e pritur të këtij vlerësimi janë ZPS/ZKM, qeveria e Kosovës dhe partnerë të tjerë të lidhur me rregullimet në zbatimin dhe/ose përgatitjen e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së, dhe për mbështetjen e diskutimeve me palët e interesit në lidhje me përpunimin e SKZH-së së ardhshme për Kosovën. Vlerësimi do të shërbejë gjithashtu për t'i informuar Qeverinë e Kosovës dhe një sërë ministrish, departamentesh dhe zyrash, Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, donatorët dhe OSHC-të mbi mësimet e nxjerra nga KNj1 e SKZH-së dhe për të paraqitur rekomandime për SKZH-në e ardhshme bazuar në gjetjet thelbësore.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit

3. Qeveria e Kosovës zhvilloi SKZH-në e saj të parë, e cila shërben si dokument strategjik për të gjithë planifikimet në Kosovë, në vitin 2016. SKZH synoi të zhvillonte një listë të prioriteteve sipas një strategjie ombrellë që do lejonte krijimin e sinergjive mes iniciativave, do të parandalonte mbivendosjen institucionale si dhe do kishte efikasitet më të lartë të performancës, do të orientonte mbështetjen e partnerëve zhvillimor dhe krijonte një bazë për llogaridhënien publike. SKZH-ja është e organizuar në katër shtylla tematike: kapitalin njerëzor, qeverisjen e mirë, zhvillimin industrial dhe zhvillimin infrastrukturor. Si shtesë e SKZH-së, udhërrëfyesi i SKZH-së, i përgatitur në vitin 2017, përshkroi një plan zbatimi më të detajuar i cili përfshinte koston si dhe treguesit e zbatimit dhe aktivitetit.
4. Shtylla e Kapitalit Njerëzor, që është fokusi i këtij vlerësimi, vendos theks të lartë mbi masat që kërkojnë të forcojnë sistemin arsimor si dhe të forcojnë lidhjen dhe zbatueshmërinë e tij me tregun e punës dhe ekonominë. Këto janë artikuluar përmes shtatë masave të veçanta dhe 32 aktiviteteve të ndërlidhura. Shtylla është e orientuar rreth promovimit, krijimit dhe mbajtjes së një fuqie punëtore produktive, të aftë dhe inovatore. Logjika prapa kësaj është se ky është një faktor përcaktues për zhvillimin e suksesshëm kombëtar. Kjo bazohet në supozimet se gjersa fuqia punëtore përvetëson aftësi më të larta, do të ketë një rritje pasuese të të ardhurave dhe përmirësim të përgjithshëm në ekonomi. Aftësitë nuk përcaktohen vetëm si aftësi teknike, por përfshijnë edhe aftësi njohëse të tilla si logjika dhe arsyetimi, si dhe aftësitë “e buta” siç janë aftësitë ose vlerat ndërpersonale. Ndërtimi i këtyre aftësive shihet si shumë i lidhur me sistemin arsimor dhe cilësinë e arsimit të ofruar para hyrjes në tregun e punës, megjithëse rritja e aftësive të tregut të punës mund të vijë edhe nga migrimi në mjedis të tjera dhe “fitimi i trurit” (*ang. Brain gain*) nga të kthyerit nga diaspora.
5. Palët kryesore të interesit të përfshira në zbatimin e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së përfshijnë tri ministri kryesore si dhe një sërë institucionesh mbështetëse. Ministrinë kryesore ishin Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Diasporës.²

¹ Për qëllimet e këtij vlerësimi, Kapitali Njerëzor është përcaktuar të jetë koleksion i aftësive, njohurive dhe përvojës në një popullatë dhe shihet në aspektin e kontributit dhe vlerës së tij në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

² Këto ministri janë ristrukturuar në vitin 2020 si pjesë e një reforme të përgjithshme ministrore. Titujt këtu i referohen titujve që nga koha e projektimit.

Metodologjia

6. Vlerësimi ka përdorur qasje mikse të metodave, duke u mbështetur në dokumentacionin ekzistues, të dhënat sasiore ekzistuese dhe në kombinim me intervistat cilësore me palët kryesore të interesit. Në total janë intervistuar 56 persona (65 përqind gra). Gjatë vlerësimit, që përfaqësojnë një përzierje të përfaqësuesve të qeverisë, OKB-së, donatorëve dhe anëtarëve të shoqërisë civile. Përveç kësaj, janë shqyrtuar më shumë se 100 dokumente të cilat u vunë në dispozicion nga ZPS dhe ministritë përkatëse të qeverisë.
7. Ekipi i vlerësimit përbëhej nga dy vlerësues. Ekipi i vlerësimit po ashtu përcillej nga gjashtë studentë vullnetarë për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve dhe ngritjen e kapaciteteve për të rinjtë. Studentët vullnetarë morën pjesë në intervistat virtuale, duke mbështetur ekipin vlerësues (EV) me marrje të shënimeve për analizën e të dhënave dhe duke shkruar përshtypjet dhe mendimet e tyre mbi programin dhe procesin e vlerësimit të UNICEF. Vullnetarët e rinj gjithashtu morën pjesë në sesionet e debriefimit dhe ushtrimet e analizës së të dhënave dhe ndihmuan në ndërtimin e përfundimeve dhe rekomandimeve për vlerësimin.
8. Qasja e vlerësimit u desh të rregullohej për të marrë parasysh pandeminë COVID-19 dhe kufizimet në udhëtim. Këto kufizime nënkuptonin që vlerësimi kaloi në qasje plotësisht në distancë, ku të gjitha intervistat kryheshin përmes platformave virtuale. Gjatë fazës fillestare të projektit dhe fazës fillestare të mbledhjes së të dhënave u zhvilluan tri punëtori të mësimit me prezencë fizike, duke përfshirë një trajnim fillestar mbi parimet e vlerësimit dhe aplikimit të tyre për qeveri me ZPS-në, një prezantim të gjetjeve paraprake dhe rekomandimeve në punëtori me përfaqësues nga ZKM, dhe një prezantim për Grupin Referencë të Vlerësimit (GRV).

Gjetjet

9. **Relevanca.** Procesi i dizajnit të KNj1 të SKZH-së ishte rigoroz dhe i bazuar në dëshmi. Prioritetet e identifikuar në KNj1 të SKZH-së janë relevante, megjithëse mund të mos jenë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha nevojat për zhvillim. KNj1 e SKZH-së ka potencialin të shërbejë si instrument i rëndësishëm afatmesëm ndërmjet mandateve dhe mund të sigurojë mekanizëm të rëndësishëm për orientimin drejt kornizave të jashtme si OZHQ-të dhe agjenda e anëtarësimit në BE (i quajtur Programi për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (SAA)).
10. Në aspektin e sfidave, aktivitetet dhe masat në KNj1 të SKZH-së fokusohen pothuajse ekskluzivisht në aspiratat e rritjes ekonomike përmes forcimit të arsimit dhe rritjes së punësimit. Konsiderata të tjera të mirëqenies si shëndeti, kultura ose kohezioni social nuk janë të pranishme. Përfundimisht, orientimi i fortë drejt rritjes ekonomike i KNj1 të SKZH-së kufizon shkallën në të cilën mund të merren parasysh temat transversale të mundësive të barabarta dhe rrjedhimisht konsideratat gjinore dhe të qasjes nuk janë shumë të dukshme në KNj1 të SKZH-së dhe kjo paraqet një hendek kritik.
11. **Efektiviteti:** Është shënuar progres në aspektin e masave dhe aktiviteteve, por ka pasur shtrirje më të ulët se sa ishte parashikuar sipas objektivave të përcaktuara. Nga 101 TKP, 23 kanë pasur përparim të mirë ose kanë përfunduar, 30 kanë pasur njëfarë progresi ndërsa 48 janë vlerësuar si me progres të kufizuar ose ende pa progres. Masat dhe aktivitetet që kanë shkallën më të lartë të suksesit janë ato që kanë marrë resurse nga mbështetja e donatorëve.
12. Shkalla e implementimit e masave që tërhoqën projekte të konsiderueshme të financuara nga donatorët ishte më e lartë se e atyre që mbështeteshin më gjerësisht në financimin e qeverisë për tri arsye. Së pari, projektet e financuara nga donatorët prireshin të kishin procese të ndara planifikimi duke përfshirë zhvillimin e objektivave, përcaktimin e përgjegjësive specifike për zbatimin dhe zhvillimin e një afati kohor të strukturuar për zbatim. Së dyti, projektet e financuara nga donatorët në kuadër të masave kishin kornizë specifike burimesh ku fondet

për aktivitetet e projektit alokoheshin dhe destinoheshin për përdorim specifik edhe nëse vinin nga qeveria. Së fundi, proceset e raportimit ishin të rregullta, të fokusuara në mënyrë specifike në aktivitetet e përshkruara të projektit, me faktorë të ofruar për çfarëdo vonesa në zbatim.

13. Treguesit ekonomikë të nivelit makro janë përmirësuar në mënyrë modeste që nga viti 2016, megjithatë kontributet e KNj1 të SKZH-së në ato ka të ngjarë të kenë qenë minimale për shkak të niveleve relativisht të ulëta të përfundimit të aktiviteteve si dhe faktit që ka rënie të treguesve në nivel të rezultateve për masat përkatëse. Nëse në pothuajse gjysmën e të gjithë TKP-ve raportohet se nuk ka pasur progres fare dhe nëse treguesit në nivelin e masave ekzistojnë për KNj1 të SKZH-së priren të tregojnë rënie nga 2015 me gjithë faktin se treguesit e nivelit makro tregojnë ngritje, atëherë është e arsyeshme të supozohet se progresi modest i nivelit makro po mbështetet nga burime të tjera përveç aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së në vetvete.
14. **Efikasiteti:** Aktualisht nuk është e mundur t'i përgjigjemi pyetjes së vlerësimit të TeR-ve mbi atë se si janë përdorur burimet financiare për zbatimin e KNj1 të SKZH-së për shkak të strukturës së procesit të buxhetimit dhe shpërndarjes së burimeve. Plani i veprimit i KNj1 të SKZH-së në vitin 2017 ka bërë vlerësim të kostos të zberthyer në nivelin e aktiviteteve duke përfshirë përshkrimin se cila përqindje e kostove do të vinte nga qeveria e Kosovës dhe cila përqindje e kostove do të vinte nga kontributet e donatorëve. Megjithatë, mënyra se si janë regjistruar burimet financiare në raportimin ministror nuk identifikon alokimet e burimeve nga aktiviteti i KNj1 të SKZH-së. Planet sektoriale të punës zberthejnë alokimet sipas dimensioneve të tjera.
15. Bazuar në provat në dispozicion, alokimet për aktivitetet e KNj1 të SKZH-së nuk ishin në proporcion me vlerësimet e kostos në planin e veprimit të KNj1 të SKZH-së dhe aktivitetet e SKZH-së prireshin të mos merrnin prioritet gjatë buxhetimit. Masat e KNj1 të SKZH-së nuk ishin të harmonizuara mjaftueshëm me alokimet buxhetare të lidhura me ligjin e buxhetit dhe ministritë nuk ishin të detyruara të ndajnë fonde për aktivitetet e KNj1 të SKZH-së, edhe pse kjo ishte kërkuar nga ZPS/ZKM. Ndërsa disa nga buxhetet ministrore ishin të lidhura me aktivitetet e KNj1 të SKZH-së, nuk kishte asnjë kërkesë të brendshme në qeveri që aktivitetet e identifikuar të KNj1 të SKZH-së të kishin prioritet në financim. Si pasojë, progresi i aktivitetit të KNj1 të SKZH-së ka shumë përputhje me zotimet vullnetare – veçanërisht zotimet e donatorëve.
16. **Qëndrueshmëria:** në kuadër të politikave vlerësimi fokusohet në dy dimensione: 1) Deri në çfarë shkalle mund të mbështetet vetë KNj1 e SKZH-së në kuadër të proceseve dhe kornizave të qeverisjes? dhe 2) deri në çfarë shkalle mund të mbahen në të ardhmen rezultatet që janë arritur në ciklin e kaluar të SKZH-së.
17. Për komponentin e parë, qëndrueshmëria do të përfshinte shkallën në të cilën KNj1 e SKZH-së është e integruar me kornizat e jashtme dhe të brendshme (sinergjitë), duke përfshirë shkallën në të cilën KNj1 e SKZH-së është e përafuar dhe integruar në proceset dhe mekanizmat ekzistues të qeverisë. Krahasuar me rishikimin afatmesëm të vitit 2018, performanca e KNj1 të SKZH-së gjatë gjysmës së dytë të ciklit ka pësuar rënie në vitet pasuese. Kjo është për shkak se KNj1 e SKZH-së nuk është integruar mirë në proceset e tjera qeveritare, gjë që zvogëlon shkallën e rëndësisë që KNj1 e SKZH-së ka në formësimin e politikave, strategjive dhe zbatimin e planeve të punës së qeverisë dhe orientimit të prioriteteve të qeverisë. Gjithashtu, ndërrimet e qeverisë janë rritur gjatë periudhës së SKZH-së, me katër qeveri të ndryshme që kanë marrë pushtetin që nga fillimi i SKZH-së.
18. Komponenti i dytë merr parasysh shkallën në të cilën mund të mbahen rezultatet e SKZH-së. Qëndrueshmëria e rezultateve në rastin e KNj1 të SKZH-së do të përfshinte tri nivele: i) se a ekziston kornizë ligjore ose rregullatore e mjaftueshme; ii) se a ka sisteme, procese ose asete të mjaftueshme të zhvilluara; dhe iii) se a ka zhvillim të mjaftueshëm të kapaciteteve teknike

njerëzore në lidhje me sistemet, proceset ose asetet duke përfshirë kontraktimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore.

19. Për KNj1 të SKZH-së në përgjithësi, normat e arritjeve në çdo nivel kanë qenë relativisht të ulëta. Gjatë gjithë aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së, janë arritur 28 për qind e aktiviteteve të renditura të nivelit 1 (ligje dhe rregullore). Aktivitetet e nivelit 2 patën shkallë të ngjashme arritjeje (24% e arritur ose me progres të mirë) në lidhje me themelimin e qendrave apo infrastrukturën e ndërtesave apo sistemeve. Shkalla më e ulët e arritjes ishte tek ato aktivitete të lidhura me trajnime ose me kontraktim të njerëzve (15%). Kjo është konfirmuar edhe nga vëzhgimet e palëve të interesit në intervista.
20. Implikimet për qëndrueshmërinë e rezultateve janë se rezultatet e SKZH KNj1 nuk ka të ngjarë të jenë në gjendje të qëndrojnë. Përfitimet më të mëdha kanë qenë në themelet e krijuara nga krijimi i projektligjeve dhe rregulloreve të nevojshme dhe fillimi i krijimit të sistemeve dhe asetëve që shoqërojnë masat. Megjithatë, mbetet më shumë për t'u bërë në drejtim të trajnimit dhe kontraktimit të njerëzve – për të ndërtuar kapacitetet e nevojshme teknike – për t'i menaxhuar asetet ose për t'i zbatuar ligjet.

Konkluzione dhe Rekomandime

21. Bazuar në modelet e gjetjeve, disa vëzhgime kryesore dallohen si të rëndësishme në lidhje me të KNj1 të SKZH-së së parë për Kosovë dhe implikimet për procesin e ardhshëm të projektimit.
22. **Ndërtimi mbi arritjet e KNj1 të SKZH-së ekzistuese.** Edhe pse më i ngadalshëm nga sa ishte parashikuar, ka pasur përparim drejt një numri masash dhe aktivitetesh të SKZH-së aktuale. KNj1 e SKZH-së e re duhet të përfshijë një rishikim të progreseve kryesore të deritanishme në masat përkatëse duke përfshirë një pasqyrë të gjendjes së progresit për secilën masë.
23. **Riformulimi i KNj1 të SKZH-së drejt një orientimi më strategjik të zhvillimit njerëzor.** Kjo përfshin ristrukturimin e arkitekturës së KNj1 të SKZH-së drejt një "strategjie të strategjive" dhe jo "prioritizimi të prioriteteve". Riorientimi i KNj1 të SKZH-së drejt zhvillimit njerëzor dhe jo ekskluzivisht në kapitalin njerëzor. Për shkak se një strategji kombëtare zhvillimi duhet t'i përfshijë të gjitha aspektet që lidhen me cilësinë e jetës për qytetarët, strategjia duhet të përfshijë më shumë sesa rritjen ekonomike. KNj1 e SKZH-së duhet të mbajë një fushëveprim shumëvjeçar për tejkalimin e mandateve dhe duhet të vazhdojë të jetë e përafëruar me agjendat për vitin 2030 të BE-së dhe OZHQ-ve. Strategjia duhet t'i integrojë prioritetet transversale të barazisë gjinore, mundësive të barabarta, qasjes dhe qëndrueshmërisë mjedisore në mënyrë më të dukshme (vizibile) në të gjitha shtyllat, masat dhe aktivitetet.
24. **Integrimi i KNj1 të SKZH-së më afër në sistemet ekzistuese qeveritare.** Kjo përfshin sigurimin e integritetit të strategjive sektoriale dhe planeve të punës të KNj1 të SKZH-së përmes një mekanizmi më të fortë të kontrollit. Krijimi i Udhëzimeve Administrative për Departamentin e Buxhetit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) mbi opinionet e kostos së KNj1 të SKZH-së dhe prioritizimin e burimeve dhe rishikimi i ligjit të buxhetit për qëllime të shpjegimit të roleve dhe përgjegjësi në departamentet buxhetore të ministrive. Për fund, të konsiderohet krijimi i Udhëzimeve Administrative nga Ministria e Pushtetit Lokal drejtuar Komunave për prioritizimin e buxhetimit për aktivitetet e KNj1 të SKZH-së në nivel komunal.
25. **Rritja e mekanizmave për llogaridhënie dhe raportim kundrejt KNj1 të SKZH-së.** Kjo përfshin zhvillimin e sistemeve për përcjelljen e progresit kundrejt aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së duke përfshirë raportimin mbi përfundimin e aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së në planet e punës së Ministrive. Zhvillimi i modeleve (shablloneve) të monitorimit dhe raportimit që zbërthejnë arritjet dhe shpenzimet sipas masave dhe aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së të cilat

do të duhet të ndaheshin me ZKM dhe Kuvendin në baza vjetore. Rritja e harmonizimit të të dhënave ekzistuese të menaxhimit përmes lidhjes së bazave të të dhënave dhe rritjes së shkëmbimit të të dhënave midis ministrive dhe departamenteve. Rritja e monitorimit publik të KNj1 të SKZH-së përmes publikimit të të dhënave të papërpunuara për panelet (dashboards) publike.

26. **Sistematizimi i pronësisë politike të nivelit të lartë të KNj1 të SKZH-së.** KNj1 e SKZH-së aktualisht është shumë e varur nga motivimet individuale të cilat mund të luhaten gjatë tranzicioneve qeveritare. Vullneti politik për mbështetjen e KNj1 të SKZH-së duhet të forcohet përmes sistematizimit të pronësisë së KNj1 të SKZH-së duke përfshirë përfaqësimin e gjerë politik në nivele mbikëqyrëse dhe menaxheriale përtej ZKM-së dhe ZPS-së. Një mënyrë për ta bërë këtë do të ishte përmes formimit të një Komiteti të zgjeruar Drejtues të KNj1 të SKZH-së, me përbërje të kombinuar të përfaqësuesve të ZKM-së dhe Kuvendit, duke përfshirë edhe shoqërinë civile, për të ndërtuar rritjen e llogaridhënies së jashtme dhe pronësinë e SKZH-së. Ky komitet do të duhej të kishte mandat për rishikimin vjetor të progresit të KNj1 të SKZH-së. Përveç mekanizmave të kontrollit të përmendur më parë, kjo mund të përfshijë fuqizimin e ZPS për koordinim me organet e tjera qeveritare përgjegjëse për shpjegimin e planeve të punës së qeverisë dhe alokimit e burimeve për të pasur zbatim më të madh të aktiviteteve dhe masave të KNj1 të SKZH-së në alokimit e burimeve nga ana e qeverisë, në planet e punës dhe në raportim.

27. Rekomandimet:³

28. Rekomandimet e mëposhtme fokusohen vetëm në shtyllën KNj1 pasi ky është fokusi i vlerësimit. Megjithatë, rekomandimet e përgjithshme do të kishin rëndësi edhe për informimin e SKZH-së në përgjithësi.

Rekomandimi 1: Rishikimi i Progresit të Masave të KNj1 të SKZH-së. ZPS/ZKM duhet të mbështet një proces rishikimi në hartimin e KNj1 të SKZH-së së re që përshkruan piketat ekzistuese të arritura në secilën masë dhe identifikon se cilët hapa të radhës kërkohen në secilën masë. Kjo mund të jetë pjesë e një analize SWOT për hartimin e SKZH-së së ardhshme por gjithashtu mund të bazohet në të dhënat e ofruara në këtë raport vlerësimi.

Rekomandimi 2: Arkitektura e Strategjisë së Strategjive. ZPS/ZKM duhet të riorientojë fokusin e KNj1 të SKZH-së drejt theksimit të KNj1 të SKZH-së si busull strategjike për qëllime të orientimit të strategjive të tjera sektoriale.

Rekomandimi 3: Orientimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm. ZPS/ZKM duhet të riorientojë fokusin e KNj1 të SKZH-së jo vetëm drejt rritjes ekonomike por edhe drejt përfshirjes së një agjende zhvillimi më tërësore që vizibilizon elementet e qëndrueshmërisë dhe mirëqenies.

Rekomandimi 4: Përafrimi i Kornizave të Jashtme. ZPS/ZKM duhet të rafinojë përafrimin e KNj1 të SKZH-së me kornizat e OZHQ-ve dhe implementimin e MSA-së nëpërmjet integritit dhe monitorimit më të mirë të këtyre kornizave. KNj1 e SKZH-së mund të bëhet mjeti kryesor për lokalizimin e OZHQ-ve në përputhje me Rezolutën e OZHQ-ve.

Rekomandimi 5: Rezultatet Strategjike dhe Plani i Veprimit. ZPS/ZKM duhet të mbajë ekzistencën e një plani veprimi të KNj1 të SKZH-së dhe kornizës së rezultateve të performancës në KNj1 të SKZH-së së re, por ato duhet të përafrohen me riorientimin strategjik të KNj1 të SKZH-së që të jetë më shumë një busull strategjike sesa një plan veprimi i projektit.

Rekomandimi 6: Integrimi i Planifikimit Sektorial. ZPS/ZKM duhet të përforcojë mënyrën se si KNj1 e SKZH-së integrohet në sistemin ekzistues kombëtar të planifikimit dhe KNj1 e SKZH-së duhet të shërbejë si bazë për zhvillimin e strategjive sektoriale dhe planeve të punës.

Rekomandimi 7: Mekanizmi sektorial i kontrollimit (cross-check). ZPS/ZKM duhet t'i përditësojë udhëzuesit dhe Udhëzimet Administrative për zhvillimet e strategjive për të krijuar mekanizëm të përforcuar të kontrollimit (cross-check) për të siguruar që strategjitë sektoriale dhe planet e punës janë në përputhje me KNj1 të SKZH-së.

³ Rekomandimet në përmbledhjen ekzekutive përfshijnë vetëm titujt kryesorë. Rekomandimet në tabelën 13 ofrojnë nën-rekomandime më të detajuara si pjesë e planit të përgjithshëm të veprimit

Rekomandimi 8: Integrimi i Burimeve. ZPS/ZKM duhet të krijojë një mekanizëm të përforcuar për të siguruar financimin e aktiviteteve të SKZH-së përmes ndarjes së buxhetit ministror.

Rekomandimi 9: Integrimi nën-kombëtar. ZPS/ZKM duhet të krijojë një mekanizëm të përforcuar për të siguruar lidhjen e strategjive të KNj1 të SKZH-së me planifikimin dhe burimet komunale.

Rekomandimi 10: Forcimi i monitorimit të brendshëm. ZPS/ZKM duhet të krijojë një mekanizëm të përforcuar për të siguruar monitorimin e brendshëm sistematik të progresit të KNj1 të SKZH-së përmes ushtrimeve të mandatuara për mbledhjen e të dhënave që lidhen si me alokimet financiare ashtu edhe me shpenzimet dhe progresin e aktivitetit.

Rekomandimi 11: Vendosja e monitorimit të SKZH-së nga shoqëria civile. ZPS/ZKM duhet të krijojë një mekanizëm të përforcuar për të siguruar që ka monitorim publik të progresit të SKZH-së.

Rekomandimi 12: Strukturat e Pronësisë Politike. ZPS/ZKM duhet të krijojë një mekanizëm të përforcuar për të siguruar që ka pronësi të mjaftueshme politike të KNj1 të SKZH-së duke përfshirë edhe përfaqësimin politik të gjerë nga nivele të ndryshme në komitetet drejtuese të ngarkuara me rishikimin e progresit kundrejt KNj1 të SKZH-së dhe për të udhëzuar veprimet pasuese në rastet kur paraqiten vonesa në zbatim.

1.0 HYRJE

1. Ky Raport Vlerësimi (RV) është për qëllim të vlerësimit në fund të ciklit të Shtyllës së Kapitalit Njerëzor⁴ (KNj1) të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Kosovës (SKZH) 2016-2021. Ky vlerësim është komisionuar nga ana e Zyrës për Planifikim Strategjik (ZPS) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) të Kosovës me mbështetje të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë dhe mbulon periudhën 2016-2021 të SKZH-së. Koha e realizimit të këtij vlerësimi synon t'i informojë Institucionet e Kosovës dhe Zyrën e Kryeministrit, si dhe palët e tjera të interesit lidhur me progresin e SKZH-së dhe mësimet e nxjerra, si dhe të paraqiten rekomandime për informimin e hartimit dhe zhvillimit të ciklit të ardhshëm të SKZH-së (2022-2030).
2. **Faza fillestare.** Gjatë fazës fillestare (Prill-Korrik 2021), ekipi i vlerësimit dhe menaxheri i vlerësimit (MV) mblodhën informacionin përkatës të historikut në lidhje me SKZH-në dhe kontekstin në të cilin po zbatohet; si dhe identifikuan palët e ndryshme të interesit për intervistim në lidhje me fushat e tyre prioritare të të mësuarit nga vlerësimi; dhe për të filluar me përgatitjen e planeve të hollësishme për fazat e procesit që kanë të bëjnë me grumbullimin dhe analizimin e të dhënave. Rishikimi në zyrë i dokumentacionit të ndarë u bë para finalizimit të Raportit fillestar (RF).
3. Përfaqësues nga grupe të ndryshme të palëve të interesit u konsultuan gjatë fazës fillestare, duke përfshirë Zyrën e Planifikimit Strategjik (ZPS) në Zyrën e Kryeministrit (ZKM) dhe UNICEF-in.⁵ Një çështje domethënëse e identifikuar gjatë misionit fillestar ka qenë se hartimi i SKZH-së së ardhshme tashmë ishte duke vazhduar. Si pasojë, procesi i vlerësimit do të duhej të merrte masa, të tilla si ndarja e gjetjeve paraprake për t'u përfshirë në procesin e projektimit të SKZH-së së re, madje edhe para se të përfundonte ushtrimi i vlerësimit. Faza fillestare gjithashtu identifikoi rëndësinë që vlerësimi të ketë një qasje të fokusuar në të mësuarit, duke përfshirë planifikimin për shtjellimin e dy punëtorive për forcimin e kapaciteteve; një menjëherë pas fazës fillestare për stafin teknik në lidhje me parimet e përgjithshme të vlerësimit, dhe një gjatë fazës së raportimit për të lehtësuar zhvillimin e përgjigjeve të menaxhmentit dhe hapave të veprimit bazuar në rekomandimet e vlerësimit të KNj1 të SKZH-së. Këto janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionet vijuese të kësaj RF-je. Si pjesë e qasjes së fokusuar në të mësuarit, procesi i vlerësimit të KNj1 të SKZH-së ka përfshirë pjesëmarrjen e vullnetarëve të rinj që shoqëruan procesin e vlerësimit si pjesë e një procesi praktik dhe për zhvillimin profesional. Ky komponent i shoqëruar nga të rinjtë përshkruhet më hollësisht në seksionin 4.2 dhe termet e referencës përfshihen në Shtojcën 11.

Përshkrimi i kontekstit

4. Kosova kategorizohet me të ardhura mesatare të sipërme me një BPV për kokë banori të vlerësuar në 4,312 dollarë amerikanë në vitin 2021.⁶ Sipas Bankës Botërore, Kosova është "një nga katër vendet në Evropë që kanë përjetuar rritje ekonomike që nga fillimi i krizës financiare globale në 2008."⁷ Pavarësisht trendit të rritjes, pabarazia është e lartë dhe fëmijët dhe të rinjtë janë veçanërisht të cenueshëm. Me 18 për qind të popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë, Kosova mbetet më e varfra në Evropë.⁸ Kosova ka një nga përqindjet më të larta të popullsisë ekonomikisht joaktive në Evropë.⁹ Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore të vitit 2020 (tremujori i tretë), fuqia punëtore joaktive në Kosovë është dukshëm e lartë, në

⁴ Për qëllimet e këtij vlerësimi, kapitali njerëzor përkufizohet si grumbullimi i aftësive, njohurive dhe përvojës në një popullatë dhe shihet në kuptimin e kontributit dhe vlerës së tij në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

⁵ Shtojca 7

⁶ Banka Botërore: Kosovo Overview 2021.

⁷ Banka Botërore. 2019. *Kosovo*. <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo>

⁸ UNICEF. 2019. Kosovo Gender Programmatic Review.

⁹ You, D. (2016). Kosovo in its Early Demographic Dividend Stage

69.9 për qind, me një pabarazi të madhe midis grave (85.6 për qind) dhe burrave (53.8 %).¹⁰ Shkalla e përgjithshme e punësimit është 30.1 për qind, me të rinjtë dhe gratë ndër më të pafavorshmit në fuqinë punëtore.¹¹ Sektorët e patregtueshëm dominojnë ekonominë dhe tregun e punës pasuar nga industria (17.5 % e BPV-së), prodhimi (11 % e BPV-së) dhe bujqësia (8 % e BPV-së).¹² Rritja ekonomike e Kosovës gjithashtu varet shumë nga remitancat. Zonat rurale kanë tregues më të ulët ekonomikë dhe socialë dhe kështu janë më të cenueshme se zonat urbane.¹³ Tabela 1 paraqet një pasqyrë të treguesve kryesorë të Kosovës.

TABELA 1: STATISTIKAT KRYESORE TË VËSHTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS¹⁴

| | |
|---|------|
| Popullsia, miliona | 1.8 |
| BPV, miliardë dollarë amerikanë, aktualisht | 7.9 |
| BPV për kokë banori, miliardë dollarë amerikanë, aktualisht | 4312 |
| Indeksi i Kapitalit Njerëzor % | 56 |
| Jetëgjatësia në lindje, vite | 76.7 |
| Mbijetesa në moshën 5 vjeç, % | 99 |

- Administrativisht, Kosova është e ndarë në 38 komuna. Një fokus i fortë i qeverisë në dekadën e fundit ka qenë mbi procesin e decentralizimit si një mënyrë për të përmirësuar shërbimet në nivel lokal, për të rritur përfaqësimin lokal dhe për të zbutur tensionin etnik¹⁵. Decentralizimi megjithatë ka nxjerrë në pah mospërputhjet në të drejtat e plota dhe të barabarta të fëmijëve, siç është cilësia e ndryshueshme në burimet për arritjen arsimore dhe qasjen në shërbimet shëndetësore dhe mungesa e kapaciteteve në nivel lokal për të zbatuar reforma të ndryshme¹⁶. Sa i përket reformave, Kosova ka nënshkruar një numër marrëveshjesh kryesore të BE-së, përfshirë Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit BE-Kosovë (MSA) në fund të vitit 2015, dhe është duke zbatuar Agjendën e Reformës Evropiane (ARE) që nga viti 2016 si “një mjet i dobishëm për udhëheqjen e zbatimit të reformave të ndërlidhura me BE-në në kontekstin e MSA-së.”¹⁷ Raporti i BE-së për Kosovën për vitin 2019 thekson progresin e bërë nga Kosova në përafrimin me legjislacionin e BE-së dhe zbatimin e disa reformave të lidhura me BE-në. Kosova gjithashtu ka treguar bashkëpunim dhe pjesëmarrje të mirë rajonale në shumicën e forumeve rajonale.
- Shpenzimet e përgjithshme publike për shërbimet sociale janë rritur me kalimin e kohës, por mbeten relativisht të ulëta dhe të pamjaftueshme për të siguruar qasje dhe mbulim universal. Arsimi dhe shëndetësia, dy nga blloqet kryesore të ndërtimit për zhvillimin e kapitalit njerëzor, janë të nënfinancuara dhe kjo është arsyeja kyçe prapa rezultatit të Indeksit të Kapitalit Njerëzor (IKNj) prej 56 për qind. IKNj-ja tregon se fëmijët po arrijnë vetëm 56 për qind të potencialit që do të kishin pasur me arsim dhe shëndetësi të plotë. Kjo paraqet është humbje prej 44 për qind të fitimeve të tyre të mundshme, sepse qeveritë aktualisht nuk po bëjnë investime efektive në njerëzit e tyre për të siguruar popullsi të

¹⁰ ASK. 2020. *Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë*, <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/labour-force-survey-q3-2020>

¹¹ ASK. 2020. *Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë* <<https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/labour-force-survey-q3-2020>>

¹² Banka Botërore. 2020. *Kosovo Overview*.

¹³ UNICEF 2019. *Termtat e Referencës: Vlerësimi i Pavarur i Programit të UNICEF -it në Kosovë*; Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. *Varfëria në Konsum në Kosovë 2012-2017*.

¹⁴ Banka Botërore. 2019. <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo>

¹⁵ Ambasada Mbretërore Norvegjeze dhe Friedrich Ebert Stiftung. 2016. *Nevoja për të rimenduar decentralizimin*

¹⁶ UNICEF. 2019. *Analiza e gjendjes së fëmijëve dhe grave në Kosovë*

¹⁷ BE. 2019 *Raporti për Kosovën*, f. 1

shëndetshme, të arsimuar dhe të qëndrueshme dhe e cila është e gatshme për vendin e punës në të ardhmen.¹⁸

7. Aktualisht, shërbimet sociale në Kosovë janë të decentralizuara në nivel komunal, megjithatë, financimi, si dhe disa shërbime siç janë shërbimet për fëmijët pa kujdes prindëror, shërbimet për personat me aftësi të kufizuara dhe të tjera, mbeten të centralizuara në nivel kombëtar. Ndarja e fondeve për shërbimet sociale në shëndetësi dhe arsim është nën mesataren e BE-së. Shpenzimet për shëndetësinë janë 3.8 për qind të BPV-së, që është dukshëm më e ulët se mesatarja e BE-së prej 7.1 për qind.¹⁹ Në mënyrë të ngjashme, shpenzimet për arsimin janë relativisht të ulëta, në 4.1 për qind të BPV, me pjesën më të madhe të financimit të shpenzuar për paga.²⁰ Shpenzimet e mbrojtjes sociale kanë parë një rritje në vitet e fundit, nga 3.6 për qind e BPV-së në vitin 2009 në 6.1 për qind të BPV-së në vitin 2016.²¹ Mbulimi i popullsisë nga programet e mbrojtjes sociale, veçanërisht ndihma sociale midis grupeve të cënueshme, mbetet i ulët.²² Si rezultat, sipas Indeksit të Kapitalit Njerëzor, një fëmijë i lindur në Kosovë sot do të jetë 57 për qind produktiv në kushtet aktuale të kapitalit njerëzor në krahasim me sa do të ishte nëse do të kishte gëzuar arsim të plotë dhe mbështetje të plotë shëndetësore.²³
8. **Rinia dhe Fuqizimi Ekonomik.** Kosova ka popullsi shumë të re ku më shumë se gjysma e popullsisë së saj prej 1.8 milionë banorë janë nën moshën 30 vjeçare dhe 31 për qind nën moshën 18 vjeçare²⁴. Ndërsa këta qytetarë rriten dhe hyjnë në fuqinë punëtore, ekziston mundësia për të përfituar nga ky "dividend demografik" për të nxitur zhvillimin ekonomik nëse shfrytëzohet në mënyrë të përshtatshme. Disa vlerësime parashikojnë se deri në vitin 2030, popullsia e rritur brenda moshave të fuqisë punëtore do të jetë rritur për 10 për qind.²⁵ Megjithatë, sipas shënimeve të politikave për hartimin fillestar të SKZH-së, ekziston shqetësimi se migrimi i konsiderueshëm nga Kosova i të rinjve në moshë pune dhe të arsimuar mund të përshpejtojë plakjen e popullsisë dhe të zvogëlojë përparësitë e këtij dividendi demografik. Sipas një studimi të UNICEF-it mbi dividendin demografik në Kosovë të zhvilluar në vitin 2015, dritarja e mundësisë për t'u mbështetur në këtë fuqi punëtore potenciale për të nxitur zhvillimin ekonomik mund të jetë e ngushtë dhe pritet të mbyllet nga mesi i viteve 2030. Rekomandimet kryesore të politikave për të përfituar nga kjo mundësi e sugjeruar nga hulumtimi i UNICEF-it do të fokusoheshin në investimet në kapitalin njerëzor, rritjen e lëvizshmërisë së tregut të punës, zvogëlimin e barrierave për pjesëmarrjen e grave në punë, forcimin e kursimeve dhe krijimin e mundësive të reja për punësim. Përshtatja e arsimit dhe aftësimi teknik për t'i përmbushur kërkesat e tregut të punës në zhvillim është një koncept veçanërisht i rëndësishëm themelor për të përfituar nga ky dividend në zhvillim në Kosovë.²⁶
9. **Arsimi.** SKZH-ja i ka dhënë përparësi investimit në kapitalin njerëzor në arsim përmes zgjerimit të arsimit parashkollor.²⁷ Qasja në programet e edukimit të hershëm për fëmijët e moshës 3-5 muajsh është shumë e ulët, në 15 për qind, në krahasim me mesataren e BE-së

¹⁸ Banka Botërore (2020). Kosovo Human Capital Index.

(https://databank.worldbank.org/data/download/hci/HCI_2pager_XKX.pdf?cid=GGH_e_hcpexternal_en_ext)

¹⁹ UNICEF (2019). *Analiza e Situatës së Fëmijëve dhe Grave në Kosovë*

²⁰ Instituti GAP. (2018). *Projektbuxheti 2019: Analizë e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore.*

<https://www.institutigap.org/documents/57498_2019draftbudget.pdf>

²¹ Banka Botërore (2018). *Kosovo Social Protection and Health Expenditure Note.*

<<http://documents.worldbank.org/curated/en/190411561720305500/pdf/Kosovo-Social-Protection-and-Health-Expenditure-Note.pdf>>

²² Banka Botërore (2018). *Kosovo Social Protection and Health Expenditure Note.*

<<http://documents.worldbank.org/curated/en/190411561720305500/pdf/Kosovo-Social-Protection-and-Health-Expenditure-Note.pdf>>

²³ Banka Botërore (2020). Kosovo Human Capital Index.

(https://databank.worldbank.org/data/download/hci/HCI_2pager_XKX.pdf?cid=GGH_e_hcpexternal_en_ext)

²⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Vlerësimi i popullsisë 2017

²⁵ UNICEF. 2016. Kosovo in its early demographic dividend stage – a time sensitive opportunity.

²⁶ Po aty.

²⁷ Qeveria e Kosovës. 2016. *Strategjia Kombëtare për Zhvillim; FISKUS, 2017. The Cost of Introducing Universal Early Childhood Education in Kosovo.*

e mbi 80 për qind.²⁸ Praktikrat familjare të fokusuar në zhvillim janë të dobëta, duke çuar në indekse të ulëta të zhvillimit të fëmijëve veçanërisht për dimensionin kognitiv.²⁹ Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës në Kosovë mbeten shqetësimet kryesore. Mungojnë të dhënat për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe qasjen e tyre në arsim. Regjistrimi i fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e detyrueshëm është nën mesataren kombëtare në 85.5 për qind për arsimin fillor dhe 64.4 për qind për arsimin e mesëm të ulët, ndërsa regjistrimi në shkollën e mesme të lartë është 31.1 për qind.³⁰ Vajzat rom, ashkali dhe egjiptiane janë më të pafavorizuara se djemtë dhe shpesh detyrohen të martohen herët.³¹ Pabarazia e të mësuarit mund të vërehet edhe në hendekun e arritjeve midis nxënësve më të varfër dhe atyre më të pasur, të vlerësuar në 1.5 vjet shkollim për Kosovën (66 pikë të PISA-s).³² Banka Botërore (2020) thotë se “fëmijët në Kosovë që fillojnë shkollën në moshën 4 vjeç mund të presin që të përfundojnë 13.2 vjet të shkollës parafillore, fillore dhe të mesme deri në moshën 18 vjeç. Megjithatë, kur vitet e shkollimit përshtaten për cilësinë e të mësuarit, kjo është e barabartë me 7.9 vjet: një hendek mësimi prej 5.3 vitesh.”³³ Rezultatet e PISA-s 2018³⁴ sugjerojnë se mbi 78 për qind e 15-vjeçarëve në Kosovë janë analfabetë funksionalë (duke performuar nën nivelin 2 të zotësisë në PISA).³⁵ Në vitin 2020, në mesin e të rinjve të moshës 7-14 vjeç, vetëm 41 për qind kishin njohuri themelore të shkrim leximit³⁶ dhe 42 për qind kishin njohuri themelore të numërimit.^{37,38} Shkalla e lartë e papunësisë në mesin e atyre me arsim të lartë (20.7 për qind në TM3 2020) tregon një mospërputhje midis rezultateve të sistemit arsimor dhe nevojave të tregut të punës.³⁹

10. **Gjinia:** Situata e grave në Kosovë ndikohet nga normat e forta shoqërore, pritjet shoqërore dhe praktikrat tradicionale. Rolet gjinore ndërtohen në familje dhe përforcohen në mjediset e shkollës dhe komunitetit. Normat konservatore shoqërore rezultojnë në pjesëmarrjen e ulët të grave në fuqinë punëtore dhe në shoqëri në përgjithësi. Me gjithë faktin se nuk ka informacione të besueshme mbi prevalencën e grave që i nënshtrohen dhunës në baza gjinore gjatë jetës së tyre, një e katërta e grave të moshës 15-49 vjeç justifikojnë dhunën e partnerit të tyre ndaj tyre.⁴⁰ Vetëm një në pesë gra në moshë pune janë aktive në tregun e punës në krahasim me tre në pesë burra.⁴¹ Pengesa të tjera për pjesëmarrjen e grave si anëtare të me vlerë përfshijnë përgjegjësitë familjare, qasjen e kufizuar në kujdesin cilësor dhe të përballeshëm të fëmijëve dhe të moshuarve, koston e lartë të pushimit të lehonisë për punëdhënësit dhe qasjen e kufizuar të grave në asete dhe inpute produktive.⁴²
11. **Korniza e Politikave:** Gjatë periudhës në shqyrtim, Kosova krijoi disa plane dhe dokumente kryesore qendrore për të krijuar bazën për një shoqëri të barabartë dhe më gjithëpërfshirëse. Këto përfshijnë strategji sektoriale për secilën ministri, Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Monitorimin e të Drejtave të Fëmijëve 2019-2023. Koncepti i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal gjithashtu ka parashikuar krijimin e grantit specifik për shërbimet sociale të miratuar nga Qeveria dhe Koncepti i Dokumentit për shërbimet sociale dhe familjare që do të përcaktojë qartë mandatin e institucioneve të ndryshme duke

²⁸ UNICEF. Të dhënat e Anketës së MICS-it të Kosovës 2020.

²⁹ UNICEF. 2018. *Kosovo Theory of Change: Kosovo Program 2019-2020*

³⁰ UNICEF. Të dhënat e Anketës së MICS të Kosovës 2020.

³¹ UNICEF. 2019. Analiza e Situatës për Fëmijët dhe Gratë në Kosovë.

³² Banka Botërore. 2020. *Raporti i Rregullt Ekonomik i Ballkanit Perëndimor: Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19*. <<http://documents1.worldbank.org/curated/en/590751590686858272/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Education.pdf>>

³³ Banka Botërore. 2020. *Indeksi i Kapitalit Njerëzor për Kosovën*

³⁴ Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve, i mbështetur nga OECD

³⁵ Banka Botërore. 2020. *Raporti i Rregullt Ekonomik i Ballkanit Perëndimor: Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19*. <<http://documents1.worldbank.org/curated/en/590751590686858272/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Education.pdf>>

³⁶ Fëmijët mund të lexojnë saktë 90% të fjalëve në një tregim, t'u përgjigjen tri pyetjeve të të kuptuarit fjalë për fjalë dhe dy pyetjeve konkluzive të të kuptuarit

³⁷ Fëmijët mund të kryejnë detyrë të leximit të numrave, detyrë **diskriminimi**, detyrë shtesë dhe detyrë për njohjen e modeleve

³⁸ Të dhënat e anketës së UNICEF-it, MICS në Kosovë 2020

³⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2020. Anketa e Fuqisë Punëtore T3 2020.

⁴⁰ UNICEF. Të dhënat e Anketës së MICS të Kosovës 2020.

⁴¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2020. Anketa e Fuqisë Punëtore T3 2020.

⁴² UNICEF. 2019. Rishikimi Programatik Gjinor i Kosovës

përfshirë mbulimin, llojet dhe cilësinë e shërbimeve; monitorimin dhe inspektimin, dhe financimin.⁴³ Së fundmi, miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës në vitin 2019 konfirmoi angazhimin e palëve të interesit për krijimin e një mekanizmi të integruar të mbrojtjes së fëmijëve në të gjithë Kosovën.⁴⁴

Subjekti i Vlerësimit: SKZH 2016-2021 - Shtylla e Kapitalit Njerëzor


Përmbledhja, shtyllat dhe përfrimi

12. SKZH-ja (2016-2021) është e para e llojit të saj e zhvilluar nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe ajo shërben si një dokument strategjik për të gjithë planifikimin zhvillimor në Kosovë. SKZH-ja synoi të zhvillonte një listë të prioriteteve nën një strategji ombrellë e cila do të lejonte ndërtimin e sinergjive midis iniciativave, do të parandalonte mbivendosjen institucionale dhe do të sillte efikasitet më të lartë të performancës, orientim të mbështetjes së partnerëve zhvillimorë dhe do të krijonte një bazë për llogaridhënien publike. SKZH-ja është e organizuar në katër shtylla tematike: kapitalin njerëzor, qeverisjen e mirë, zhvillimin industrial dhe zhvillimin infrastrukturor. Si një shtesë e SKZH-së, Udhërrëfyesi i SKZH-së, i përgatitur në vitin 2017, përshkroi një plan zbatimi më të detajuar i cili përfshinte kostimin, si dhe treguesit e zbatimit dhe të aktiviteteve.
13. Shtylla 1: Kapitali Njerëzor, subjekt i këtij vlerësimi, është e orientuar rreth promovimit, krijimit dhe mbajtjes së një fuqie punëtore produktive, të aftë dhe inovatore. Logjika prapa kësaj është se ky është një faktor përcaktues për zhvillimin e suksesshëm kombëtar. Kjo bazohet në supozimet se ndërsa fuqia punëtore fiton aftësi më të larta, do të ketë një rritje pasuese të të ardhurave dhe një përmirësim të përgjithshëm në ekonomi. Aftësitë jo vetëm që përcaktohen si aftësi teknike, por gjithashtu përfshijnë aftësi njohëse, të tilla si logjika dhe arsyetimi, si dhe aftësi 'të buta' siç janë aftësitë ose vlerat ndërpersonale. Ndërtimi i këtyre aftësive është i shumë i lidhur me sistemin arsimor dhe cilësinë e arsimit të siguruar para futjes së fuqisë punëtore, edhe pse rritja e aftësive të tregut të punës mund të vijë edhe nga migrimi në mjedise të tjera dhe "kthimi i trurit" (*brain gain*) nga të kthyerit nga diaspora.
14. Për sa i përket alokimit të përgjithshëm të burimeve për SKZH-në, pjesa më e madhe e burimeve për SKZH-në i alokohet zhvillimit të Infrastrukturës në Shtyllën 4, e cila përfshin gati 95 për qind të burimeve totale për SKZH-në. Megjithëse shtylla e Kapitalit Njerëzor në krahasim përbën vetëm rreth 3.4 për qind të burimeve totale për SKZH-në, ajo është shtylla e dytë me më shumë burime pas Infrastrukturës me rreth 3-4 herë më shumë se shumica e burimeve për Shtyllën 2 (Qeverisje e Mirë) dhe Shtyllën 3 (Industritë Konkurruese). Kjo sugjeron që edhe pse të gjitha Shtyllat konsiderohen të nevojshme për zhvillimin kombëtar, i është kushtuar një vëmendje shtesë zhvillimit të infrastrukturës në krahasim me shtyllat e tjera. Tabela e mëposhtme përmbledh vlerësimet relative të burimeve bazuar në planin fillestar të burimeve për SKZH-në.

TABELA 2: KOSTIMI I SKZH-së PËR SHTYLLË (EURO)

⁴³UNICEF (2018). Teoria e Ndryshimit: Programi i Kosovës 2019 - 2020

⁴⁴UNICEF (2019). RAM



15. **Kontributet e ndikimit makro:** SKZH-ja artikulon një gamë prej 16 treguesish të nivelit makro që duhet të pasqyrojnë ndryshime pozitive në rast se masat e SKZH-së janë të suksesshme. Këto grupohen në katër kategori të përgjithshme: Rritja Ekonomike, Tregu i Punës, Kohezioni Social dhe Investimet dhe Tregtia (Tabela 3). Megjithëse të gjitha shtyllat kontribuojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në të gjithë treguesit e nivelit makro, treguesit më relevant për shtyllën e kapitalit njerëzor janë ata që lidhen me tregun e punës. Instituti GAP së fundi ka përfunduar rishikimin e progresit të disa prej këtyre treguesve të nivelit makro deri në vitin 2019⁴⁵. Disa nga treguesit e kohezionit social nuk janë përfshirë pasi nuk ishin rimatur para publikimit të raportit të GAP-it. Rezultatet kundrejt treguesit të nivelit makro janë përshkruar në seksionin 3, tek Efektiviteti.

TABELA 3: PERFORMANCA E TREGUESVE MAKRO TË SKZH-së⁴⁶

| Tema | # | Treguesi | Njësia |
|-------------------------------|--|---|-------------|
| Rritja Ekonomike | 1 | BPV për kokë banori | EUR |
| | 1.1 | Shkalla Vjetore Reale e Rritjes së BPV-së | % |
| | 2 | GFCF ⁴⁷ (% e BPV-së) | % |
| Tregu i Punës | 1 | Raporti i punësimit ndaj popullsisë | % |
| | 2 | Papunësia ⁴⁸ | % |
| | 2.1 | Papunësia tek të Rinjtë ⁴⁹ | % |
| | 2.2 | Pjesa e Rinisë NEET ⁵⁰ | % |
| | 3 | Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ⁵¹ | % |
| 3.1 | Shkalla e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore ⁵² | % | |
| Kohezioni Social | 1 | % të njerëzve në varfëri | % |
| | 2 | IZhNj ⁵³ | Index 0-1 |
| Investimet dhe Tregtia | 1 | Flukset e përgjithshme hyrëse të IHD-ve | Milion Euro |
| | 1.1 | IHD si pjesë në BPV | % |
| | 2 | Investimet private si pjesë në BPV | % |
| | 3 | Norma eksport-import | % |

⁴⁵ Referuar në studimin e Institutit GAP

⁴⁶ Burimi: Udhërrëfyesi për Zbatimin e SKZH-së 2016-2021

⁴⁷ Formimi i kapitalit fiks bruto

⁴⁸ Përqindja e fuqisë totale punëtore

⁴⁹ 15-24 vjeç

⁵⁰ Që nuk është në arsim, punësim ose trajnim

⁵¹ Popullsia totale +15 vjet

⁵² Popullsia totale +15 vjet

⁵³ Indeksi i Zhvillimit Njerëzor

| | | | |
|--|---|---|---|
| | 4 | Pjesa e eksporteve në BPV ⁵⁴ | % |
|--|---|---|---|

16. Nuk ka tregues të nivelit makro që fokusohen në mënyrë specifike në vetë kapacitetin e sistemit arsimor, por ka tregues të asociuar të performancës për sistemin arsimor të përshkruar në Udhërrëfyesin e SKZH-së, siç janë përmirësimet e rezultateve të PISA-s. Shtojca 3 jep një përshkrim më të detajuar të të gjithë treguesve të performancës që lidhen me Shtyllën e Kapitalit Njerëzor në nivel makro dhe të aktivitetit.
17. **Përafrimi i kornizës së SKZH-së:** Megjithëse fokusi kryesor i SKZH-së ka qenë rritja ekonomike, zbatimi i SKZH-së kishte për qëllim të shërbente si një mjet për të avancuar gjithashtu agjendën e Integritimit Evropian të Kosovës. Si rezultat, në kohën e hartimit të SKZH-së në vitin 2016, pati përpjekje për të harmonizuar masat e SKZH-së me Marrëveshjen Kombëtare të Stabilizim Asociimit (MSA) dhe programin e zbatimit të saj për miratimin e acquis të BE-së.
18. **KNj1 e SKZH-së:** Subjekti i vlerësimit është komponenti KNj1 e SKZH-së brenda SKZH-së gjithëpërfshirëse dhe të gjitha analizat dhe gjetjet pasuese raportohen vetëm kundrejt KNj1 të SKZH-së. Megjithëse nuk ka një Teori specifike të Ndryshimit (TeN) për SKZH-në, ka supozime të nënkuptuara të përfshira në masat dhe arsyetimin prapa Shtyllës së Kapitalit Njerëzor që nënkuptojnë cilat janë barrierat kryesore që pengojnë zhvillimin e kapitalit njerëzor në Kosovë dhe hyrjen në tregun e punës. Këto barrierat dhe supozime të nënkuptuara për korrigjim të përfshira në shënimet e politikave për KNj1 të SKZH-së janë një "TeN e nënkuptuar".
19. KNj1 e SKZH-së dhe Udhërrëfyesi i KNj1 të SKZH-së theksojnë se barrierat kryesore e madhe për hyrjen në tregun e punës është aftësitë dhe njohuritë e pamjaftueshme të popullatës - veçanërisht popullatës së të rinjve (15-24 vjeç). Tri barrierat kryesore pengojnë zhvillimin e kapitalit njerëzor në Kosovë: i) Fëmijët nuk po hyjnë në programe arsimore ose po hyjnë shumë vonë, ii) Cilësia e arsimit të ofruar në shkollat është e pamjaftueshme për të ndërtuar kapitalin njerëzor, iii) Sistemi arsimor dhe kurrikula është nuk i përshtatet nevojave të njohurive dhe aftësive në tregun modern të punës. Këto barrierat formojnë bazën e aktiviteteve brenda Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë⁵⁵ me një theks të veçantë drejt ndërtimit të shkollave dhe ngritjes së mekanizmave të certifikimit dhe llogaridhënies.
20. Një barrierë e dytë kryesore është se qytetarët ngurrojnë të hyjnë në tregun e punës për shkak të trajtimit të dobët duke përfshirë mungesën e kontratave dhe kushtet e këqija të punës. Kjo është disi në kundërshtim me logjikën e deklaruar të barrierës së parë - se është vetë popullata që nuk ka kapital të mjaftueshëm njerëzor për të hyrë në tregun e punës.
21. Barrierat e tretë kryesore të nënkuptuar në masa është se kapitali njerëzor është i ulët në popullatën e Kosovës për shkak të ikjes së trurit brenda diasporës dhe se kapitali njerëzor mund të forcohet me zhvillimin e stimujve për të tërhequr dhe kontraktuar diasporën për t'u angazhuar në tregun e punës brenda Kosovës (ose në sistemin arsimor).
22. Për shkak të këtyre barrierave, KNj1 e SKZH-së vë një theks të fortë në masat që kërkojnë të forcojnë sistemin arsimor dhe lidhjen dhe aplikueshmërinë e tij në tregun e punës dhe ekonominë. Ekzistojnë shtatë masa të dallueshme të artikuluar nën Shtyllën 1 (Tabela 4). Një përshkrim i plotë i masave, aktiviteteve, agjencive kryesore dhe kostimit të SKZH-së gjendet në Shtojcën 3.

⁵⁴ Mallra dhe shërbime

⁵⁵ Emërtim i vjetër, i ndërruar që nga hartimi i SKZH-së

TABELA 2: MASAT E SHTYLLËS SË KAPITALIT NJERËZOR

| Masa | Arsyetimi |
|---|---|
| 1. Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore | Kjo do të mundësojë sukses më të mirë në nivele më të larta arsimore, do të zvogëlojë pabarazinë dhe do të rrisë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Fëmijët mund të mësojnë ndërsa nëna e tyre është duke punuar. |
| 2. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm | Ky është një parakusht për sukses më të mirë të sistemit arsimor dhe forcimin e aftësive të rinjve për tregun e punës. Ndërsa mësimdhënësit bëhen më të kualifikuar, cilësia e arsimit të marrë nga fëmijët duhet të përmirësohet. |
| 3. Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës | Kjo do të kontribuojë në uljen e papunësisë dhe promovimin e rritjes së industrive kosovare. Prandaj, nxënësit nga shkollat profesionale ose studentët e universiteteve duhet ta kenë më të lehtë të punësohen pas përfundimit të studimeve si dhe punës praktike gjatë studimeve të tyre. |
| 4. Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit në sistemin arsimor | Nëse shkollat dhe mësimdhënësit mbahen përgjegjës për punën e tyre dhe shpërblehen për cilësinë e punës së tyre - kjo do të përmirësojë cilësinë e arsimit të marrë nga fëmijët. |
| 5. Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin e arsimit | Kjo do të rrisë efikasitetin e sistemit arsimor dhe duhet të mundësojë kursime në buxhet duke i ridrejtuar fondet nga fushat me prioritet më të ulët në fushat me prioritet më të lartë. |
| 6. Ulja e nivelit të punësimit joformal | Punësimi formal mundëson mbrojtje më të mirë të punëtorëve dhe avancime më të strukturuar. Punëtorët duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga pensionet, të kenë qasje më të mirë në kredi dhe të punojnë në kushte më të mira pune. |
| 7. Angazhimi konkret i ekspertëve dhe studentëve të diasporës | Kjo do të mundësojë transferimin e aftësive dhe njohurive të marra nga komuniteti i diasporës jashtë vendit për zhvillimin kombëtar të Kosovës dhe forcimin e lidhjeve me vendlindjen e tyre. Ekspertët e teknologjisë mund të mbështeten financiarisht gjatë zhvillimit të projekteve për institucionet e Kosovës ose kompanitë private për prodhim afatgjatë. |

23. Në vitin 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Rezolutën për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të). OZHQ-të u përafrauan ngushtë dhe u raportuan si pjesë e KNj1 të SKZH-së duke përfshirë integrimin e treguesve kryesorë socialë shtesë në shëndetësi, arsim, punësim dhe mirëqenie sociale.⁵⁶ Përafrimi i KNj1 të SKZH-së me Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm kishte për qëllim të përshpejtonte agjendën e zbatimit të OZHQ-ve për Kosovën. Përveç kësaj, SKZH-ja u përafraua me strategjitë sektoriale që synojnë të maksimizojnë rezultatet për zhvillimin ekonomik, arsimin dhe punësimin. KNj1 e SKZH-së është e përafrauar me kornizën e OZHQ-ve - të pasqyruar në planin e veprimit të KNj1 të SKZH-së të vitit 2017. Për sa i përket barazisë dhe të drejtave të njeriut, KNj1 e SKZH-së artikulon hapa veprimi për përmirësimin e sistemeve që ofrojnë shërbime për të gjithë. Megjithatë, dy popullata të cenueshme të përshkruara në shtyllën e Kapitalit Njerëzor janë gratë dhe popullatat rurale që kanë qasje të kufizuara në shërbimet kombëtare.

Zbatimi dhe progresi i SKZH-së

24. Zbatimi i SKZH-së ishte parashikuar të bëhej një komponent thelbësor i Sistemit të Planifikimit të Integruar në Kosovë. Arsyetimi për centralitetin e tij përfshinte supozimet e mëposhtme: masat e SKZH-së duhet të kenë prioritet në alokimin e burimeve dhe do të monitorohen nga afër, përfshirë vëmendjen e drejtpërdrejtë të Kryeministrit; masat e SKZH-

⁵⁶UNICEF (2019). Termat e Referencës: Vlerësimi i pavarur i Programit të UNICEF-it në Kosovë

së duhet të marrin mbulim të plotë financiar, me qasje preferenciale në çdo burim shtesë nga buxheti qeveritar ose partnerët zhvillimorë sipas mundësive; Ministrat dhe Institucionet përgjegjëse për prioritetet e SKZH-së duhet të hartojnë udhëzime të qarta për zbatimin e objektivave të SKZH-së. U pranua se dy sfidat kryesore do të përfshinin ndërrimin e mundshëm politik si dhe vështirësinë në përcjelljen e shpenzimeve brenda sistemit financiar në përputhje me aktivitetet e planifikuara brenda SKZH-së.

25. Në vitin 2018 u krye një rishikim afatmesëm (RAM) i zbatimit të SKZH-së dhe progresit të tij. Raporti vuri në dukje se për KNj1 të SKZH-së, progres i fortë ishte arritur në disa fusha të rëndësishme si zhvillimi profesional i mësimit dhe futja e provimeve kombëtare të nxënësve/studentëve për t'i matur arritjet e të nxënësve. Për më tepër, rishikimi afatmesëm vuri në dukje se lansimi i prituri i një sistemi të ri informacioni arsimor në atë kohë u supozua të ishte pothuajse i kompletuar dhe përmirësimi i inspektimeve të shkollës ka shënuar progres⁵⁷. U cituan edhe masat e ndërlydhura për reduktimin e punësimit joformal dhe përmirësimet në inspektimet e tregut të punës.
26. Raporti RAM gjithashtu vuri në dukje se vonesat nën këtë shtyllë shpesh lidheshin me ndryshimet sistematike dhe zhvillimin e vazhdueshëm institucional. Për shembull, Agjencia e Standardeve dhe Vlerësimit nuk ishte krijuar ende për shkak të një reforme më të gjerë të administratës publike që po ndërmerre një rishikim të agjencive ekzekutive. Kjo çoi në vonesa në zhvillimin e kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare të Kualifikimit dhe Agjencisë Kosovare për Akreditim që pati efekt dytësor duke vonuar implementimin e sistemit të gradimit dhe licencimit të mësimit dhe mjetet kryesore për arsimin profesional, të tilla si parashikimi ose rishikimi i formulës financiare, gjithashtu u vonuan. RAM gjithashtu vuri në dukje se pak punë ishte bërë për tërheqjen e ekspertëve dhe studentëve të diasporës në sistemin arsimor kombëtar. Raporti theksoi një sërë rregullimesh dhe rekomandimesh të mundshme për zbatim.
27. Në vitin 2021 filloi procesi për konceptimin dhe hartimin e SKZH-së (2022-2030). Për shkak të ndërrimeve të qeverive, rekomandimet e RAM nuk u ndoqën, por ende mund të merren parasysh në hartimin e SKZH-së së re. Hartimi i SKZH-së së re pritet të përfundojë në vitin 2022 dhe gjetjet nga ky vlerësim i SKZH-së aktuale duhet të informojnë hartimin e SKZH-së dhe përzgjedhjen e aktiviteteve në planin e veprimit të SKZH-së. Tabela e mëposhtme përmbledh pikat e rëndësishme të procesit në SKZH-në aktuale.

TABELA 3: PIKETAT E RËNDËSISHME NË SKZH 2016-2021

| Viti | Piketa |
|-----------|---|
| 2014-2015 | Procesi i konsultimit dhe hartimit për SKZH-në |
| 2016 | SKZH-ja e finalizuar dhe e miratuar |
| 2017 | Shtjellimi i Planit të Veprimit të SKZH-së (Plani i Zbatimit dhe Burimeve) |
| 2018 | Raporti i parë mbi zbatimin dhe rezultatet e SKZH-së (i quajtur edhe si rishikim afatmesëm) |
| 2018 | Ushtrim për vlerësimin e progresit nga Instituti GAP |
| 2020 | Matjet e treguesve makro nga Instituti GAP |
| 2021 | Iniciimi i ushtrimit të vlerësimit të Kapitalit Njerëzor të SKZH-së aktuale |

Palët e interesit të SKZH-së

28. **Palët e interesit.** Palët kryesore të interesit të përfshira në zbatimin e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së përfshijnë tri ministri kyçe qeveritare si dhe një sërë institucionesh mbështetëse. Në kohën e hartimit të KNj1 të SKZH-së, ministritë kryesore ishin Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria

⁵⁷ Edhe pse një gjetje dhe jo një përshkrim historik, vetëm për të vënë në dukje se sistemi i informacionit arsimor ende nuk është krijuar

e Diasporës⁵⁸. Institucionet mbështetëse përfshijnë subjekte akademike, biznesi dhe zhvillimi. Subjektet akademike përfshijnë: Institutin Pedagogjik të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Akreditimit dhe Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, Universitetet Private dhe Publike, Rrjetet e Nxënësve/Studentëve dhe shkollat. Subjektet e ndërlidhura me biznesin përfshijnë: Odën Ekonomike të Kosovës, Qendrën e Inovacionit në Kosovë, Rrjetet Profesionale dhe bizneset private. Subjektet Zhvillimore dhe Administrative si UNDP, GIZ dhe Donatorët.

29. **Interesat e palëve të interesit në vlerësim.** Një sërë palësh të interesit brenda dhe jashtë UNICEF-it dhe Zyrës së Kryeministrit kanë interes në rezultatet e vlerësimit dhe shumë prej tyre u ftuan për të luajtur një rol në procesin e vlerësimit (Shtojca 6). Qytetarët janë palë kryesore të interesit si përfituesit përfundimtarë të masave të KNj1 të SKZH-së. Palët e tjera kryesore të interesit përfshijnë institucionet e Kosovës, si dhe ato drejtpërdrejt dhe tërthorazi përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e SKZH-së – duke përfshirë përfaqësuesit nga ministritë e linjës, nivelet qendrore dhe lokale, partnerët zbatues dhe donatorët.

2.0 TIPARET E VLERËSIMIT

Qëllimi dhe objektivat e vlerësimit

30. Siç përshkruhet në TeR, ky vlerësim synon të jetë një vlerësim formativ i punës së përfunduar në kuadër të Shtyllës 1 të SKZH-së së Kosovës (2016-2021) dhe do të kontribuojë në hartimin e SKZH-së së ardhshme. Vlerësimi ka tri objektiva:
1. Të vlerësojë rëndësinë, efektivitetin, qëndrueshmërinë, efikasitetin, sinergjitë dhe ndryshimet afatgjata të lidhura me SKZH-në – Shtyllën e Kapitalit Njerëzor – përfshirë zgjedhjet prioritare dhe programore të bëra në lidhje me strategjitë dhe prioritetet e tjera sektoriale dhe kontekstin socio-ekonomik gjithnjë në ndryshim në Kosovë.
 2. Të sigurojë një vlerësim të pavarur të performancës të SKZH-së 2016-2021 – Shtyllës së Kapitalit Njerëzor – të shikuar në lidhje me rezultatet e pritura siç tregohet në kornizën e monitorimit të Udhërrëfyesit të SKZH-së, për të cilën promovimi i barazisë dhe barazisë gjinore konsiderohen se janë pjesë përbërëse.
 3. Të identifikohen mësimet e nxjerra dhe rekomandimet e ardhshme që mund të informojnë zhvillimin e SKZH-së 2030.
31. Vlerësimi u fokusua në tri objektivat kryesore duke aplikuar kryesisht metoda cilësore. Shtirirja organizative e vlerësimit ishte që të përqendrohet në rezultatet e nivelit kombëtar të arritura nën Shtyllën e Kapitalit Njerëzor, në përputhje me prioritetet gjithëpërfshirëse të SKZH-së. Diçka e tillë kërkoi një rishikim të procesit të zhvillimit dhe zgjedhjeve strategjike të ndërlidhura. Nuk pritet që vlerësimi t'i mbulojë shtyllat e tjera të SKZH-së dhe as nuk pritet që vlerësimi të vlerësojë SKZH-në e përgjithshme.
32. Vlerësimi rishikoi strategjitë përkatëse dhe produktet e njohurive të rëndësishme për Shtyllën e Kapitalit Njerëzor me fokus në arsim, zhvillimin e aftësive dhe nevojat e tregut. Fokus i veçantë i përfshirë në TeR ka të bëjë me çështjet që lidhen me barazinë dhe nëse ato adresojnë dhe kontribuojnë në të drejtat e njeriut, OZHQ-të dhe integrimin gjinor. Pyetjet Vlerësuese (PV) origjinale nuk i pasqyruan domosdoshmërisht këta komponentë në mënyrë eksplicite, por ata janë trajtuar si tema ndërsektoriale përgjatë vlerësimit. Për shembull, kur eksplorohet sesi kryhet monitorimi ose zbatimi, një vlerësim është kryer për masën në të

⁵⁸ Ministrinë u ristrukturuar së fundmi. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në kohën e këtij raporti, tani quhet Ministria e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tashmë është e integruar nën Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferet (MFPT), dhe Ministria e Diasporës tani është e integruar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Për qëllimet e raportit, emrat origjinalë të ministrive citohen në të gjithë, pasi ato ishin struktura për shumicën e ciklit të SKZH-së.

cilën çështjet e të drejtave të njeriut ose barazisë janë marrë parasysh në aktivitetet e zbatuara.

33. Mësimet dhe rekomandimet e përshkruara në TeR do të përfshinin (por nuk do të kufizoheshin në) katër komponentë: a) procesi i përfshirjes dhe pjesëmarrjes së palëve të interesuara në hartimin e SKZH-së;⁵⁹ b) përshtatshmëria dhe lloji i shtyllave të zgjedhura dhe prioritetet e ndëlidhura;⁶⁰ c) rregullimet në aktivitetet për të rritur kontributet në Kosovë;⁶¹ dhe d) integrimi i zbatimit dhe pronësisë së masave të SKZH-së, monitorimit dhe raportimit brenda Qeverisë.⁶²
34. Një ushtrim i mësimave të nxjerra mbi procesin e projektimit të përgatitjes së SKZH-së 2014-2015 u mbështet nga Komisioni Evropian dhe kjo mund të shërbejë si një bazë për përpunimin e mësimave bashkëkohore të nxjerra.
35. Bazuar në këto pritshmëri, TeR paraqiti një grup pyetjesh dhe nënpyetjesh që duheshin eksploruar brenda secilit prej këtyre kritereve (Shtojca 1). Këto pyetje të TeR u përsosën më pas gjatë konsultimeve fillestare dhe përmirësimet janë përshkruar në Seksionin 4.1.
36. **Periudha kohore nën rishikim:** Aktivitetet e bëra nga fillimi i hartimit të KNj1 të SKZH-së në vitin 2015 deri në mars 2021 përfshihen në fushëveprimin e vlerësimit.
37. **Përdorimi i vlerësimit:** Vlerësimi do t'i shërbejë objektivave të dyfishtë dhe reciprokisht përforcues të llogaridhënies dhe të mësuarit, por me theks në të mësuarit. Sa i përket llogaridhënies, vlerësimi do të vlerësojë dhe raportojë mbi performancën dhe rezultatet e arritura (të qëllimit ose të paqëllimit, pozitive ose negative) të KNj1 të SKZH-së. Ndërsa sa i përket të mësuarit, vlerësimi do t'i përcaktojë arsyet pse dhe si proceset dhe rezultatet e caktuara ndodhën ashtu siç ndodhën; do të nxjerrë mësimet dhe praktikat të mira me tregues për të mësuar prej tyre. Po ashtu, vlerësimi do të ofrojë gjetje të bazuara në dëshmi për të informuar vendimmarrjen strategjike në lidhje me strategjitë për zhvillimin e kapitalit njerëzor në Kosovë. Mësimet e nxjerra nga ky vlerësim synohen të përdoren për të përsosur dhe përmirësuar hartimin e SKZH-së së ardhshme dhe zbatimin e aktiviteteve të saj.
38. **Përdoruesit e pritshëm të vlerësimit:** Përdoruesit e pritshëm të këtij vlerësimi janë ZPS-ja në ZKM, institucionet e Kosovës dhe partnerët e tjerë në vendimmarrjen e SKZH-së, veçanërisht në lidhje me rregullimet në zbatimin dhe/ose dizajnin e KNj1 të SKZH-së dhe mbështetjen e diskutimeve me palët e interesit në lidhje me shtjellimin e SKZH-së së ardhshme për Kosovën. Vlerësimi gjithashtu do të shërbejë për të informuar Qeverinë e Kosovës dhe një sërë ministrish, departamentesh dhe zyrash, Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, donatorët dhe OShC-të mbi mësimet e nxjerra nga KNj1 e SKZH-së dhe për t'i paraqitur rekomandimet për aktivitetet e ardhshme të KNj1 të SKZH-së bazuar në gjetjet thelbësore.

Pyetjet e vlerësimit të TeR

39. Gjatë misionit fillestar, EV rishikoi pyetjet origjinale të TeR me ZPS-në dhe palët e tjera të interesit të SKZH-së për të shqyrtuar se si t'u përshtaten ushtrimet nevojave më të rëndësishme të Qeverisë së Kosovës.
40. Ky reflektim dhe konsultim ishte pjesërisht i nevojshëm për shkak të kohës së vlerësimit të KNj1 të SKZH-së në lidhje me procesin e përgjithshëm për zhvillimin e SKZH-së së ardhshme (2022-2030) dhe për të nxjerrë perspektivat e palëve të interesit që nuk ishin përfshirë deri më tani në përpilimin e pyetjeve origjinale të TeR. Tabela 6 paraqet pyetjet e

⁵⁹ Pjesë e nënpyetjeve 1, 2 dhe 6

⁶⁰ Pjesë e nënpyetjeve 2, 3 dhe 8

⁶¹ Pjesë e nënpyetjeve 3, 5, 8 dhe 9

⁶² Pjesë e nënpyetjeve 5, 7 dhe 10

rafinuara të TeR për të gjithë vlerësimin. Analiza e nënkuptuar e TeN dhe rishikimi i supozimeve do të shërbejë si një nga ushtrimet ndërsektorale për informimin e gjetjeve kundrejt këtyre pyetjeve të vlerësimit. Për shembull, a ishin të sakta supozimet në lidhje me përafrimin e nevojave dhe përzgjedhjen e mëvonshme të masave të KNj1 të SKZH-së? A lidheshin logjikisht masat e propozuara me arritjen e objektivave të përshkruar?

TABELA 4: NËNPTYETJET E TeR SIPAS DIMENSIONIT

| Dimensionet | Nënpyetjet |
|--|--|
| Rëndësia: Për të vlerësuar përafrimin e SKZH-së me nevojat ekzistuese të Kosovës duke përfshirë strategjitë, politikat dhe ndryshimet në kushtet. | <p>1. Përafrimi i nevojave: Deri në çfarë mase SKZH-ja (2016-2021) është përafruar në tërësi me nevojat e Kosovës, duke përfshirë barazinë ekonomike dhe kushtet e kapaciteteve sociale që SKZH-ja synon t'i adresojë?</p> <p>2. Bazuar në dëshmi: Deri në çfarë mase janë informuar nga dëshmitë masat e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021)?</p> <p>3. Përshtatja dhe pozicionimi: Deri në çfarë mase është përshtatur Shtylla e Kapitalit Njerëzor e SKZH-së (2016-2021) me prioritetet në zhvillim e sipër?</p> |
| Efektiviteti: vlerësimi i masës në të cilën janë zbatuar aktivitetet dhe ndërhyrjet e SKZH-së. ⁶³ | <p>4. Arritja e objektivave dhe caqeve: Deri në çfarë mase është arritur masa e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021) kundrejt objektivave dhe caqeve të përcaktuara?</p> <p>5. Korniza e monitorimit dhe raportimit: Deri në çfarë mase është hartuar korniza e monitorimit dhe raportimit për të informuar monitorimin sistematik dhe zbatimin e SKZH-së?</p> <p>6. Integrimi gjinor: A është integruar gjinia në mënyrë efektive në zbatimin e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021), dhe nëse jo, si mund të bëhet më mirë?</p> |
| Efikasiteti: Për të vlerësuar efektivitetin e kostos dhe efikasitetin operacional të SKZH-së. ⁶⁴ | <p>7. Efektiviteti i kostos: Deri në çfarë mase burimet financiare të disponueshme u përdorën në mënyrë efikase duke marrë parasysh efektivitetin e kostos dhe efikasitetin operacional të Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021) në lidhje me zhvillimin e kapitalit njerëzor?</p> |
| Qëndrueshmëria: Për të vlerësuar masën në të cilën masat e SKZH-së janë në gjendje të mbahen në të ardhmen. | <p>8. Përafrimi me strategjitë: Në çfarë mase janë të përafruara masat e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021) me strategjitë sektorale dhe strategjitë e tjera përkatëse dhe marrin parasysh situatat në zhvillim e sipër me rreziqe dhe kompromise të mundshme?⁶⁵</p> |
| Sinergjitë: Për të vlerësuar shkallën në të cilën SKZH-ja është e koordinuar nga jashtë me kornizat dhe prioritetet e tjera. | <p>9. Ndërsektorialiteti/sinergjia: Në çfarë mase janë të përafruara masat e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021) me OZHQ-të dhe prioritetet e BE-së?</p> |
| Ndryshimi/ndikimi afatgjatë: Për t'i vlerësuar kontributet e kornizës në | <p>10. Ndryshimet afatgjata: Deri në çfarë mase mund të konsiderohet se Shtylla e Kapitalit Njerëzor e SKZH-së (2016-2021) ka dhënë kontribut në progresin e vërejtur në rritjen e</p> |

⁶³Efektiviteti si parim i OECD -së zakonisht përqendrohet në kontributin e aktiviteteve dhe ndërhyrjeve në rezultatet e menjëhershme. Në kontekstin e këtij vlerësimi, kjo interpretohet si efektiviteti i procesit të zbatimit të SKZH.

⁶⁴Efikasiteti si dimension vlerësimi zakonisht eksploron dy kategori. Së pari, përfundimi në kohë i aktiviteteve të planifikuara dhe së dyti, kosto-efektiviteti i aktiviteteve të zbatuara. Për qëllimet e këtij vlerësimi, kategoria e parë është e integruar në EQ4 nën Efektivitetin duke lënë kategorinë e vetme të dytë për t'u eksploruar në këtë seksion.

⁶⁵TOR jep shembuj të tillë si Strategjia dhe Plani i Veprimit për Arsimin në Kosovë (2017-2021), Strategjia Sektorale e Mirëqenies Sociale (2018-2022), dhe Strategjia e Rinisë (2019-2023) dhe sugjeron eksplorimin e të tjerëve gjatë fazës fillestare.

| | |
|------------------------------------|---|
| ndryshimet e vërejtur në kontekst. | kapitalit njerëzor, përfshirë pasojat e mundshme të ndërhyrjeve në të drejtat dhe barazitë e njeriut? |
|------------------------------------|---|

Metodologjia e vlerësimit

41. Vlerësimi përdori një qasje mikse të metodave, duke u bazuar në tri burime të përgjithshme informacioni në nivele të ndryshme të palëve të interesit: i) **Dokumentacioni** paraprak (p.sh. politikat, raportet e donatorëve, hulumtimet e jashtme); ii) Informacionet **sasiore ose cilësore** paraprake (p.sh. treguesit demografikë të nivelit kombëtar, matja e treguesve të programit, grupet e brendshme të të dhënave); dhe iii) Informacioni **cilësor parësor**. Parimet e pjesëmarrjes, fuqizimit dhe kërkimit vlerësues u integruan në hartimin, mjetet dhe ushtrimet e analizës. Bazuar në pyetjet e vlerësimit, u zhvillua një matricë vlerësimi (Shtojca 5) që përshkruante lidhjet midis informacionit dhe burimeve të analizës të përdorura për t'i identifikuar gjetjet dhe për të arritur përfundime. Detaje të mëtejshme në lidhje me metodologjinë mund të gjenden në Shtojcën 6. Udhërrëfyesit e intervistave për IIK gjenden në Shtojcën 7.
42. Qasja e vlerësimit duhej të rregullohej për të marrë parasysh pandeminë COVID-19 dhe kufizimet pasuese të udhëtimit. Këto kufizime nënkuptuan që vlerësimi u zhvendos në një qasje plotësisht nga distanca, në të cilën të gjitha intervistat – intervistat me informatorë kyç, diskutimet në grupet e fokusit dhe sondazhet – u kryen përmes platformave virtuale. Tri punëtori mësimore me pjesëmarrje fizike u kryen gjatë fazës fillestare dhe fazës fillestare të mbledhjes së të dhënave. Këto kishin për qëllim të siguronin komente kthyes mbi gjetjet dhe vëzhgimet fillestare, të orientonin palët kryesore të interesit në parimet dhe praktikën kryesore të vlerësimit dhe t'i përafrojnë gjetjet e reja për t'i informuar proceset e hartimit të SKZH-së së re aktualisht në zhvillim. Tabela e mëposhtme përmbledh punëtoritë mësimore.

TABELA 5: PËRMBLEDHJE E PUNËTORIVE MËSIMORE

| Data | Titulli | Qëllimi | Pjesëmarrësit |
|-----------------|---|---|---|
| 11 qershor 2021 | Parimet dhe Konceptet e Vlerësimit | Ofrimi i një pasqyre të peizazhit konceptual të vlerësimit dhe aplikimit të mundshëm për Qeverinë. | Kryesisht stafi nga Zyra e Planifikimit Strategjik në Zyrën e Kryeministrit plus përfaqësues të tjerë të Ministrisë nga palët e interesit nga ministritë në KNJ1 të SKZH-së |
| 21 qershor 2021 | Vëzhgimet Paraprake të Vlerësimit të SKZH-së së Kosovës | Ndarja e gjetjeve paraprake dhe rekomandimeve të reja për të dhënë kontributin në diskutimet që lidhen me hartimin e SKZH-së së re. | Kryesisht përfaqësues nga Qeveria dhe Zyra e Kryeministrit të përfshirë në hartimin e SKZH-së së re duke përfshirë konsulentët e përfshirë në shtjellimin e SWOT për shtyllat përkatëse të SKZH-së së re. |
| 1 korrik 2021 | Prezantimi i Raportit Fillestar | Prezantimi i raportit fillestar dhe vërtetimi i vëzhgimeve fillestare nga faza fillestare duke përfshirë rekomandimet paraprake për anëtarët e Grupit Referencë të Vlerësimit | Anëtarët e Grupit Referues të Vlerësimit që përfaqësojnë Zyrën e Kryeministrit dhe ZPS-në si dhe palët e interesit nga ministritë e përfshira në KNJ1, si dhe përfaqësues të donatorëve dhe përfaqësues të agjencive ndërkombëtare. |

43. Ekipi i vlerësimit përbëhej nga dy vlerësues. **Ekipi i vlerësimit po ashtu përcillej nga gjashtë studentë vullnetarë për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve** dhe ngritjen e kapaciteteve për të rinjtë. Studentët vullnetarët morën pjesë në intervistat virtuale, duke mbështetur ekipin vlerësues (EV) me marrje të shënimeve për analizën e të dhënave dhe duke shkruar përshtypjet dhe mendimet e tyre mbi SKZH-në dhe procesin e vlerësimit. Vullnetarët e rinj gjithashtu morën pjesë në sesionet e debriefimit dhe ushtrimet e analizës së të dhënave dhe ndihmuan në përpilimin e përfundimeve dhe rekomandimeve për vlerësimin.

44. Gjatë fazës së grumbullimit të të dhënave, ekipi i vlerësimit intervistoi 56 palë të interesit (65 për qind gra) përmes IIK-ve. Këto palë interesi përfaqësuan larminë e kategorive të palëve të interesit të lidhura me SKZH-në (Shtojca 9). Për secilën IIK, shënimet e vlerësimit u përpiluan në një model të standardizuar të etiketuar nga palët e interesit dhe aktiviteti (Shtojca 7). Pjesa më e madhe e intervistave janë kryer në mënyrë virtuale duke përdorur Skype, Zoom ose thirrje telefonike. Megjithatë, disa IIK u kryen me prezencë fizike nga anëtarët e ekipit me vendbanim në Prishtinë.
45. **Analiza e të dhënave.** Analiza e të dhënave u krye si një grup informimesh (*briefings*) të integruara gjatë gjithë fazës së mbledhjes së të dhënave përmes një kombinimi të ushtrimeve sinkronike dhe asinkronike. Për ushtrimet sinkronike, seanca u mbajtën përmes Zoom-it dhe duke përdorur platformën Mural për organizimin vizual. Në punën asinkronike, anëtarët e ekipit u ftuan të bënin "detyrat e tyre të shtëpisë" në Google Sheets të ngritur kundrejt matricës së vlerësimit dhe në Mural para çdo takimi. Kjo qasje ua mundësoi anëtarëve të kenë kohë për të reflektuar, si dhe për të menduar së bashku.
46. Ekipi i vlerësimit shqyrtoi përgjigjet nga palët e interesit, të dhënat sasiore dhe rishikimin e dokumenteve për të gjeneruar gjetje dhe përfundime kundrejt pyetjeve të vlerësimit të TeR. Të tri llojet kryesore të të dhënave (të dokumenteve, ato sasiore dhe cilësore) kishin menaxhimin dhe analizat e tyre shoqëruese. Metodatat e analizës së të dhënave përdorën analiza sasiore përshkruese dhe krahasuese, analiza narrative tematike, analiza cilësore të të dhënave përsëritëse dhe analizë kontributi. Njësitë kryesore të mendimit u identifikuan në intervista dhe më pas u grupuan në kategori. Temat emergjente nga secila kategori u përzgjedhën për analiza të mëtejshme dhe rikategorizim për t'i identifikuar modelet kryesore. Analiza e të dhënave është detajuar më tej në Shtojcën 6. Të gjitha metodatat u trianguluan si nga brenda ashtu edhe në të gjitha metodatat sipas mundësive.
47. Për shkak të rëndësisë së triangulimit të gjetjeve nga burime të ndryshme, një komponent jetik i analizës së të dhënave ishin debrifimet e analizës në fund të fazës së mbledhjes së të dhënave. Ato u përdorën për të vërtetuar gjetjet dhe për të zhvilluar përfundime dhe rekomandime në përgjigje të pyetjeve të TeR. Triangulimi përfshin krahasimin e informatave nga burime të ndryshme, të mbledhura nga vlerësues të ndryshëm dhe të marra nga metoda të ndryshme.⁶⁶ Në përputhje me parimin e vlerësimit të fokusuar në shfrytëzimin, gjetjet dhe përfundimet fillestare u ndanë me ZPS-në/ZKM-në dhe palët tjera të interesit nga Qeveria e Kosovës si pjesë e punëtorive mësimore të përmendura më herët.
48. **Kufizimet e vlerësimit.** Vlerësimi arriti t'i përmbahej planit dhe metodologjisë së synuar edhe pse kishte disa vonesa për shkak të kalendareve të muajve të verës në Qeveri dhe disponueshmërisë relative të palëve të interesit për intervista. EV beson në qëndrueshmërinë e modeleve të identifikuar dhe rëndësinë e mësimave të nxjerra për të informuar hartimin e SKZH-së re. Kufizimi më i konsiderueshëm i vlerësimit - si dhe një element i rëndësishëm në mësimet e nxjerra - lidhet me disponueshmërinë e informacionit⁶⁷ të menaxhimit në lidhje me zbatimin e masave dhe aktiviteteve të KNJ1 të SKZH-së. Informacioni i menaxhimit ekziston, por është shumë i shpërndarë nëpër Ministri dhe nuk lidhet lehtë me vetë SKZH-në - por më tepër orientohet në strategji të tjera sektoriale, plane pune të qeverisë ose platforma të tjera të Ndihmës. Të dhënat gjithashtu nuk janë lehtësisht të disponueshme për qasje nga përfaqësuesit joqeveritarë. Disponueshmëria e kufizuar e të dhënave sasiore të menaxhimit dhe treguesve të nivelit më të ulët kufizon disponueshmërinë e shkallës në të cilën të dhënat sasiore mund të përdoren në gjetjet. Të dhënat cilësore nga IIK-të arritën të siguronin një pasqyrë të përgjithshme të progresit dhe mund të përdoren për t'i mbuluar disa nga këto boshllëqe. Për më tepër, rëndësia e shfaqur e konsideratave të drejtuara nga procesi dhe

⁶⁶ Shih ALNAP. Evaluation of Humanitarian Action: Pilot Guide, ODI, 2013: 140 për përkufizimet e secilit lloj të triangulimit.

⁶⁷ Monitorimi dhe raportimi i brendshëm nga Qeveria ndaj zbatimit të aktiviteteve dhe masave të KNJ1 të SKZH

konsideratat e menaxhimit arritën të vlerësoheshin përmes të dhënave cilësore të mbledhura në intervista.

3.0 GJETJET E VLERËSIMIT

Vështrim i përgjithshëm

49. Paraqitja e gjetjeve është e strukturuar sipas pyetjeve të vlerësimit të TeR dhe matricës pasuese të vlerësimit. Për qëllime të rrjedhshmërisë në narrativë, disa pyetje të vlerësimit të TeR janë të kombinuara. Kur kjo ndodh, një paragraf hyrës sqaron cilat pyetje po kombinohen dhe logjikën prapa kombinimit. Gjetjet përfaqësojnë triangulimin e burimeve të ndryshme duke përfshirë të dhëna sasiore para-ekzistuese, dokumentacion dhe intervista. Referencat në një burim të caktuar, të tilla si intervistat e informatorëve kryesorë, shtohen për qëllime theksuese ose ilustruese.

Relevanca

50. Ky seksion vlerëson përafrimin e KNj1 të SKZH-së me nevojat ekzistuese të Kosovës, duke përfshirë strategjitë, politikat dhe ndryshimet në kushte. Pyetjet e TeR u përqendruan në tri dimensione - shkalla në të cilën hartimi i KNj1 të SKZH-së ishte i bazuar në dëshmi, i përafruar me nevojat e Kosovës dhe shkalla në të cilën KNj1 e SKZH-së u përshtat me prioritetet e reja. Megjithatë, gjatë intervistave cilësore, u shfaqën tri konsiderata të tjera të relevancës që u panë nga palët e interesit të kishin ndikim të fortë në performancën e KNj1 të SKZH-së. Këto ishin të lidhura me arkitekturën e KNj1 të SKZH-së, rëndësinë e integritetit të SKZH-së në proceset ekzistuese qeveritare (të tilla si buxhetimi, raportimi dhe monitorimi) dhe relevancën e KNj1 të SKZH-së për vetë Qeverinë - shkallën e pronësisë politike të KNj1 të SKZH-së brenda qeverive të Kosovës. Për shkak se këto elemente ndikojnë në qëndrueshmërinë e mundshme të KNj1 të SKZH-së, këto përfshihen në qëndrueshmëri dhe vetëm relevanca e hartimit të KNj1 të SKZH-së mbulohet në këtë seksion.
51. **Nevojat dhe dëshmitë.** Vlerësimi i nevojave të KNj1 të SKZH-së dhe procesi i analizimit të kontekstit kishte qenë i bazuar në dëshmi dhe u bazua në rekrutimin e ekspertizës së jashtme. Rishikimi i dokumenteve identifikoi një numër vlerësimesh që janë zhvilluar si përgatitje para hartimit të KNj1 të SKZH-së. Konsulentët e jashtëm ekspertë zhvilluan shënime të politikave që shërbyen si bazë e zhvillimit në KNj1 të SKZH-së. Ministritë e Linjës kanë dhënë inpute nëpërmjet Grupeve Punuese dhe para aprovimit final janë mbajtur konsultimet publike. Konsensusi i të gjitha palëve të interesit të intervistuar të involvuara në procesin e hartimit gjithashtu konfirmoi këto observime të qasjes rigoroze dhe të bazuar në dëshmi.
52. Dokumentet e politikave që vlerësojnë kontekstin identifikuan një gamë të sfidave sociale, ekonomike, kulturore dhe politike që mund të përdoren për zhvillimin e KNj1 të SKZH-së. Nga kjo gamë e elementeve potenciale, dy temat kryesore të zgjedhura në KNj1 të SKZH-së fokusohen në fuqizimin e sistemit arsimor dhe përmirësimin e aftësive për punësim në mesin e qytetarëve të Kosovës. Punësimi dhe arsimi janë prioritetë relevante për kontekstin e Kosovës të trianguluara nga shënimet e politikave, vlerësimet e tjera të kontekstit të kryera nga BE-ja, Banka Botërore dhe Agjencitë e OKB-së, dhe konsensusi i trianguluar ndërmjet palëve të interesit të intervistuar në të gjitha nivelet, edhe nëse ato nuk kapin tërësinë e sfidave të cituara në analizat e situatës.
53. Ndër shembujt e rëndësisë së këtyre prioritetëve janë rezultatet e ulëta arsimore dhe nivelet e larta të papunësisë. Rezultatet e ulëta të PISA-s për vitin 2015 shërbyen si një njoftim i rëndësishëm i shkallës së mbështetjes së nevojshme për sistemin arsimor për të forcuar performancën arsimore të të rinjve kosovarë që të përputhen me vendet e tjera evropiane. Një nga nxitësit e supozuar të normave relativisht të larta të papunësisë – veçanërisht në

mesin e të rinjve – u lidh me aftësitë e ulëta të punësimit dhe mungesën e lidhjeve midis sistemit arsimor dhe tregjeve të punës. Nuk kishte kundërthënie midis dokumentave dhe intervistave në lidhje me rëndësinë e përmirësimit të cilësisë së sistemit arsimor dhe rëndësinë e rritjes së shkallës së punësimit. Për shembull, raportet vjetore të Komisionit Evropian për Kosovën theksojnë nevojën e vazhdueshme për adresimin e boshllëqeve të aftësive në tregun e punës dhe vazhdimisht theksojnë nevojën për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe rezultateve të arsimit. Raporti i UNICEF-it “Kosova në fazën e hershme të dividendit demografik” theksoi në vitin 2016 se kishte nevojë urgjente për të investuar në kapitalin njerëzor dhe për të rritur punësimin e të rinjve dhe pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Indeksi i Kapitalit Njerëzor të Bankës Botërore për Kosovën në vitin 2018 tregoi një hendek mësimor prej 5.1 vitesh për 18-vjeçarët në Kosovë krahasuar me mesataren evropiane. Studimet e mëvonshme dhe ato bashkëkohore ende konfirmojnë se temat e punësimit dhe arsimit mbi të cilat prioritetet e KNJ1 të SKZH-së janë të bazuara janë akoma relevante brenda shtyllës së KNJ1.

54. **Relevanca e teorisë së nënkuptuar të ndryshimit.** KNJ1 e SKZH-së artikulon teori të nënkuptuar të ndryshimit (TeN) që fokuson shumë masat e saj në temat e punësimit dhe arsimit dhe secila masë e zgjedhur është një rrugë e propozuar për ndryshim me arsyetimin e vet për përfshirje (Tabela 4). Masat e zgjedhura konsiderohen të nevojshme për zhvillimin kombëtar bazuar në studimet e disponueshme, por rrugët e zgjedhura brenda TeN të nënkuptuar për adresimin e këtyre temave gjithëpërfshirëse kanë boshllëqe ose sfida që janë identifikuar gjatë gjithë ciklit të SKZH-së.
55. Për shembull, përsa i përket punësueshmërisë, masat e KNJ1 të SKZH-së fokusoheshin në kontratat joformale dhe kushtet e vendit të punës, por këto janë elemente që lidhen me ata që janë tashmë të punësuar. Politikat e punësimit për rekrutimin e të papunëve në radhët e punësimit mungonin në masat e KNJ1 të SKZH-së. Një shembull tjetër i dalë nga intervistat cilësore vuri në dukje se një nga pengesat kryesore që nuk u theksuan në KNJ1 të SKZH-së kishte të bënte me atraktivitetin relativ të mësimdhënies si opsion karriere. Të intervistuarit raportuan se studentët e universitetit po i jepnin përparësi profesioneve të tjera para mësimdhënies parauniversitare që perceptohej si një opsion vetëm për ata që nuk ishin të kualifikuar për karriera të tjera. Kjo stigmë e perceptuar e lidhur me mësimdhënien parauniversitare u pa si një faktor që i pengoi studentët të zgjedhin këtë profesion – me një efekt kaskadues të mëvonshëm në cilësinë e mësimdhënësve në dispozicion dhe gatishmërinë e mëvonshme të mësimdhënësve për t’u futur në mësimdhënien parashkollore.
56. Jo vetëm që ka boshllëqe brenda masave të përzgjedhura për t’u marrë në konsideratë, por përzgjedhja e masave përjashtoi masat e mundshme që do të ishin të nevojshme për të kontribuar në forcimin e arsimit ose punësimit dhe mungonin dimensione shtesë që do të kishin kontribuar në zhvillimin kombëtar. Për shembull, në nivel të vetë KNJ1 të SKZH-së, u cituan boshllëqe në lidhje me përfshirjen e shëndetit dhe mirëqenies sociale, edhe pse këta tregues përfshihen në treguesit e nivelit makro si pjesë e treguesit të indeksit të zhvillimit njerëzor nën kohezionin social. Indeksi i zhvillimit njerëzor është një statistikë e përbërë që vlerëson cilësinë e përgjithshme të jetës dhe përfshin shëndetin, barazinë gjinore, arsimin dhe përfshirjen sociale brenda kornizës së saj.
57. Tabela e mëposhtme përmbledh disa nga boshllëqet kryesore si brenda masave të përzgjedhura ashtu edhe midis masave të përzgjedhura që mungojnë nga TeN e nënkuptuar.

| Sfidat apo boshllëqet brenda masave | | | |
|---|---|--|---|
| Masa | Fokusi primar | Arsyetimi | Sfida apo boshllëqe |
| Masa 1: Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore | Ndërtimi i kopshteve publike, licencimi i institucioneve private, rishpërndarja dhe trajnimi i mësuesve parashkollore | Kjo do të mundësojë sukses më të mirë në nivelet më të larta të arsimit, do të ul pabarazinë dhe rritë pjesëmarrjen e grave në | Qasja në kopshte varet shumë nga fakti nëse familjet janë në vende urban dhe nga nivelet e pasurisë. Familjet më të pasura kanë 15 herë më shumë gjasa të |

| | | | |
|--|---|---|--|
| | | tregun e punës. Fëmijët mund të mësojnë ndërsa nëna e tyre është duke punuar | kenë fëmijë në institucionet parashkollore sesa fëmijët e varfër. ⁶⁸ |
| Masa 2: Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në sistemet fillore dhe të mesme | Përditësimi i teksteve shkollore dhe i kurrikulës, proceset e parakualifikimit të mësuesve, përmirësimi i trajnimit të mësuesve | Ky është parakusht për sukses më të mirë të sistemit arsimor dhe forcimin e aftësive të të rinjve për tregun e punës. Ndërsa mësuesit bëhen më të kualifikuar, cilësia e arsimit të marrë nga fëmijët duhet të përmirësohet. | Perceptimi i mësimdhënies si opsion jo tërheqës karriere për shkak të pagës, kushteve të punës dhe stigmës. |
| Masa 3: Përmirësimi i korrelacionit ndërmjet nevojave të arsimit dhe tregut të punës | Theksimi mbi AAP-në duke përfshirë qendrat e trajnimit profesional, praktikat e biznesit të QAP-së, parashikimin kombëtar të aftësive | Kjo do të kontribuojë në uljen e papunësisë dhe promovimin e rritjes së industrive kosovare. Prandaj studentët nga shkollat profesionale apo universitetet duhet ta kenë më të lehtë të punësohen pas përfundimit të studimeve si dhe punë praktike gjatë studimeve të tyre.. | Nevojat e AAP-ve evoluojnë shpejt dhe kurrikulat dhe pajisjet duhet të përditësohen vazhdimisht – nuk ka mekanizma për rregullime dhe fleksibilitet për të shmangur jorelevancën. Studimet tregojnë disponueshmëri të kufizuar të punëtorëve për pozicionet ekzistuese edhe pse shkalla e lartë e papunësisë (duke sugjeruar mospërputhje midis aftësive dhe kërkesave të tregut të punës). |
| Masa 4: Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit në sistemin arsimor | Testimi i standardizuar i studentëve, inspektoratet arsimore, standardet dhe rishikimi i performancës së mësuesve | Nëse shkollat dhe mësuesit mbahen përgjegjës për punën e tyre dhe shpërblehen për cilësinë e punës së tyre - kjo do të përmirësojë cilësinë e arsimit të marrë nga fëmijët. | Mësuesit dhe shkollat kanë nevojë për shërbime të përmirësuara për performancë pozitive arsimore (akses në internet, kompjuterë, madhësi të reduktuar të klasave, infrastrukturë të mirë mësimore, etj.). Orientimi i mësuesve drejt kurrikulës së re, teksteve shkollore, sistemeve të menaxhimit të informacionit dhe pedagogjisë alternative me në qendër nxënësin e kërkuar si pararendës për përgjegjshmërinë dhe certifikimin e performancës. |
| Masa 5: Planifikimi i përmirësuar i shpenzimeve në sistemin arsimor | Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit, zhvillimi i sistemit të AAP-së, partneritete publiko-private | Kjo do të rrisë efikasitetin e sistemit arsimor dhe do të mundësojë kursime në buxhetin e shtetit duke devijuar fondet nga zonat me prioritet më të ulët në ato me prioritet më të lartë.. | Ngurrimi i palëve të interesuara në arsim për të përdorur sistemet e menaxhimit dhe përgjegjësia e kufizuar për zbatimin e përdorimit të sistemit. |
| Masa 6: Rekrutimi i ekspertëve të diasporës | Rekrutimi i ekspertëve të diasporës, bursa për angazhim akademik | Punësimi formal lejon mbrojtje më të mirë të punëtorëve dhe avancime më të strukturuar. Punëtorët duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga pensionet, të kenë qasje më të mirë në kredi dhe të punojnë në kushte më të mira pune. | Theksi në sjelljen e diasporës, por fokus i kufizuar në mbrojtjen e burimeve ekzistuese njerëzore nga presionet për migrimin masiv. |

⁶⁸ Sipas Anketës së Grupimeve me Tregues të Shumëfishtë (MICS) 2020 (Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF).

| | | | |
|---|---|---|---|
| Masa 7: Ulja e nivelit të punësimit informal dhe krijimi i kushteve adekuate të punës | Reduktimi i punësimit joformal, rritja e cilësisë së inspektimeve të punës, përmirësimi i kushteve në vendin e punës | Kjo do të mundësojë transferimin e aftësive dhe njohurive të fituara nga komuniteti i diasporës jashtë vendit për zhvillimin kombëtar të Kosovës dhe forcimin e lidhjeve me vendlindjen e tyre. Ekspertët e teknologjisë mund të mbështeten financiarisht gjatë zhvillimit të projekteve për institucionet e Kosovës apo kompanitë private për prodhim afatgjatë. | Mungojnë politikat e punësimit. Masat adresojnë ata që janë tashmë të punësuar. Orientimi i Masës është punësimi në firmat e mëdha, një theks relativisht i vogël në promovimin dhe lehtësimin e shfaqjes së bizneseve të vogla përmes trajnimeve ose stimujve. Relativisht pak theks në tërheqjen e investimeve të huaja në biznes megjithëse ky është prioritet i rëndësishëm |
| Sfidat ose boshllëqet midis masave të përzgjedhura | | | |
| Dimensionet | Masat e Përfshira | Mangësitë midis masave | |
| Arsimi | <ul style="list-style-type: none"> Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit në sistemin arsimor Përmirësimi i shpenzimeve në planifikim në sistemin arsimor | <p>Qasje bazuar në renditjen urbane/rurale dhe të pasurisë</p> <p>Përmirësime në infrastrukturën standarde arsimore</p> <p>Forcimi i kapaciteteve njerëzore për qasjet pedagogjike, menaxhimin e informacionit apo të menduarit kritik.</p> | |
| Punësimi | <ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i korrelacionit ndërmjet aftësive të fituara në arsim dhe nevojave të tregut të punës Niveli i ulur i punësimit joformal Rekrutimi konkret i ekspertëve dhe studentëve të diasporës | <p>Politika e punësimit, Trajnim për ndërmarrësi</p> <p>Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme – politika, kredi, grante</p> <p>Investimet e huaja</p> | |
| Tjera | Masat e shëndetit, mbrojtjes sociale dhe kohezionit social nuk janë përfshirë | Masat e shëndetit, mbrojtjes sociale dhe kohezionit social nuk janë përfshirë | |

58. Kulmi i rishikimit të TeN të nënkuptuar tregon boshllëqe si brenda ashtu edhe midis masave dhe dimensioneve të zgjedhura që çojnë në një shteg jo të plotë ndryshimi për KNj1 të SKZH. Elementet që përzgjidhen konsiderohen **të nevojshëm** për zhvillimin kombëtar të arsimit dhe punësimit, por nuk janë **të mjaftueshëm** për të përfshirë tërësinë e konsideratave që duhet të përfshihen në një TeN të nënkuptuar për të arritur rezultatet e nivelit makro.

59. Kjo lloj strukture "boshllëku" e KNj1 të SKZH-së është e qëllimshme në dizajn, sepse KNj1 e SKZH-së (dhe SKZH në përgjithësi) u përcaktua si një prioritet i prioriteteve kryesore për zhvillimin kombëtar. Konkretisht, prioritetet e përzgjedhura për përfshirje ishin ato që parashikohej se mund të tërhiqnin fonde nga donatorët ose që ishin në përputhje me interesat e donatorëve. KNj1 e SKZH-së shërbeu si mjet për organizimin dhe tërheqjen e fondeve nga donatorët, por pasojat e padëshiruara për marrjen e një qasjeje të priorizimit të prioriteteve janë eksploruar më tej në seksionin e qëndrueshmërisë.

60. **Përshtatja dhe pozicionimi.** Nuk kishte asnjë provë nga intervistat apo dokumentacioni se KNj1 e SKZH-së përshtati masat ose aktivitetet e saj gjatë gjithë ciklit për të adresuar këto boshllëqe ose për t'i integruar prioritetet e reja në zhvillim. Në një masë të madhe, kjo ishte për shkak të mungesës së mekanizmave ose proceseve brenda KNj1 të SKZH-së për të lejuar përshtatje.
61. Në momentin e hartimit, dokumenti i SKZH-së vuri në dukje se dokumenti duhet parë si një dokument i gjallë për t'u plotësuar gjatë viteve të ardhshme përmes politikave dhe strategjive specifike sektoriale. Megjithatë, nuk kishte përshkrime të mekanizmave ose pikë referimi që do të përdroreshin për rregullimin e KNj1 të SKZH. Për shembull, procesi i KNj1 të SKZH-së kishte rishikim afatmesëm për përcjelljen e progresit të treguesve të identifikuar, por nuk kishte rishikim afatmesëm periodik të mandatuar për vlerësimin e nevojave dhe prioritetëve të Kosovës ose ndryshimit të rrethanave (si migrimi masiv, fatkeqësitë natyrore, ose pandemitë) dhe mekanizmat pasues për mbledhjen e vendimmarrësve për të shqyrtuar dhe miratuar prioritetet dhe masat e reja bazuar në këto rishikime. Si rezultat, SKZH-ja u bë një dokument relativisht statik dhe jo një strategji evoluese.
62. Për më tepër, fleksibiliteti i KNj1 të SKZH-së ishte penguar paqëllimshëm për shkak të shtjellimit të planit të veprimit të KNj1 të SKZH-së në vitin 2017. Kur SKZH-ja u zhvillua në vitin 2016, ajo u përqendrua në përshkrimin e katër shtyllave dhe masave brenda shtyllave. Megjithatë, KNj1 të SKZH-së i mungonte udhëzimi i mjaftueshëm në përshkrimin e mënyrës se si rrugët për ndryshim - aktivitetet të cilat do të qonin në arritjen e këtyre masave - si dhe planet operationale për arritjen e këtyre masave. Si rezultat, në vitin 2017 u zhvillua plani i veprimit i KNj1 të SKZH-së. Kjo përfshinte një shtjellim të mëtejshëm të aktiviteteve që do të trajtoheshin nën secilën masë, një përshkrim të ministrive të cilat ishin përgjegjëse për këto aktivitete, dhe një lidhje me strategjinë sektoriale përkatëse dhe kornizën e shpenzimeve. Plani i veprimit përfshiu gjithashtu një përshkrim të detajuar të kostimit që përshkruan kontributet e pritshme relative për zbatimin e çdo aktiviteti nga qeveria, donatorët, ose për t'u kërkuar. Treguesit kyç të performancës u lidhën me secilin aktivitet dhe nënaktivitet për të siguruar një kornizë të plotë të rezultateve të performancës.
63. Plani i veprimit i KNj1 të SKZH-së kishte për qëllim të siguronte një udhërrëfyes operacional për t'i udhëzuar ministrinë (dhe donatorët) se si të arrihen masat e synuara brenda KNj1 të SKZH-së. Megjithatë, ka pasur një lansim relativisht të heshtur të planit të veprimit të KNj1 të SKZH-së pas shtjellimit të tij dhe shumë palë interesi në ministrinë qeveritare – veçanërisht ato që kishin kaluar në pozicionet e tyre pas hartimit të KNj1 të SKZH-së – nuk ishin në dijeni të planit të veprimit të KNj1 të SKZH-së ose të detyrimeve të tyre brenda tij. Palët e tjera të interesit pohuan se plani i veprimit i KNj1 të SKZH-së, duke qenë i plotë dhe i detajuar, de fakto kishte evoluar në një kornizë të zbatimit të projektit dhe jo në një strategji kombëtare për zhvillim. Për shkak të nivelit të detajeve në aktivitete, plani i veprimit i KNj1 të SKZH-së nuk u zhvendos lehtë për t'i absorbuar interesat e reja ose mundësitë e reja. Si i tillë, ai u konsiderua se i shërbente efektit të padëshiruar të zvogëlimit të përshtatshmërisë së mundshme të SKZH-së dhe gradualisht u bë më pak i rëndësishëm për nevojat gjatë tranzicioneve të qeverisë.
64. Relevanca e KNj1 të SKZH-së në kuadër të proceseve qeveritare. KNj1 të SKZH-së ishte krijuar në dizajnin e saj për t'i prioritetuar prioritetet brenda qeverisë së Kosovës. Brenda bollëkut të nevojave dhe drejttimeve të propozuara nga të gjitha strategjitë e Qeverisë, cilat ishin ato që do të kishin më shumë prioritet për sa i përket mbështetjes së donatorëve dhe zhvillimit të strategjisë sektoriale?
65. Ndonëse prioritetet e identifikuar në KNj1 të SKZH-së janë nevoja, një pasojë e kësaj qasjeje është se KNj1 e SKZH-së u bë më shumë një mjet për të synuar boshllëqet në shërbimet ekzistuese sesa të shërbejë si një busull strategjike për të orientuar strategjitë sektoriale. Siç u theksua në seksionin e mëparshëm, grupi i masave në KNj1 të SKZH-së nuk përfshin kornizë gjithëpërfshirëse, por nga të intervistuarit shihen si nënvizim i fushave të

veçanta të nevojave. Temat perceptohen universalisht si ende relevante, por mënyra se si KNj1 e SKZH-së u përqendrua në tema specifike reduktoi pa dashje rëndësinë për ministritë. KNj1 e SKZH-së ka më pak kapacitet për të shërbyer si një strategji ombrellë për të orientuar ministritë në zhvillimin e strategjive të tyre sektoriale, por u bë pothuajse një listë kontrolli e aktiviteteve që mund të përfshihen në një strategji sektoriale.

66. Në kohën e zhvillimit të KNj1 të SKZH-së, ekzistonte një njohje e vazhdueshme që qeveria vuante nga ekzistenca e shumë strategjive. Raporti i SIGMA-s në vitin 2017 vuri në dukje se në rajon, Kosova ishte në mesin e atyre me numrin më të madh të dokumenteve të planifikimit qendror, duke e bërë të vështirë sigurimin e planifikimit koherent dhe konsistent – duke çuar në një ngecje në zbatimin e këtyre strategjive. SKZH-ja u pa se kishte potencialin për të luajtur një rol në krijimin e një mjedisi strategjik më të ndërlidhur dhe reduktimin ose racionalizimin e strategjive. Kjo u pa më shpesh në intervistat e palëve të interesuara, ku të intervistuarit sugjeruan se korniza e KNj1 të SKZH-së do të ishte më e rëndësishme nëse do të ndërtohej për të shërbyer më shumë si një busull strategjike ose një "strategji strategjish" - për t'u bërë një kornizë për të informuar përpunimin e mëvonshëm të strategji më të detajuara ministrore.
67. Një shqetësim i dytë në lidhje me rëndësinë e kornizës së KNj1 të SKZH-së lidhej me orientimin e rritjes ekonomike të KNj1 të SKZH-së të përgjithshme. Të katër shtyllat fokusohen pothuajse ekskluzivisht në atë që mund të nxisë rritjen ekonomike. Të dhënat cilësore vunë në dukje se edhe termi "kapital njerëzor" nënkupton se njerëzit po shërbejnë si lëndë djegëse për ekonominë. Si pasojë, arkitektura e KNj1 të SKZH-së është më pak e rëndësishme për integrimin e formave të tjera të zhvillimit njerëzor, të tilla si shëndeti, ose shqetësimet e barazisë dhe qasjes. Kishte një pajtim pothuajse universal midis të intervistuarve, e vërtetuar nga raportet bashkëkohore duke përfshirë rishikimin afatmesëm të SKZH-së, se KNj1 e SKZH-së do të ishte më e rëndësishme për zhvillimin kombëtar nëse do të kishte një zhvendosje nga rritja e pastër ekonomike drejt një qasjeje të zhvillimit të qëndrueshëm dhe integrimi i temave ndërsektoriale që lidhen me gjininë, barazinë dhe përfshirjen në të gjitha shtyllat dhe aktivitetet pasuese.
68. Si pasojë, orientimi i rritjes dhe fokusit të prioritizimit të prioriteteve të arkitekturës së KNj1 të SKZH-së nënkuptonte se përderisa elementet e përfshira në KNj1 të SKZH-së janë **të nevojshme** për kontekstin e Kosovës, ato nuk janë **të mjaftueshme** për adresimin e nevojave të kontekstit të Kosovës. Implikimet e mëtejshme të arkitekturës së KNj1 të SKZH-së për formësimin e performancës së KNj1 të SKZH-së janë eksploruar më në detaje në Seksionin 3.6 (ndikimi afatgjatë).

Efektiviteti dhe ndryshimi afatgjatë

69. Në TeR, seksioni i efektivitetit vlerëson shkallën në të cilën janë zbatuar aktivitetet dhe ndërhyrjet e KNj1 të SKZH-së. Seksioni i efektivitetit mbulon arritjet e objektivave dhe cageve duke përfshirë shkallën e integritit gjinor brenda KNj1 të SKZH-së. Seksioni i ndryshimit afatgjatë eksploron shkallën në të cilën KNj1 e SKZH-së mund të konsiderohet se ka dhënë një kontribut në progresin e vërejtur në kapitalin njerëzor, përfshirë kontributet e mundshme të ndërhyrjeve në të drejtat dhe barazitë e njeriut. Për shkak se këto dy seksione janë të lidhura (zbatimi dhe më pas kontributet), këto dy seksione janë të kombinuara. Së pari, seksioni i efektivitetit profilizon progresin e KNj1 të SKZH-së në zbatimin e aktiviteteve dhe masave. Kontributi i mëvonshëm i performancës së aktiviteteve dhe masave të zbatuara në ndryshimet në nivel kombëtar përshkruhet më pas përmes rishikimit të treguesve të nivelit makro dhe lidhjeve të mundshme me kontributet e KNj1 të SKZH-së.

Performanca e masave dhe aktiviteteve

70. **Treguesit e progresit të KNj1 të SKZH-së:** Ekzistojnë tri nivele të treguesve të performancës në SKZH: Treguesit ekonomikë të nivelit makro (për tërë SKZH-në, dhe jo

vetëm masën 1), treguesit specifikë të masave dhe treguesit e nivelit të aktiviteteve. Këta janë të përafuar me qëllimin, rezultatit dhe outputin e kornizës së performancës. Treguesit e nivelit makro përfaqësojnë ndryshime në demografinë sociale. Treguesit specifikë të masave pasqyrojnë ndryshimet në sjelljet individuale ose organizative. Treguesit e nivelit të aktiviteteve përfaqësojnë ndryshimet në procedurat ose materialet që duhet të çojnë në ndryshimin e sjelljes dhe gjurmohen si tregues kyç të performancës (TKP). Seksioni i efektivitetit i gjurmon dy nivelet e fundit - treguesit specifikë të masave dhe TKP-të e KNJ1 të SKZH-së për performancën e aktiviteteve. Kontributet e nivelit makro përshkruhen në seksionin Ndryshimi afatgjatë.

71. **Performanca e aktiviteteve.** Brenda shtyllës së kapitalit njerëzor, plani i veprimit i SKZH-së përshkruan 32 aktivitete të lidhura me shtatë masat. Në rishikimin afatmesëm të vitit 2018, ushtrimi identifikoi se 66 për qind e aktiviteteve kishin qenë në progres të mirë sipas kalendarit të planit të veprimit të SKZH-së në atë kohë. Sidoqoftë, asnjë rishikim i mëvonshëm nuk është kryer që nga viti 2018 në nivelin e aktiviteteve individuale.
72. Për qëllimet e këtij raporti, treguesit kyç më të detajuar të performancës përdoren për të gjurmuar progresin. Ekzistojnë 101 tregues kyç të performancës në planin e veprimit të KNJ1 të SKZH-së që synojnë të gjurmojnë progresin e aktiviteteve përkatëse. Tabela e mëposhtme tregon performancën e KNJ1 të SKZH-së kundrejt këtyre TKP-ve përmes një vlerësimi sipas ngjyrave të semaforit të kryer në korrik 2021. Ngjyra e gjelbër do të thotë progres i mirë ose përfunduar, e verdha do të thotë njëfarë progresi, e kuqja do të thotë progres i kufizuar ose nuk ka progres fare (apo nuk ka të dhëna në dispozicion) në TKP-të përkatëse. Vlerësimet u bazuan në përmbledhjet e monitorimit të brendshëm të ZPS-së të ndara me EV në dosjet excel të plotësuara nga raportet e donatorëve, raportet e Ministrisë dhe intervistat me palët kryesore të interesit.

TABELA 6: AKTIVITETET E KNJ1 TË SKZH-SË – PROGRESI I TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS

| Aktivitetet | Treguesit kyç të performancës | Vlerësimi |
|---|--|-----------|
| Masa 1: Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore | | |
| 1.1 Rritja e numrit të kopshteve publike | Ndërtimi i kopshteve publike | |
| | Punim kërkimor mbi situatën dhe kostimin e regjistrimit të fëmijëve 3-6 vjeç në sistemin arsimor | |
| 1.2 Rritja e përfshirjes së institucioneve private | Projektligji për përmirësimin e kornizës ligjore për ZhFH (ligji për fëmijët parashkollorë) | |
| | Licencimi i institucioneve private parashkollore | |
| 1.3 Optimizimi i personelit mësimdhënës përmes rialokimit prej niveleve më të larta (arsimi fillor) | Vlerësimi i numrit të mësimdhënësve për planin e rishpërndarjes në institucionet arsimore | |
| | Mësimdhënësit e trajnuar për të punuar në institucionet arsimore si mësimdhënës mbështetës për nxënësit me nevoja të veçanta | |
| | Mësimdhënës që do të punojnë me fëmijët në nevojë dhe trajnimi i tyre | |
| Masa 2: Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në sistemin e arsimit fillor dhe të mesëm | | |
| 2.1 Rishikimi dhe përfundimi i procesit të kualifikimit të mësimdhënësve para futjes në shërbim | Zhvillimi profesional i mësimdhënësve para fillimit të shërbimit | |
| | Zbatimi i sistemit të gradimit në procesin e licencimit të mësimdhënësve dhe reflektimi i efekteve financiare në sistemin e pagave | |
| 2.2 Optimizimi i numrit të mësimdhënësve ekzistues duke e pasur për kriter cilësinë | Ndryshimi i bazave ligjore për zhvillimin profesional të mësimdhënësve (ZhPM) | |
| | Nërtimi i mekanizmave për zbatimin e kornizës strategjike për ZhPM | |
| | Ngritja e kapaciteteve të shkollës për vlerësimin e performancës | |
| | Realizimi i planit dinamik të VPM ndër vite bazuar në ligjin e inspektoratit | |

| | | |
|--|--|--|
| 2.3 Përshpejtimi i ZhPM-së | Mbështetje për ETF-në për shkollat e të mësuarit të të rriturve dhe agjencinë e AAP-së për AutoCAD, 2D | |
| | Akreditimi i programeve të trajnimit të mesimdhënësve | |
| | Trajnimi i menaxhmentit të drejtimeve shkollore, për leadership si dhe për kurrikulë | |
| 2.4 Zgjerimi i miratimit të kurrikulës së re në shkollat e mbetura | Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulave lëndore parauniversitare | |
| | Zhvillimi dhe pilotimi i kurrikulës së re për nivelin parashkollor dhe parafillor | |
| | Trajnimi i mesimdhënësve për zbatimin e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës | |
| 2.5 Rishikimi i teksteve shkollore dhe zhvillimi i teksteve të reja shkollore | Ndryshimi i ligjit për tekstet shkollore dhe mjetet mësimore. Udhëzimi Administrativ i prodhuar | |
| | Zhvillimi i teksteve të reja shkollore | |
| Masa 3: Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathtësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës | | |
| 3.1 Përshpejtimi i procesit të zhvillimit të standardeve profesionale | Zhvillimi i standardeve të profesioneve | |
| | Dokumenti i klasifikimit të profesioneve të miratuara (MPMS) | |
| 3.2 Përcaktimi i fushave me prioritet të lartë në aftësimin profesional dhe arsimor (AAP) dhe zhvillimi i kurrikulave bërthamë | Rritja e numrit të qendrave për këshillim dhe orientim në karrierë | |
| | Zhvillimi i kurrikulave të reja për AAP-në dhe konvertimi në formë modulare (MASHT) | |
| | Krijimi dhe mbështetja e kabineteve të trajnimit | |
| 3.3 Zbatimi i sistemit pilot të kombinuar të AAP-së | Trajnimi i kandidatëve në QAP-kompani | |
| | Trajnimi i aftësive të buta i mbështetur nga GIZ | |
| | Sigurimi i pajisjeve për punëtoritë për AAP-të | |
| | Marrëveshje të Praktikës Profesionale me biznesin për praktika | |
| | Hartimi i materialeve të mesimdhënësve për profilet prioritare | |
| | Koncept shënim për AAP-në | |
| | Zhvillimi i programeve aktive të tregut të punës | |
| 3.4 Zhvillimi i Sistemit Kombëtar të Parashikimit të Shkathtësive | Pjesëmarrja e nxënësve në programet e shkëmbimit të praktikave | |
| 3.5 Ndëridhja e punës hulumtuese në universitete me Industrinë përmes qasjes së specializimeve të mençura dhe R&D | Pjesëmarrja e aplikantëve në programin Horizon 2020 | |
| | Skema e Inovacioneve VOUCHER për NVM-të dhe Bizneset | |
| | Bursat për studime universitare dhe pasuniversitare të huaja | |
| | Zhvillimi i kornizës ligjore për inovacionin dhe hulumtimin shkencor | |
| | Ngritja e kapaciteteve në hulumtim dhe inovacion | |
| | Mobiliteti ndërkombëtar (CEEPUS) | |
| | Analiza e nevojave të shkathtësive dhe trajnimit (HERAS) | |
| | Krijimi i këshillave të Universitetit për bashkëpunim industrial | |
| Masa 4: Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit në sistemin arsimor | | |
| 4.1 Rritja e kapaciteteve të Këshillit Kombëtar të Cilësisë | Plotësimi i anëtarësisë në KSHC | |
| | Plotësimi i kornizës rregullatore për procesin e akreditimit | |
| | Kryerja e studimit të fizibilitetit për IAL-të | |
| | Angazhimi i ekspertëve ndërkombëtarë për monitorimin e IAL-ve | |
| Aktiviteti 4.2 Zbatimi i një testi përfundimtar më të besueshëm për nxënësit | Realizimi i testit për klasën 5 me mostra për kriteret e zgjedhura | |
| | Realizimi i testit për klasën e 9-të | |
| | Realizimi i testit për klasën e 12-të | |
| | Pilotimi i PISA-s | |
| | Ngritja e kapaciteteve të Divizionit të Standardeve përmes projektit të BB | |

| | | |
|--|---|--|
| 4.3 Provimi përfundimtar i përmirësuar për profesionet e rregulluara | Zhvillimi i kornizës legislative për Agjencinë për Standarde dhe Vlerësim | |
| | Themelimi i Agjencisë për Standarde dhe Vlerësim | |
| | Themelimi i Këshillit Shtetëror për Profesionistët e Rregulluar | |
| | Hartimi i provimeve finale të profesionistëve të rregulluar | |
| 4.4 Zgjerimi i sistemit të inspektimit në arsim dhe VPM | Miratimi i Ligjit për Inspektoratin Arsimit | |
| | Inspektorët e Arsimit të emëruar dhe të trajnuar | |
| | Rishikimi i procedurave të monitorimit pas akreditimit | |
| | Forcimi i Këshillave të Prindërve | |
| | Trajnimi i drejtorëve të shkollave për menaxhim | |
| | Mekanizmi i inspektoratit funksionon në të gjitha shkollat | |
| 4.5 Përmirësimi i cilësisë dhe llogaridhënies së institucioneve | Zhvillimi i UA-së për Agjencinë e Standardeve | |
| | Zhvillimi i softuerit të sistemit të integruar të akreditimit dhe digitalizimi | |
| | Rritja e transparencës së IAL-ve përmes publikimit të materialeve në faqet e tyre të internetit | |
| | Ndërtimi i një sistemi monitorimi të ofruesve të AAP-së | |
| | Pilotimi dhe zbatimi i procesit të njohjes së mësimit paraprak | |
| 4.6 Zhvillimi i sistemit të vlerësimit të performancës së mësimit dhe sistemit të gradimit të mësimit | Inspektorët e VPM-së u trajnuan | |
| | Themelimi i Agjencisë për Standarde | |
| Masa 5: Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin arsimor. | | |
| 5.1 Zhvillimi i një masterplani për rrjetet e shkollave AAP | Zhvillimi i analizës së përputhshmërisë | |
| | Ridizajnimi i rrjetit të shkollave të AAP-së | |
| 5.2 Krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL) dhe sistemeve të tjera | Funksionalizimi i sistemit SMIAL | |
| | Përmirësimi i SMIA-s ekzistuese | |
| 5.3 Rritja e financimit për programet e arsimit profesional dhe arsimin e lartë | Rishikimi i formulës së financimit për përcjelljen e financimit në fusha më prioritare | |
| | Plotësimi i kornizës ligjore për arsimin e lartë. Hartimi i UA | |
| 5.4 Pilotimi i Modelit të Partneriteteve Publiko-Private | Rishikimi i kornizës ligjore për partneritetet publiko-private | |
| | Ndërmarrja e iniciativave PPP për t'i mbështetur shkollat publike | |
| Masa 6: Rekrutimi i ekspertëve dhe studentëve të diasporës për angazhimin në tregun e punës. | | |
| 6.1 Krijimi i një baze të dhënash për identifikimin e profileve të diasporës | Baza e të dhënave është krijuar. | |
| | Numri i ekspertëve të regjistruar | |
| 6.2 Krijimi i Programit për Angazhim në Atdhe (PAA) | Ekspertë të diasporës të angazhuar për ngritjen e kapaciteteve | |
| | Konferencë me ekspertë të ndryshëm të diasporës | |
| | Diaspora ndjek universitetet e Kosovës | |
| | Praktika profesionale për diasporën | |
| 6.3 Zbatimi i Programit për Kthimin e Ekspertëve të Qeverisë së Gjermanisë | Angazhimi i ekspertëve me diasporën që është në Gjermani | |
| 6.4 Zbatimi i programit TOKTEN | Marrëveshja e lidhur me UNDP-në | |
| | Angazhimi i ekspertëve të diasporës përmes TOKTEN | |
| 6.5 Krijimi i programit të mësimit online | Zhvillimi, pilotimi dhe funksionalizimi i programit të mësimit online për diasporën | |

| Masa 7: Zvogëlimi i nivelit të punësimit joformal dhe krijimi i kushteve të përshtatshme të punës | | |
|--|---|--|
| 7.1 Forcimi i dialogut të institucioneve me partnerët socialë | Miratimi i Ligjit për Ndryshimin e Ligjit për Këshillin Socio-Ekonomik (KSE) | |
| | Miratimi i Strategjisë së KSE-së | |
| | Faqja e internetit e KSE-së është funksionale | |
| 7.2 Përmirësimi i të drejtave të punëtorëve dhe garantimi i standardit minimal të sigurisë dhe shëndetit në punë | Projektligji për inspektoratin e punës | |
| | Plotësimi i kornizës ligjore për kontratat e punës dhe sigurinë | |
| | Certifikimi i punonjësve të sigurisë në terren | |
| | Licencimi i kompanive që kryejnë siguri në terren | |
| | Trajnimi i inspektorëve të punës në fushën e sigurisë në terren | |
| | Fushata ndërgjegjësimi për sigurinë | |
| 7.3 Forcimi i mekanizmave dhe koordinimi i institucioneve që synojnë punësimin joformal | Zhvillimi i MM-ve me institucionet që mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit ose organizatat e biznesit për reduktimin e punësimit joformal | |
| | Trajnimi i inspektorëve mbi legjislacionin në lidhje me punësimin joformal | |
| | Përmirësimi i procedurave të inspektimit për të rritur inspektimet për punësim joformal | |
| | | |
| 7.4 Krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Inspektoratin e Punës | Sistemi i informacionit i krijuar | |
| | Punonjësit e Inspektoratit të Punës (IP) të trajnuar për sistemin e informacionit | |
| | Uebfaqja e Inspektoratit të Punës funksionale | |

73. Nga 101 TKP, 23 kanë bërë progres të mirë, ose janë përfunduar, 30 kanë pasur njëfarë progresi ndërsa 48 u vlerësuan me progres të limituar apo ende pa progres. Normat relativisht të ulëta të zbatimit të plotë triangulohen edhe me studime të tjera mbi politikat sektoriale. Për shembull, një raport i KEC në vitin 2020 mbi zbatimin e politikës sektoriale të arsimit në Kosovë (PSAK) raportoi se nga 264 masat në kuadër të PSAK-së, vetëm 19 ishin arritur plotësisht (7%).
74. Masat dhe aktivitetet që kanë shkallën më të lartë të suksesit janë ato të cilat kanë marrë burime nga mbështetja e donatorëve. Për shembull, dy masat në kuadër të KNj1 të SKZH-së me përqindjen më të madhe të TKP që raportuan të paktën njëfarë progresi ishin Masa 1 (institucionet parashkollë) dhe Masa 3 (Lidhjet e tregut të punës). Të dy raportuan se 71 përqind e IKP-ve të tyre kishin pasur njëfarë progresi. Të dyja këto masa morën mbështetje të konsiderueshme nga donatorët për zbatimin e aktiviteteve – veçanërisht Masa 3 në lidhje me mbështetjen e qendrave të formimit profesional-teknik të cilat morën mbështetje thelbësore nga donatorët për zbatimin.
75. Edhe në këto 'masa të suksesshme', boshllëqet në progres prireshin të ishin për ato aktivitete që nuk kishin marrë mbështetje nga donatorët dhe vareshin nga burimet e qeverisë kombëtare. Për shembull, në Masën 3, boshllëqet më të mëdha ishin për zhvillimin e sistemit kombëtar të parashikimit të aftësive (aktiviteti 3.4) dhe lidhja e punës kërkimore në universitete me industrinë (aktiviteti 3.5). Në Masën 1, ndërtimi i kopshteve publike dhe kornizat ligjore kanë progres, por boshllëqet më të mëdha u përkasin përpjekjeve të trajnimit dhe rishpërndarjes së mësimdhënësve për t'i mbështetur këto institucione parashkollë.
76. Shkalla e implementimit e masave që tërhoqën projekte të konsiderueshme të financuara nga donatorët ishte më e lartë se e atyre që mbështeteshin më gjerësisht në financimin e qeverisë për tri arsye. Së pari, projektet e financuara nga donatorët prireshin të kishin procese të ndara planifikimi duke përfshirë zhvillimin e objektivave, përcaktimin e përgjegjësive specifike për zbatimin dhe zhvillimin e një afati kohor të strukturuar për zbatim. Së dyti, projektet e financuara nga donatorët në kuadër të masave kishin kornizë specifike burimesh ku fondet për aktivitetet e projektit alokoheshin dhe destinoheshin për përdorim specifik edhe nëse vinin nga qeveria. Së fundi, proceset e raportimit ishin të rregullta, të fokusuara në mënyrë

specifike në aktivitetet e përshkruara të projektit, me faktorë të ofruar për çfarëdo vonesa në zbatim.

77. Kjo dinamikë e një entiteti mbikëqyrës që kërkon arsye për zbatimin e vonuar është cituar në intervista si një faktor i rëndësishëm i paparashikuar në mbështetjen e progresit. Palët e interesuara vunë re se në aktivitetet dhe masat të financuara nga qeveria brenda KNj1 të SKZH-së, nuk kishte mekanizma të zbatuar vazhdimisht për përfaqësuesit e nivelit të lartë për të pyetur se pse mund të mos ishte arritur përparim ndaj masave të KNj1 të SKZH-së.
78. Masat 4, 5 dhe 6 raportuan se më pak se një e treta e TKP-ve kishin progres, me më shumë se dy të tretat e TKP-ve në këto tri masa që raportonin se nuk ka progres. Masat 4 dhe 5 lidheshin me masat e llogaridhënies dhe certifikimit brenda sistemit arsimor ndërsa Masa 6 kishte të bënte me rekrutimin e diasporës.
79. Në Masën 4 pati njëfarë progresi në krijimin e testeve kombëtare (Aktiviteti 4.2), por pesë aktivitetet e tjera kishin treguar pak progres në sistemimin e procedurave për përmirësimin e cilësisë dhe akreditimin. Për Masën 5 (planifikimi i shpenzimeve) ka njëfarë progresi kundrejt krijimit të sistemeve të menaxhimit të informacionit, por raportohet se këto nuk shfrytëzohen sa duhet nga të gjithë palët e interesit në arsim dhe ka kufizime thelbësore për të qenë në gjendje t'i përdorin të dhënat e sistemit të menaxhimit të informacionit për analiza, monitorim ose planifikim.
80. Masa 7 raportoi progres në zhvillimin e një kornize të inspektoratit të punës edhe pse ende ka relativisht pak inspektorë të kontraktuar. Funkzionet e mbikëqyrjes dhe menaxhimi dhe procedurat e sistemeve janë raportuar se ende kanë nevojë për progres.
81. **Integrimi gjinor.** KNj i SKZH-së nuk ka një fokus të fortë gjinor, barazie apo përfshirjeje të integruar në strategji. Në nivelin e aktiviteteve, të dhënat për pjesëmarrjen në aktivitete raportohen të zbërthyer sipas pjesëmarrësve meshkuj dhe atyre femra dhe një nga treguesit e nivelit makro lidhet me proporcionin e grave në vendin e punës. Disa të intervistuar ishin gjithashtu në gjendje të artikulojnë një efekt të mundshëm kaskadë të institucioneve parashkollore që lejojnë qasje të përmirësuar të nënave në vendin e punës ose se si përmirësimi i kontratave formale mund të integrojë më shumë gra në ekonominë formale sepse gratë mund të jenë të përfshira në mënyrë disproporcionale në punësim joformal. Megjithatë, integrimi gjinor nuk është i artikuluar në vetë KNj1 të SKZH-së ose në planin e mëvonshëm të veprimit. Për shembull, asnjë nga aktivitetet nuk është përshtatur në mënyrë specifike me një lente të ndjeshmërisë ndaj gjinisë dhe nuk ka TKP të ndërlidhur me gjininë ose tregues të nivelit të Masës për KNj1 të SKZH-së përtej detyrimeve të raportimit të ndarë sipas gjinisë.
82. Orientimi i rritjes ekonomike të KNj1 të SKZH-së dhe shtjellimi i saj të kapitalit njerëzor si nxitje për ekonomi e cituar më herët në seksionin e relevancës është një faktor që pengon integrimin e gjinisë, si dhe tema të tjera të barazisë dhe qasjes. Temat gjinore dhe të barazisë konsiderohen më shpesh me një kornizë të zhvillimit të qëndrueshëm ose zhvillimit gjithëpërfshirës dhe jo të rritjes në vetvete. Gjithashtu, popullatat e cënueshme dhe rajonet e largëta nuk janë shprehur në mënyrë specifike në mesin e masave, aktiviteteve ose treguesve të performancës.
83. **Performanca e Masave.** Janë shtatë masa të përfshira në Shtyllën e Kapitalit Njerëzor 1. Performanca e këtyre masave matet përmes 13 treguesve të nivelit të rezultateve (ndryshimi i dukshëm i sjelljes individuale ose organizative). Tabela e mëposhtme përshkruan një përmbledhje të ndryshimeve në treguesit e nivelit të masave. Për performancën e nivelit të masave, ngjyra e gjelbër do të thotë progres i konsiderueshëm. E verdha përshkruan njëfarë progresi, por jo shumë të avancuar. E kuqja do të thotë se nuk ka progres - ose se ka rënie të vlerave të treguesve nga gjendja fillestare. Përshkrimet e plota të vlerave të treguesve të masave janë profilizuar në Shtojcën 3.

TABELA 10: MASAT E SKZH-SË - PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATEVE

| Masat dhe aktivitetet | Treguesit | Vlerësimi | Komente dhe vëzhgime (opsionale) |
|--|---|-----------|--|
| Masa 1: Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore. | % e fëmijëve të regjistruar në parashkollor % e fëmijëve të regjistruar në parafillor | | Regjistrimi në parashkollor u rrit nga 33.9 në 38.1% dhe në parafillor nga 87.6 në 93.1% |
| Masa 2: Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në sistemin e arsimit fillor dhe të mesëm. | % e mësimdhënësve me Bachelor ose Master Parashkollor Fillor I mesëm i ulët I mesëm i lartë Mesatarja e Vlerësimit të PISA-s | | Të dhënat nuk janë në dispozicion për ndryshoren e parë Rezultatet e PISA-s janë në dispozicion vetëm për vitet 2015 dhe 2018. Rezultatet mesatare të papërpunuara të shkencës ranë për 13 pikë nga viti 2015 në vitin 2018 (nga 378 në 365) |
| Masa 3: Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës. | # I profileve të përditësuara të sistemit arsimor % e papunësisë për të rinjtë që kanë përfunduar arsimin profesional | | Të dhënat nuk janë në dispozicion |
| Masa 4: Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit në sistemin arsimor | Testi përfundimtar i përqindjes mesatare të arritshmërisë: Klasa 5 Klasa 9 Matura | | Vlerat e testit për klasën e 9-të dhe të 12-të ranë për shtatë pikë përqindje nga gjendja fillestare në vitin 2015 (nga 64.7% në 57.9% për klasën e 9-të dhe nga 74.1% në 67.4% për klasën e 12-të). |
| Masa 5: Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin arsimor. | % e nxënësve bazuar në profilet e AAP-së % e studentëve bazuar në profilet e arsimit të lartë | | Të dhënat raportohen ndryshe nga treguesit. Rritje e lehtë në profilet shëndetësore dhe veterinare (rreth katër pikë përqindje secila) dhe rënie në inxhinieri dhe administrim biznesi (rreth katër pikë përqindje). |
| Masa 6: Rekrutimi i ekspertëve dhe studentëve të diasporës për angazhimin në tregun e punës. | Numri i iniciativave të iniciuara nga anëtarët e diasporës | | Asnjë veprim i ndërmarrë apo progres i arritur në këtë dimension |
| Masa 7: Zvogëlimi i nivelit të punësimit joformal dhe krijimi i kushteve të përshtatshme të punës | # I lëndimeve në vendin e punës % e punonjësve pa kontratë % e punonjësve pa kontratë përmes Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) | | Të dhënat tregojnë përmirësime në kontratat për punësimin joformal (të reduktuara nga 66.5% pa kontratë në 18% pa kontratë). Megjithatë, ka pasur një rritje të aksidenteve të raportuara në vendin e punës (nga 45 në 160) edhe pse vdekjet kanë rënë (nga 23 në 11). |

84. Të dhënat për treguesit e Masës 2 dhe Masës 3 nuk ishin të disponueshme për EV-në. Nga të tjerat, dy masat e vetme që shfaqën përmirësime nga viti 2015 ishin regjistrimi në parashkollor dhe rënia e përqindjes së kushteve të punës në punësimin joformal. Përqindja e fëmijëve të

regjistruar në parafillor dhe kopshte u rrit për 6 për qind nga viti 2015. Kjo pasqyron një përmirësim modest edhe pse përsëri jo në nivelet e caqeve të shtjelluara në KNj1 të SKZH-së. Për punësimin në vendin e punës, përqindja e punonjësve joformalë ka rënë ndjeshëm sipas të dhënave të inspektoratit (45 pikë përqindje), por vetëm shumë pak sipas të dhënave të Anketës së Fuqisë Punëtore (rreth 2 pikë përqindje).⁶⁹ Megjithatë, edhe pse modestë, këta tregues reflektojnë një ndryshim pozitiv. Pjesa tjetër e treguesve të nivelit të masave nuk tregojnë progres pozitiv. Shqetësimi më i madh janë ndryshimet në performancën arsimore të nxënësve në testet e klasës 9, maturës (klasa 12) dhe PISA-s.

85. Rezultatet e testit të PISA-s janë nga vitet 2015 dhe 2018, por ende nuk janë të disponueshme për më vonë në ciklin SKZH-së. Sidoqoftë, rezultatet nuk tregojnë për trend pozitiv. Ndërsa rezultatet e papërpunuara në lexim dhe matematikë mbetën relativisht të ngjashme nga viti 2015 në vitin 2018 (nga 347 në 353 dhe nga 362 në 366), rezultatet e papërpunuara në shkencë ranë nga 378 në vitin 2015 në 365 në vitin 2018. Për testet kombëtare të klasës së 9-të dhe të 12-të, përqindja e arritshmërisë ra në të dyja masat nga viti 2015 për rreth shtatë pikë përqindje (nga 64.7% në 57.9% për klasën e 9-të dhe nga 74.1% në 67.4% për klasën e 12-të).

Kontributet kombëtare

86. **Performanca e nivelit makro.** Treguesit e nivelit makro matin rritjen ekonomike, tregjet e punës, kohezionin social dhe investimet e huaja. Një kufizim i treguesve të kornizës të nivelit makro të SKZH-së është se ata nuk janë duke e matur në mënyrë specifike performancën e shtyllave individuale. Për shembull, nuk ka tregues që lidhen me performancën e arsimit. Logjika prapa treguesve të nivelit makro është se ata duhet t'i pasqyrojnë pasojat kolektive kombëtare të të gjithë KNj1 të SKZH-së dhe rrjedhimisht fokusohen kryesisht në treguesit e nivelit makro të orientuar drejt ekonomisë (në vend të zhvillimit ose mirëqenies njerëzore). Në teori, aktivitetet e shtyllës KNj1 duhet të jenë drejtpërdrejt më të rëndësishmet për treguesit e tregut të punës dhe treguesit e kohezionit social. Treguesit e kohezionit social nuk u matën, por siç u theksua në përshkrimin e programit të KNj1 të SKZH-së, të gjithë treguesit e tjerë të nivelit makro pasqyrojnë arritje modeste nga gjendja fillestare në të gjithë treguesit, por jo në nivelin e caqeve të përshkruara në Udhërrëfyesin e KNj1 të SKZH-së (2017). Për shembull, BPV-ja për kokë banori u rrit nga viti 2015 për afro 700 Euro (nga 3277 Euro për kokë banori në 3986 Euro) por caku ishte vendosur në mënyrë ambicioze në 5000 Euro për kokë banori deri në vitin 2021; raporti i punësimit ndaj popullsisë u rrit për pesë pikë përqindje (nga 25% në 30%), por caku ishte 34 për qind për kokë banori); dhe investimet e huaja u rritën për rreth 12 milionë euro nga viti 2015 edhe pse caku kishte qenë 600 milionë euro deri në vitin 2021.⁷⁰ Tabela e mëposhtme përmbledh performancën e treguesve të nivelit makro. Ngjyra e gjelbër tregon progres sipas caqeve, e verdha tregon progres edhe pse më pak se caqet. E kuqja tregon se nuk ka progres apo se ka rënie.

TABELA 7: NDIKIMI I SKZH-SË - PROGRESI I TREGUESVE MAKRO⁷¹

| Tema | # | Treguesi | Njësia | Gjendja fillestare (2015) | Caku (2021) | Raporti i Institutit GAP ⁷² | Progresi |
|------------------|-----|---|--------|---------------------------|-------------|--|----------|
| Rritja ekonomike | 1 | BPV për kokë banori | EUR | 3277 | 5000 | 3986 | |
| | 1.1 | Norma e rritjes vjetore të BPV-së reale | % | 4.1% | 7.0% | 4.9% | |

⁶⁹ Të dhënat e ASK-së tregojnë një rritje të përqindjes së punëtorëve me kontrata të përhershme nga 28% në vitin 2015 në 45% në vitin 2020. Këto të dhëna nuk janë pjesë e burimeve zyrtare të të dhënave për planin e veprimit të SKZH-së, por tregojnë trekëndëzim të modeleve të njëjta.

⁷⁰ Shihni Tabelën 4 për detajet e treguesit të nivelit makro.

⁷¹ Burimi: Udhërrëfyesi për Zbatimin e SKZH-së 2016-2021.

⁷² Të dhënat gjatë vitit 2019

| | | | | | | | |
|-------------------------------|-----|--|-------------|-------|-------|-------|--|
| | 2 | GFCF ⁷³ (% e BPV - së) | % | 25.8% | 32.0% | 28.6% | |
| Tregu i punës | 1 | Raporti i punësimit ndaj popullsisë | % | 25.2% | 34.0% | 30.1% | |
| | 2 | Papunësia ⁷⁴ | % | 32.9% | 20% | 25.7% | |
| | 2.1 | Papunësia e të rinjve ⁷⁵ | % | 57.7% | 30% | 49.4% | |
| | 2.2 | Përqindja e rinisë NEET ⁷⁶ | % | 31.4% | 25% | 32.7% | |
| | 3 | Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore ⁷⁷ | % | 37.6% | 42% | 40.5% | |
| | 3.1 | Shkalla e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore ⁷⁸ | % | 18.1% | 37% | 21.1% | |
| Kohezioni social | 1 | % e njerëzve në varfëri | % | 29.9% | 25% | NA | |
| | 2 | IZhNj ⁷⁹ | Indeksi 0-1 | 0.741 | 0.80 | NA | |
| Investimet dhe tregtia | 1 | Hyrjet e përgjithshme të IHD-ve | Milion Euro | 308.8 | 600 | 321.7 | |
| | 1.1 | IHD-të si përqindje në BPV | % | 56.0% | 65% | NA | |
| | 2 | Investimet private si përqindje në BPV | % | TBC | TBC | NA | |
| | 3 | Raporti i eksportit ndaj importit | % | 12.3% | 18% | 12.2% | |
| | 4 | Përqindja e eksporteve në BPV ⁸⁰ | % | 19.3% | 28% | 29.5% | |

87. Nga 16 treguesit në kornizën makro të SKZH-së, katër nuk u matën. Nga 12 të tjerët, njëri nuk tregoi progres, njëri tregoi progres sipas caqeve, dhe 10 treguan njëfarë progresi modest, edhe pse jo në nivelin e caktuar të dëshiruar. Arritjet më të shpeshta ishin në punësimin në tregun e punës dhe në zhvillimin ekonomik. Megjithatë, ekziston njëfarë luhatshmërie në matjet nga viti në vit të tregjeve të punës që nuk identifikohen lehtësisht në matjet e thjeshta të gjendjes fillestare/fundore. Për shembull, treguesit e tregut të punës u përmirësuan nga viti 2016 në vitin 2018, por më pas pati një rënie nga viti 2018 deri në vitin 2019 përpara përmirësimeve përsëri në vitin 2020.

88. **Kontributet e aktiviteteve në treguesit e nivelit makro.** Treguesit e nivelit makro tregojnë përfitime pozitive nga gjendja fillestare, por ka dëshmi të kufizuara që zinxhiri shkakësor në TeN të nënkuptuar është në gjendje të ndikojë në treguesit e nivelit makro. Së pari, shkallët relativisht të ulëta të arritjeve (më pak se gjysma) e treguesve të aktivitetit nuk do të pasqyronin një rrugë logjike shkakësore për ndryshimet e vërejtura në treguesit e rezultateve të KNj1 të SKZH-së. Së dyti, nga 20 treguesit e nivelit të rezultateve në KNj1 të SKZH-së, gati tre të katërtat nuk tregojnë asnjë ndryshim ose rënie nga niveli bazë (siç janë rezultatet e PISA-s). Së treti, një numër treguesish të nivelit makro nuk janë ata që mund të ndikohen logjikisht nga rrugët e aktivitetit të KNj1 të SKZH-së (të tilla si kohezioni social ose investimet e huaja) dhe llojet e treguesve që mund të ndikohen nga KNj1 të SKZH-së (të tilla

⁷³ Formimi Bruto i Kapitalit Fiks

⁷⁴ Përqindja e fuqisë punëtore totale)

⁷⁵ 15-24 vjeç

⁷⁶ Jo në Arsim, Punësim, apo Trajnim

⁷⁷ Popullsia totale 15+ vjeç

⁷⁸ Popullsia totale 15+ vjeç

⁷⁹ Indeksi i Zhvillimit Njerëzor

⁸⁰ Mallrat dhe shërbimet

si treguesit e arsimit) nuk janë të pranishëm në treguesit e nivelit makro. Nëse më shumë se gjysma e të gjithë TKP-ve raportohet se nuk kanë pasur progres dhe nëse treguesit në nivelin e Masës që ekzistojnë për KNj1 të SKZH-në kanë tendencë të tregojnë rënie nga viti 2015 edhe kur treguesit e nivelit makro tregojnë rritje, atëherë është e arsyeshme të supozohet se progresi modest në nivel makro po mbështetet nga burime të tjera përveç aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së në vetvete.

Efikasiteti

89. Efikasiteti si një dimension vlerësimi zakonisht eksploron afatin kohor të përfundimit të aktiviteteve të planifikuara dhe efektivitetin e kostos së aktiviteteve të zbatuara. Për qëllimet e këtij vlerësimi, ky dimension i OECD-së u përshtat në TeR për të vlerësuar se deri në çfarë mase burimet financiare në dispozicion u përdorën në mënyrë efektive. Ndërsa mbledhja e të dhënave të vlerësimit përparonte, një numër i pengesave të zbatimit u identifikuan brenda proceseve të qeverisjes së brendshme në lidhje me procedurat e burimeve. Ky seksion është ristrukturuar për të nxjerrë në pah këto pengesa financiare sepse elementi i burimeve financiare lidhet me këtë, ndërsa pengesat e tjera trajtohen në seksionin e qëndrueshmërisë.
90. **Pengesat e burimeve:** Aktualisht nuk është e mundur t'i përgjigjemi pyetjes së vlerësimit të TeR se si janë përdorur burimet financiare për zbatimin e KNj1 të SKZH-së për shkak të strukturës së procesit të buxhetimit dhe alokimit të burimeve. Plani i veprimit i KNj1 e SKZH-së në vitin 2017 ka zhvilluar një vlerësim të kostimit të ndarë në nivelin e aktiviteteve duke përfshirë një përshkrim se cila përqindje e kostove do të vinte nga qeveria e Kosovës dhe cila përqindje e kostove do të vinte nga kontributet e donatorëve. Megjithatë, mënyra se si regjistrohen burimet financiare në raportimin ministror nuk identifikon alokimet e burimeve sipas aktivitetit të KNj1 të SKZH-së. Planet sektoriale të punës zbatohen sipas dimensioneve të tjera. Duke qenë kështu, nuk është e mundur të gjurmohet shkalla e shpenzimeve kundrejt aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së brenda strukturave ekzistuese.
91. Implikimet e kësaj janë se çdo gjurmim i shpenzimeve për aktivitetet e KNj1 të SKZH-së duhet të bëhet manualisht dhe nuk janë pjesë e proceseve të rregullta të raportimit. Është më e lehtë të gjurmohet financimet e donatorëve, të cilat alokohen sipas kodeve të ndryshme financiare. Rritja e llogaridhënies në lidhje me aftësinë për t'i gjurmuar projektet e financuara nga donatorët është një faktor për përmirësimin e shkallëve të arritjeve të aktivitetit, siç theksohet në seksionin e efektivitetit.
92. Megjithëse kishte një mungesë të të dhënave financiare kundrejt KNj1 të SKZH-së, në bazë të dëshmive në dispozicion, alokimet për aktivitetet e KNj1 të SKZH-së nuk ishin proporcionale me vlerësimet e kostimit në planin e veprimit të KNj1 të SKZH-së dhe aktivitetet e SKZH-së kishin tendencë të mos trajtoheshin me prioritet gjatë buxhetimit. Masat dhe aktivitetet e KNj1 të SKZH-së zakonisht nuk janë marrë parasysh nga përfaqësuesit e nivelit të Kabinetit gjatë përcaktimit të prioritetëve vjetorë. Si rezultat, Ministritë kishin alokuar shumë nga burimet e tyre për prioritetet e tjera - si mbështetjen e pagave për mësimdhënësit - dhe aktivitetet e KNj1 të SKZH-së nuk u prioritetizuan as në alokimin e burimeve "të lira". Për shembull, sipas Institutit GAP, Ministria e Arsimit alokon rreth 65 përqind të buxhetit të saj vjetor për paga dhe infrastrukturë. Aktivitetet e përpjekjeve për forcimin e sistemeve në KNj1 të SKZH-së, si certifikimi ose rishikimi i performancës së mësimdhënësve, nuk regjistrohen në raportimin zyrtar. Ky model i alokimit i përafshuar me strategjitë përmendet edhe në vlerësimet e tjera të jashtme në Kosovë, duke përfshirë raportin SIGMA (2017) dhe Raportet Vjetore të Progresit të BE-së (2017-2020).
93. Një arsye për këtë është se alokimi i burimeve për aktivitetet e KNj1 të SKZH-së dhe integrimi i KNj1 të SKZH-së në proceset e buxhetimit në përgjithësi ka qenë një pengesë për zbatimin. Çdo vit, si pjesë e planeve të tyre sektoriale të punës, Ministritë shtjellojnë strategjitë e tyre të kostimit dhe pastaj alokojnë burimet nga buxheti i tyre për aktivitetet specifike. Masat e KNj1 të SKZH-së nuk ishin të harmonizuara me ligjin e buxhetit, që

nënkuptonte se ministritë nuk janë të detyruara të alokojnë fonde për aktivitetet e KNj1 të SKZH-së. Edhe pse një pjesë e buxhetit të ministrive ishte e lidhur me aktivitetet e KNj1 të SKZH-së, nuk ka pasur kërkesë të brendshme në qeveri që aktivitetet të identifikoheshin nga KNj1 të SKZH-së t'u jepet përparësi në financim.

94. Si rrjedhojë, progresi i aktiviteteve të SKZH-së është shumë i harmonizuar me zotimet vullnetare – veçanërisht zotimet e donatorëve. KNj1 e SKZH-së ende shërben si një orientim i përgjithshëm për investimet e donatorëve, të dëshmuar me progresin relativ të masave që ndërliken ngushtë me shkallën e investimit nga donatorët. Megjithatë, sa i përket elementeve që vareshin nga financimi i qeverisë ose zbatimi, mund të shihet se kanë relativisht pak progres. Kjo dinamikë e buxhetimit dhe ligjit për buxhetin mbulohet në më shumë detaje në seksionet në vijim.

Qëndrueshmëria dhe sinergjitë

95. Qëndrueshmëria brenda kornizës së vlerësimit të politikave fokusohet në dy dimensione: 1) Deri në çfarë shkalle mund të mbështetet vetë KNj1-ja e SKZH-së brenda proceseve dhe kornizave të qeverisjes? Dhe 2) deri në çfarë shkalle mund të mbahen në të ardhmen rezultatet që janë arritur në ciklin e kaluar të SKZH-së.
96. Për komponentin e parë, qëndrueshmëria do ta përfshinte shkallën në të cilën KNj1 e SKZH-së është e integruar me kornizat (sinergjitë) e jashtme dhe të brendshme, duke përfshirë shkallën në të cilën KNj1 e SKZH-së është përafuar dhe integruar në proceset dhe mekanizmat ekzistues të qeverisë. Vlerësimi i pengesave të mundshme për zbatimin e KNj1 të SKZH-së janë konsiderata të rëndësishme për ta kuptuar qëndrueshmërinë afatgjate të KNj1 të SKZH-së.
97. Komponenti i dytë merr parasysh shkallën në të cilën mund të vazhdojnë të qëndrojnë rezultatet e SKZH-së. Qëndrueshmëria e rezultateve në rastin e KNj1 të SKZH-së do të përfshinte tri nivele: i) nëse ekziston kornizë ligjore ose rregullator i mjaftueshëm; ii) nëse ka sisteme, procese ose asete të mjaftueshme të zhvilluara; dhe iii) nëse ka zhvillim të mjaftueshëm të kapaciteteve teknike njerëzore në lidhje me sistemet, proceset ose asetet, duke përfshirë kontraktimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore. Garancitë e burimeve të vazhdueshme adekuata të rezultateve janë të lidhura me komponentin e parë pasi kjo ka të bëjë me proceset e buxhetimit të qeverisë.

Qëndrueshmëria e rezultateve të KNj1

98. 101 TKP të ndryshme nga KNj1 e SKZH-së mund të klasifikohen në tri kategori të aktiviteteve që lidhen me qëndrueshmërinë e rezultateve të KNj1 të SKZH-së: i) hartimi i ligjeve, kornizave ligjore ose studimeve (29); ii) zhvillimi i sistemeve ose proceseve ose krijimi i një asemi (ndërtesa, qendra, pajisje) (45); dhe iii) trajnimet dhe kontraktimi i burimeve njerëzore (27).
99. Tri nivelet e ndryshme pasqyrojnë kushte të ndryshme të nevojshme për qëndrueshmëri. Niveli i parë është më themelor, hartimi i ligjeve dhe kornizave ligjore të nevojshme që një masë të ketë sukses. Niveli i dytë përfshin krijimin e sistemeve dhe qendrave të nevojshme brenda të cilave do të zbatohen masat. Niveli përfundimtar përfshin kontraktimin dhe trajnimin e njerëzve që do të përfshihen në zbatimin e masave. Që të arrihet qëndrueshmëria e rezultateve, të tri nivelet duhet të arrihen brenda një mase.
100. Për KNj1 të SKZH-së në përgjithësi, shkallët e arritjeve në çdo nivel kanë qenë relativisht të ulëta (Shtojca 4). Gjatë gjithë aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së, u arritën 28 për qind e aktiviteteve të renditura të nivelit 1 (ligje dhe rregullore). Aktivitetet e nivelit 2 kishin një shkallë të ngjashme arritjeje (24% e arritur ose progres i mirë) në lidhje me ngritjen e

qendrave ose ndërtesave ose sistemeve. Normat më të ulëta të arritjeve ishin të lidhura me ato aktivitete të lidhura me trajnime ose me kontraktim të njerëzve (15%).

101. Implikimet për qëndrueshmërinë e rezultateve janë se rezultatet e KNj1 të SKZH-së nuk ka të ngjarë të jenë në gjendje të vazhdojnë. Përfitimet më të mëdha kanë qenë në themelet e krijuara nga krijimi i projektligjeve dhe rregulloreve të nevojshme dhe fillimi i krijimit të sistemeve dhe asetëve që shoqërojnë masat. Megjithatë, mbetet më shumë për t'u bërë në drejtim të trajnimit dhe kontraktimit të njerëzve – ngritjen e kapaciteteve të nevojshme teknike – për t'i menaxhuar asetet ose për t'i zbatuar ligjet.

Qëndrueshmëria e KNj1 të SKZH-së si politikë

102. Ky seksion eksploron shkallën në të cilën masat KNj1 të SKZH-së janë përafuar me OZHQ-të dhe prioritetet e BE-së, si dhe masën në të cilën masat e KNj1 të SKZH-së mund të mbështeten në të ardhmen. TeR kishin përfshirë gjithashtu një pyetje në lidhje me përafrimin e KNj1 të SKZH-së me strategjitë sektoriale ekzistuese, e cila është integruar në seksionin e mëparshëm të relevancës.

Sinergia me kornizat e jashtme

103. KNj1 e SKZH-së (dhe SKZH-ja në përgjithësi) është e përafuar me OZHQ-të dhe prioritetet e BE-së edhe pse proceset standarde të raportimit vjetor të KNj1 të SKZH-së nuk përfshijnë këta tregues. Në rastin e OZHQ-ve, OZHQ-të nuk ishin miratuar nga Qeveria e Kosovës deri pas hartimit të KNj1 të SKZH-së. Prandaj, një ushtrim retrospektiv u krye si pjesë e hartimit të planit të veprimit të SKZH-së në vitin 2017 për të ilustruar lidhjet e vendosura në SKZH me kontributet e tyre në OZHQ-të. Raporti i progresit për SKZH ka përfshirë një kapitull për OZHQ-të, ku janë raportuar të dhënat në nivel të treguesve. Megjithatë, kjo është raportuar vetëm një herë gjatë ciklit dhe raportet vjetore të KNj1 të SKZH-së si pjesë e procesit të raportimit në vazhdim e sipër nuk raporton kundrejt OZHQ-ve dhe treguesit e OZHQ-së nuk janë pjesë e kornizës së rezultateve të performancës së KNj1 të SKZH-së. Një ushtrim i ngjashëm u krye për të harmonizuar SKZH-në në mënyrë retroaktive edhe me prioritetet e BE-së. Megjithatë, edhe pse raportet vjetore të BE-së të lidhura me planin e aderimit në BE nxjerrin në pah elemente nga aktivitetet e KNj1 të SKZH-së, raportimi real vjetor i KNj1 të SKZH-së nuk i referohet në mënyrë specifike progresit kundrejt prioritetëve të BE-së, nuk identifikon vonesat ose citon plane veprimi për korrigjim kundrejt prioritetëve.

Qëndrueshmëria me kornizat e brendshme

104. Performanca e përgjithshme dhe qëndrueshmëria e mundshme e KNj1 të SKZH-së ka qenë e pabarabartë dhe është ndikuar nga një sërë faktorësh. 'Prioritizimi i prioritetëve' në arkitekturën e KNj1 të SKZH-së dhe mungesa e integritit të produkteve të KNj1 të SKZH-së në proceset e vazhdueshme qeveritare kufizon dobinë e KNj1 të SKZH-së për orientimin e strategjive sektoriale dhe kufizon shkallën në të cilën të dhënat e monitorimit për menaxhimin e KNj1 të SKZH-së janë në dispozicion. Pronësia e kufizuar politike e KNj1 të SKZH-së përtej zyrës së ZPS-së gjithashtu kufizon shkallën në të cilën Ministrinë mbahen përgjegjëse për performancën dhe qëndrueshmërinë e KNj1 të SKZH-së.
105. Pronësia e kufizuar ndërlikohet më tej nga pengesat për bashkëpunimin dhe koordinimin ndërministror. KNj1 e SKZH-së përmban masa të shumta që mbështeten në koordinimin ndërministror për arritje. Megjithatë, ekzistojnë dëshmi relativisht të kufizuara të bashkëpunimit ndërmjet ministrive ose me ZPS-në dhe kjo ndërlikohet nga ndarja ekzistuese e roleve dhe përgjegjësive brenda qeverisë. Për shembull, raporti i SIGMA-s për qeverisjen në Ballkan në vitin 2017 vuri në dukje se në Kosovë puna e planifikimit është e ndarë në mes të ZPS-së (caktimi i prioritetëve) dhe Sekretariatit Koordinues të Qeverisë (hartimin e planit të punës të qeverisë), duke krijuar kështu sfida shtesë për koordinimin brenda qeverisë. Raporti vazhdon duke vënë në dukje se rrënjësia e prioritetëve dhe planit të

punës në të njëjtën njësi strukturore do ta bënte më të lehtë sigurimin e përafrimit. Si rrjedhojë, bashkëpunimi shumë i ngushtë ndërmjet njërive do të ishte i nevojshëm në mënyrë që planifikimi i përbashkët të funksionojë. Kjo sfidë e vendosur u përkeqësua më tej nga mungesa e integritit të KNj1 të SKZH-së brenda mekanizmave ekzistues të qeverisë.

106. Ekziston potenciali i KNj1 të SKZH-së që të jetë i rëndësishëm për të shërbyer si një instrument i rëndësishëm afatmesëm që mund të shërbejë si një urë lidhëse midis mandateve qeveritare. Hapësira më e gjatë kohore e KNj1 të SKZH-së siguroi një kornizë gjithëpërfshirëse më të gjatë se sa mandatet individuale të qeverisë. KNj1 e SKZH-së u pa gjithashtu si një kornizë përkatëse për orientimin e strategjive dhe investimeve të donatorëve në projekte. Donatorët vërtet raportuan se u referohen prioriteteve të KNj1 të SKZH-së në arsyetimet e projekteve të tyre në Kosovë. Kjo u triangulua nga intervistat ku lidhja e aktiviteteve të ministrisë me SKZH-në ndihmoi në ofrimin e një arsyeimi më bindës për investimet e synuara nga donatorët.
107. Megjithatë, praktikisht, KNj1 e SKZH-së është disi e shkëputur nga proceset normale të Qeverisë. Kjo mund të shihet në aspektin e zhvillimit dhe raportimit të planit të punës, si dhe proceseve të tjera të tilla si buxhetimi dhe mbikëqyrja. Megjithëse KNj1 e SKZH-së është e referuar, strategjitë sektoriale ministrore shërbejnë si orientimi kryesor për qeverinë dhe donatorët në zbatimin dhe raportimin real të projekteve. Ministrinë raportojnë arritjet kundrejt strategjive të tyre sektoriale dhe planeve të punës, e jo kundrejt KNj1 të SKZH-së.
108. **Në proceset e buxhetimit**, ekzistojnë departamente të buxheteve në kuadër të secilës ministri, si dhe Departamenti i Buxhetit në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Si departamentet e buxheteve të ministrive ashtu edhe Departamenti i Buxhetit në kuadër të MFPT janë përgjegjëse për shqyrtimin final dhe kostimin e buxheteve të ministrisë dhe Departamenti i Buxhetit i MFPT është gjithashtu përgjegjës për lëshimin e opinioneve të mira lidhur me atë nëse kostimi i propozuar i buxheteve të ministrisë është real. Megjithatë, të dy kanë kufizime sa i përket marrjes parasysh të SKZH.
109. Për shkak se KNj1 e SKZH-së nuk është pjesë e ligjit të buxhetit (dhe i strukturuar), në mënyrë që Departamenti i Buxhetit të MFPT të lëshojë opinione të mira kundrejt kostos së KNj1 të SKZH-së ose ta zbatojë alokimin e fondeve të ministrisë për aktivitetet e KNj1 të SKZH-së, Departamentit të Buxhetit të MFPT do t'i duhej një Udhëzim Administrativ (UA) vjetor për të kërkuar që të merren parasysh konsideratat e KNj1 të SKZH-së. Megjithatë, Departamenti i Buxhetit i MFPT nuk i ka pranuar këto udhëzime administrative për të drejtuar nxjerrjen e opinioneve buxhetore kundrejt KNj1 të SKZH-së ose për të kërkuar nga ministritë që t'i prioritetizojnë aktivitetet e KNj1 të SKZH-së gjatë caktimit të burimeve. Prandaj, ministrive përkatëse nuk u kërkohet të alokonin fonde për këto aktivitete të KNj1 të SKZH-së nëse donatorët nuk zgjidhnin t'i financonin ato.
110. Struktura e kostimit dhe buxhetimit brenda ministrive shfaqet gjithashtu si një pengesë tjetër e efikasitetit. Secila ministri ka zyrtarët e saj të financave, por ky personel zakonisht nuk përfshihet në planifikimin vjetor të buxheteve të Ministrisë dhe përfshihet vetëm në fund ku ata janë të mandatuar ta aplikojnë kostimin për aktivitetet e përzgjedhura. Aktualisht, buxheti nuk filtron planifikimin e propozuar buxhetor dhe nuk janë të përfshirë në planifikimin fillestar për të siguruar përputhjen me parametrat e përgjithshëm buxhetor për një vit të caktuar brenda një ministrie.
111. **Për sa i përket mbikëqyrjes**, plani i veprimit i KNj1 e SKZH-së i vitit 2017 ka hartuar një kornizë të detajuar monitorimi, por kjo kornizë nuk është e integruar në proceset e vazhdueshme të monitorimit sektorial që kryhen nga ministritë, duke rezultuar që shumë tregues të mos maten në mënyrë rutinore nëse nuk kanë qenë në fakt pjesë e planit të monitorimit sektorial.

112. **Sa i përket pronësisë politike**, ka relativisht pak vullnet politik për zbatimin e aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së. Termi vullnet politik u citua vazhdimisht në intervistat me palët e interesit, megjithëse kjo kishte tendenca të tregonte dy lloje të ndryshme fenomenesh, varësisht nga niveli i qeverisë së përfshirë. Në nivelin më të lartë të qeverisë, *vullneti politik* nënkuptonte pronësinë e KNj1 të SKZH-së si një strategji që duhej marrë në konsideratë dhe zbatohet. Në nivelin e nëpunësit civil, *vullneti politik* është përdorur për t'iu referuar gatishmërisë për të punuar për zbatimin e aktiviteteve dhe masave. Ky përdorimi i fundit ishte një referencë indirekte në nevojën për mekanizma të llogaridhënies për të siguruar vëmendjen dhe përparimin në zbatim ose ekzistencën e pasojave ose sanksioneve për performancën joadekuate.
113. KNj1 e SKZH-së është relevant për kontekstin dhe nevojat, por është më pak relevant politikisht për sa i përket pronësisë së nivelit të lartë të qeverisë mbi procesin - ose të paktën, nivelet e qeverisë të përfshira në hartimin e KNj1 të SKZH-së nuk ishin proporcionale për të futur nivel të qëndrueshëm mbështetjeje për KNj1 të SKZH-së. Një pjesë e kësaj mund të ketë qenë e lidhur me procesin e hartimit i cili solli ekspertë të nivelit të lartë të cilët zhvilluan, përmes metodave rigorozë, shënimet e politikave dhe KNj1 pasuese të SKZH-së. Ky proces kërkonte validimin nga palët qeveritare të interesit, por për shkak se ushtrimi ishte bërë nga konsulentë të jashtëm, kishte një përfshirje të kufizuar ministrore në shtjellimin e aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së dhe planeve të punës. Edhe plani i veprimit i KNj1 të SKZH-së, i cili është i detajuar në shtjellimin e aktiviteteve, treguesve kyç të performancës dhe kostimit, u zhvillua përmes konsulentëve të jashtëm dhe, sipas intervistave të palëve të interesit, kishte lansim dhe integrim të kufizuar në proceset e vazhdueshme qeveritare.
114. Ndërrimi i shpejtë i qeverive dhe personelit qeveritar brenda ministrive gjithashtu pengoi forcimin e pronësisë politike gjatë ciklit të KNj1 të SKZH-së. Nga shtjellimi i KNj1 të SKZH-së në vitin 2016, pati katër tranzicione qeveritare dhe një periudhë prej nëntë muajsh kur nuk u formua fare qeveria. Gjatë disa periudhave të ciklit të SKZH-së, kishte interes më të madh politik për KNj1 të SKZH-së sesa në periudhat e tjera. Në periudhën 2015- fillimi i vitit 2018, dukej se kishte një vullnet relativisht të lartë politik bazuar në numrin e dokumenteve dhe raporteve të prodhuara kundrejt KNj1 të SKZH-së (përfshirë planin e veprimit të KNj1 të SKZH-së dhe rishikimin afatmesëm të vitit 2018). Nga fundi i vitit 2018 deri në fund të vitit 2020, vullneti politik duket se ka rënë siç dëshmohet nga më pak raporte dhe aktivitete. Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe shkallë të lartë të ndërrimit të Qeverisë, me katër qeveri që e kanë marrë pushtetin nga muaji dhjetor i vitit 2017. Së fundi, nga fillimi i vitit 2021, duket se ka pasur një ringjallje të interesit në vullnetin politik për KNj1 të SKZH-së me aktivitete të rritura rreth KNj1 të SKZH-së duke përfshirë ushtrime nga mësimet e nxjerra, analizat SWOT dhe koncepte të reja për hartimin e KNj1 të SKZH-së së re.

Pengesat për integrimin e KNj1 të SKZH-së

115. Megjithëse produktet ishin teknikisht rigorozë, shkëputja e produkteve nga proceset e vazhdueshme qeveritare dhe pronësia e kufizuar politike kufizoi shkallën e integritit të KNj1 të SKZH-së në proceset ekzistuese dhe mandatet e qeverisë dhe krijoi pengesat e mëposhtme të zbatimit dhe qëndrueshmërisë.
116. **Pengesat në monitorim dhe raportim:** Plani i veprimit i KNj1 të SKZH-së zhvilloi një kornizë të detajuar të performancës së rezultateve. Megjithatë, kjo kornizë e performancës nuk është e integruar në mënyrë specifike në proceset e raportimit të Ministrisë. Për shkak të kësaj, ka të dhëna të kufizuara monitorimi që mund të nxirren lehtësisht nga raportet e Ministrisë dhe të aplikohen për të përcjellë në mënyrë specifike aktivitetet e KNj1 të SKZH-së në strategjitë sektoriale. Çdo raportim i KNj1 të SKZH-së bëhet "në shtesë të" proceseve të raportimeve ministrore e jo "si pjesë" e proceseve ministrore. Edhe në ZPS, raporti vjetor për Kryeministrin në lidhje me arritjet e aktiviteteve nga Ministritë bazohet në planet e punës të Ministrisë dhe jo sipas prioriteteve dhe masave të KNj1 të SKZH-së. Për shembull, raporti

vjetor i ZPS-së mund të tregojë se sa aktivitete brenda planit sektorial të MASHT-it janë përfunduar, por nuk raporton se sa nga këto ishin aktivitete të KNj1 të SKZH-së.

117. Ekzistojnë platforma të raportimit të brendshëm që ofrojnë informacion monitorimi, por këto nuk mblidhen ose raportohen për KNj1 të SKZH-së. Për shembull, donatorët raportojnë aktivitetet e projekteve të tyre brenda platformës së menaxhimit të ndihmës dhe këto aktivitete mund të lidhen me performancën e KNj1 të SKZH-së, por nuk publikohen në këtë mënyrë. Për më tepër, raportet e brendshme të qeverisë për aktivitetet që përgatiten për ZPS-në supozohet të jenë të lidhura me aktivitetet e KNj1 të SKZH-së aty ku është relevante, por këto nuk nxirren për të raportuar posaçërisht kundrejt KNj1 të SKZH-së publikisht. Plani vjetor i qeverisë supozohet të përfshijë referenca për masat e SKZH-së, por këto jo gjithmonë plotësohen nga agjencitë sektoriale përkatëse. Në fund, të dhëna të tjera për menaxhimin e informacionit për KNj1 të SKZH-së ekzistojnë, por nuk nxirren lehtë dhe kërkojnë koordinim midis agjencive, të tilla si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit⁸¹ dhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Zyra të ndryshme po grumbullojnë informata të ndryshme por këto nuk mblidhen së bashku për të siguruar një pasqyrë të përgjithshme të progresit të KNj1 të SKZH-së.
118. Për shkak të natyrës së shpërndarë të informacionit, ka mundësi të kufizuara për monitorim publik të KNj1 të SKZH-së. Të dhënat ekzistuese nuk ndahen në mënyrë efektive midis agjencive në lidhje me KNj1 të SKZH-së dhe ndërsa statistikave raportohen, të dhënat e papërpunuara nuk janë në dispozicion të publikut ose mbahen në bazat e të dhënave të veçanta të cilat nuk janë të ndërlidhura. Pa këtë ndërlidhje të të dhënave me performancën e KNj1 të SKZH-së, ka pengesa për të informuar diskursin e politikave të bazuar në dëshmi. Për shembull, Instituti GAP publikon të dhëna vjetore për alokimin e buxhetit, por të dhënat janë të lidhura me strategjitë ministrore dhe jo me masat e KNj1 të SKZH-së, por këto mund të riformulohen për të ilustruar buxhetimin kundrejt masave dhe aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së.
119. **Pengesat në llogaridhënie:** Ekzistojnë mekanizma të kufizuar të llogaridhënies për të zbatuar pajtueshmërinë e Ministrive dhe departamenteve me KNj1 të SKZH-së. KNj1 të SKZH-së i mungon një mekanizëm për të siguruar që të gjitha strategjitë sektoriale dhe planet e punës të jenë në përputhje me KNj1 të SKZH-së. Gjatë shtjellimit të planeve të punës, departamentet ligjore brenda secilës ministri kryejnë një kontroll të strategjive dhe planeve të punës për të siguruar harmonizimin me legjislacionin aktual. Kjo përfshin zyrën e buxhetit dhe shpenzimet, përafrimin me anëtarësimin në BE⁸² dhe kështu me radhë. Megjithatë, nuk ekziston një mekanizëm brenda departamenteve përgjegjëse për planifikim dhe koordinim të politikave për të bërë verifikim të kryqëzuar të planeve të punës kundrejt KNj1 të SKZH-së për ministritë e tyre përkatëse, e as nuk ka një udhëzim administrativ të nivelit të ZPS-së për të kryer këtë verifikim të kryqëzuar për ZKM-në.
120. Për fund, ka masa brenda KNj1 të SKZH-së që kërkojnë që komunat të jenë në përputhje me KNj1 të SKZH-së për shkak të procesit të decentralizimit në Kosovë. Kjo mund të jetë mbështetja e komunës për buxhetimin e mësimdhënësve në sistemin arsimor, institucionet parashkollore, ose mbështetja e qendrave të AAP-së. Megjithatë, edhe pse masat kërkojnë mbështetjen e komunave, aktualisht nuk ekziston asnjë mekanizëm për të siguruar që buxhetet dhe veprimet e komunave janë realisht në përputhje me KNj1 të SKZH-së. Një mekanizëm i tillë mund të jetë përmes një udhëzimi administrativ nga Ministria e Pushtetit Lokal për t'i prioritetizuar masat e KNj1 të SKZH-së gjatë parashikimit të alokimeve të buxhetit komunal. Mungesa e këtij lloj mekanizmi u vu re në intervistat me palët e interesit, të cilat cituan se bashkëpunimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal mungonte gjatë zbatimit të KNj1 të SKZH-së, përveç në rastin e projekteve të financuara nga donatorët. Për këtë të

⁸¹ Emri ka ndryshuar që nga hartimi i SKZH-së.

⁸² Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit (MSA).

fundit, kjo ndodhi shpesh për shkak se vetë donatori ose partnerët zbatues po i krijojnë lidhjet e nevojshme me nivelin komunal për koordinimin e aktiviteteve të projektit.

121. **Pengesat në fokus apo pika e theksit:** Orientimi i KNj1 të SKZH-së drejt rritjes orienton aktivitetet e KNj1 drejt trajtimit të njerëzve si 'lëndë djegëse për ekonominë' në vend që të kërkojë në mënyrë më holistike të rrisë mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve. Nevojat ekonomike janë reale, por mungesa e dimensioneve të tjera që nuk lidhen menjëherë me ekonominë, siç është shëndetësia, pengon shkallën në të cilën KNj1 e SKZH-së mund të japë kontribute të qëndrueshme në mirëqenien e përgjithshme kombëtare – siç mund të shprehet në treguesit e kohezionit social në kornizën e nivelit makro.
122. Për më tepër, fokusi në rritjen e ekonomisë minimizon kontributet e mundshme të KNj1 të SKZH-së për t'i trajtuar në mënyrë të qëndrueshme çështjet e barazisë të cituara në boshllëqet dhe sfidat në seksionin e relevancës. Integrimi gjinor kishte relativisht pak fokus në aktivitetet e KNj1 të SKZH-së. Format e tjera të barazisë përfshirë adresimin e përfshirjes së popullatave të marginalizuara dhe/ose popullatave të vështira për t'u arritur nuk adresohen në mënyrë specifike brenda masave dhe aktiviteteve – as nuk janë të matura përmes treguesve. Për fund, elementet që lidhen me qëndrueshmërinë dhe ndikimin në mjedis minimizohen në modelin aktual për shkak të theksimit të rritjes në KNj1 të SKZH-së. Ka pak masa ose aktivitete që mund të shoqërohen me rritje alternative ekonomike, energji të gjelbër ose kontribute të tjera të mundshme kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm. Një temë kryesore emergjente ka përfshirë kufizimet konceptuale të KNj1 të SKZH-së për të shërbyer si një mjet më i madh zhvillimi dhe rëndësinë e rikonceptualizimit të KNj1 të SKZH-së si një kontribut në zhvillimin njerëzor - dhe jo në kapitalin njerëzor.

4.0 PËRFUNDIMET

Përmbledhje

123. Bazuar në modelet në gjetje, disa vëzhgime kryesore veçohen si më të rëndësishme në lidhje me këtë KNj1 të SKZH-së të parë për Kosovën.
124. Procesi i hartimit të KNj1 të SKZH-së ishte rigoroz dhe i bazuar në dëshmi. Prioritetet e identifikuar në KNj1 të SKZH-së konsiderohen të rëndësishme, edhe pse ndoshta jo të mjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha nevojat e zhvillimit. Teoria e nënkuptuar e ndryshimit (TeN) brenda KNj1 fokusohet shumë në synimet e rritjes ekonomike përmes forcimit të arsimit dhe rritjes së punësimit. Megjithatë, ka boshllëqe në TeN dhe brenda masave që mund të adresohen në SKZH-në e ardhshme (për shembull, ndërsa masa 7 fokusohet te kontratat dhe kushtet e punës, kjo në fakt fokusohet tek ata që janë tashmë të punësuar dhe jo tek politikat për rritjen e punësimit). Për më tepër, konsiderata të tjera të mirëqenies si shëndeti, kultura ose kohezioni social nuk janë të pranishme dhe kjo përbën një hendek kritik.
125. KNj1 e SKZH-së ka potencial për të shërbyer si një instrument i rëndësishëm afatmesëm midis mandateve dhe do të mund të sigurojë një mekanizëm të rëndësishëm për orientimin drejt kornizave të jashtme, siç janë OZHQ-të dhe agjenda e anëtarësimit në BE (i quajtur Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit (MSA)). Megjithatë, KNj1 e SKZH-së nuk shërben si orientim primar për Qeverinë e Kosovës ose donatorët si dhe strategjitë sektoriale priren të kenë dominim më të madh. Orientimi i fortë i rritjes ekonomike në KNj1 të SKZH-së kufizon shkallën në të cilën mund të merren parasysh temat e barazisë transversale dhe duke qenë kështu, konsideratat gjinore dhe të qasjes (rurale kundrejt urbane, të cenueshme kundrejt të pasurve, etj) nuk janë fort të dukshme në KNj1 të SKZH-së.

126. Treguesit ekonomikë të nivelit makro janë përmirësuar në mënyrë modeste që nga viti 2016, por kontributet e KNj1 të SKZH-së në këto arritje ka të ngjarë të kenë qenë minimale për shkak të niveleve relativisht të ulëta të përfundimit të aktiviteteve dhe rënies së treguesve të nivelit të rezultateve në lidhje me masat përkatëse. Orientimi ekonomik i treguesve të nivelit makro gjithashtu pengon gjurmimin e arritjeve në sektorë të tjerë në nivelin makro, siç është arsimi ose shëndetësia. Ekzistojnë tregues të kohezionit social në kornizën e performancës të nivelit makro të KNj1 të SKZH-së, të cilët mund të shërbejnë si masa përfaqësuese për elementet e tilla si arsimi dhe shëndetësia, por këta tregues të kohezionit social nuk janë matur në mënyrë të qëndrueshme si treguesit ekonomikë.
127. Megjithatë, është bërë njëfarë progresi kundrejt masave dhe aktiviteteve, por ka pasur një lansim më të ulët nga sa ishte parashikuar sipas caqeve të përcaktuara. Shumë nga këto arritje kanë qenë në sferën e krijimit të kornizave ligjore të kërkuara ose komisionimit të studimeve fillestare në lidhje me masat. Progresi i veçantë vërehet në ato masa që morën mbështetje nga donatorët për projekte specifike. Hapat e ardhshëm në shumë prej këtyre masave do të ishin ndërmarrja e veprimeve për t'i ndryshuar sistemet ose procedurat - veçanërisht për sa i përket burimeve njerëzore dhe kapaciteteve.
128. Në krahasim me rishikimin afatmesëm të vitit 2018, performanca e KNj1 të SKZH-së gjatë gjysmës së dytë të ciklit ka rënë pak në vitet pasuese. Kjo ka të ngjarë të jetë për shkak të kufizimeve strukturore dhe arkitekturore të vërejtura për sa i përket mekanizmave për zbatimin e KNj1 të SKZH-së. Kufizimi primar për KNj1 të SKZH-së ka qenë se ai nuk është integruar mirë në proceset e tjera qeveritare, gjë që zvogëlon shkallën e rëndësisë që KNj1 e SKZH-së ka në formësimin e politikave, strategjive dhe zbatimit të planeve të punës të qeverisë dhe orientimit të prioriteteve të qeverisë. Ka disa faktorë të tjerë që kanë shërbyer gjithashtu për të penguar zbatimin e KNj1 të SKZH-së dhe zvogëlimin e rëndësisë së saj në veprimet e Qeverisë.
- a. Së pari, fokusi i KNj1 të SKZH-së në prioritizimin e prioriteteve dhe theksi i saj në rritjen ekonomike ka penguar aftësinë e saj për të shërbyer si një busull më e madhe strategjike për strategji të tjera dhe për integrimin e temave të barazisë në mënyrë transverzale.
 - b. Së dyti, KNj1 e SKZH-së ka një plan veprimi të zhvilluar mirë i cili përshkruan në detaje kostimin dhe treguesit kyç të performancës dhe përgjegjësitë përkatëse të ministrive. Sidoqoftë, sado që ky dokument është i përgatitur mirë në aspektin teknik, as zbatimi i KNj1 të SKZH-së dhe as vetë plani i veprimit, gjithashtu nuk janë të integruar mirë në proceset ekzistuese qeveritare për buxhetin, planifikimin dhe raportimin. Ky trajtim de fakto i KNj1 të SKZH-së si 'i jashtëm' për sistemet qeveritare kufizon shkallën në të cilën mund të gjurmohet progresi kundrejt vetë KNj1 të SKZH-së, kufizon burimet për aktivitetet e KNj1 të SKZH-së dhe pasqyrimin dhe analizën për llogaridhënie.
 - c. Së treti, KNj1 e SKZH-së ka një kornizë teknike të shëndoshë të monitorimit dhe performancës, por kjo kornizë tenton të trajtohet si një dokument i pavarur që është integruar në mënyrë jokonsistente në proceset burokratike ekzistuese të qeverisë. Kjo pengon shkallën në të cilën mund të kryhet monitorimi i progresit të KNj1 të SKZH-së. Të dhënat e menaxhimit në lidhje me shpenzimet buxhetore apo progresi i aktivitetit të KNj1 të SKZH-së mund të gjenden brenda sistemit qeveritar, por janë shumë të ndara. Të dhënat shpërndahen në baza të ndryshme të të dhënave të menaxhuara nga ministri ose departamente të ndryshme qeveritare dhe nuk ndahen ose grumbullohen lehtë. Qasja e publikut në këto të dhëna është e kufizuar dhe ato të dhëna që publikohen priren të orientohen drejt kornizave të tjera (të tilla si strategjitë sektoriale) dhe jo drejt KNj1 të SKZH-së dhe kategoritë e alokimit të burimeve dallojnë nga ato të cituara në SKZH. Kjo kufizon shkallën në të cilën mund të gjurmohen lidhjet nga aktivitetet te masat, te shtyllat, e deri te treguesit e nivelit makro, si dhe shkallën e transparencës publike ndaj KNj1 të SKZH-së.

- d. Për fund, pronësia politike dhe vullneti për KNj1 të SKZH-së është luhatur gjatë ciklit. Bazuar në modelet e progresit në KNj1 të SKZH-së, duket se ka pasur një periudhë prej rreth 30 muajsh në mes të ciklit të pronësisë relativisht të ulët të KNj1 të SKZH-së në qeveri. Kjo përkon me një periudhë të tranzicioneve të shumta të qeverive në Kosovë dhe sugjeron që pronësia politike e KNj1 të SKZH-së varet shumë nga motivimet individuale, e nuk është e mishëruar në sistem.

Mësimet e nxjerra

129. Mësimet e nxjerra synojnë të jenë vëzhgime ose modele që dalin nga një vlerësim specifik që mund të përgjithësohen në kontekste të tjera përtej fokusit të menjëhershëm të vlerësimit. Seksioni i mëposhtëm mbi rekomandimet thekson parimet e rëndësishme që duhen marrë në konsideratë në hartimin e KNj1 të SKZH-së së ardhshme. Për sa i përket mësimëve të përgjithësuar të nxjerra, ekzistojnë katër mësimet që do të ishin të rëndësishme për t'u konsideruar në kontekste të tjera.
130. **SKZH është e rëndësishme për orientimin e prioritetëve të qeverisë.** Kjo ishte strategjia e parë kombëtare për zhvillim e hartuar nga Kosova dhe, përkundër sfidave të pranishme, pranohet gjerësisht se SKZH-ja është një mjet i rëndësishëm për formësimin e prioritetëve të qeverisë dhe ofrimin e një vizioni afatgjatë përtej mandateve individuale të qeverisë.
131. **Mënyra se si strukturohet SKZH-ja brenda qeverisë është kritike për suksesin.** Për të siguruar rigorozitet, SKZH-ja mbështetet shumë në inputet dhe mbështetjen e jashtme, duke filluar nga kontraktimi i ekspertëve të jashtëm të ngarkuar me zhvillimin e koncepteve, deri te marrja e mbështetjes nga donatorët për ushtrimin e SKZH-së, dhe te kontraktimi i konsulentëve të jashtëm për hartimin e planeve operationale që shoqërojnë SKZH-në. Synimi ishte promovimi i rigorozitetit dhe rekrutimit të ekspertizës, megjithatë, kjo ndikoi butësisht në integrimin e SKZH-së në pjesën tjetër të proceseve normale të qeverisë dhe më pas uli shkallën e llogaridhënies dhe shkallën e pronësisë nga qeveria në SKZH. Pothuajse të gjitha rekomandimet në seksionin vijues lidhen me këtë mësim të rëndësishëm të nxjerrë.
132. **SKZH-ja mund të luajë një rol të rëndësishëm në bisedat me donatorë, por nuk duhet të udhëhiqet nga prioritetet e donatorëve.** Në hartimin e SKZH-së u theksua prioritizimi i prioritetëve si një mënyrë për t'i menaxhuar dhe për t'ju dhënë kuptim të gjitha prioritetëve konkurrues që dalin nga një shumëllojshmëri të strategjive. Synimi ishte të ndihmonte fillimisht në drejtimin e investimeve të donatorëve në ato fusha. Megjithatë, masat specifike që u zgjodhën përfundimisht në kuadër të KNj1 të SKZH-së u zgjodhën me shpresën se këto do të ishin ato që donatorët kishin më shumë interes për financim. Me fjalë të tjera, SKZH-ja u përfrua me interesat e donatorëve në vend që të ndihmonte në përfrimin e interesave të donatorëve me prioritetet e qeverisë. Aty ku financimi i donatorëve u bë më pas, këto masa ishin relativisht të suksesshme. Megjithatë, për masat që nuk përfunduan duke marrë mbështetje të konsiderueshme nga projekte të donatorëve, me SKZH-në u bë përpjekje të siguroheshin fonde të mjaftueshme për shkak të shkëputjes së saj nga proceset e tjera të burimeve të qeverisë.
133. **SKZH-ja mund të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për një koordinim më sistematik dhe më të strukturuar të donatorëve.** Ka relativisht pak koordinim nga qeveria për angazhimin e donatorëve. Ekziston një sistem i menaxhimit të informacionit të donatorëve, ku donatorët supozohet të fusin informacionin e përditësuar të projektit dhe investimeve. Megjithatë, ky menaxhim nuk përditësohet vazhdimisht nga të gjithë donatorët dhe raportimi i sistemit të menaxhimit të informacionit të donatorëve nuk është i lidhur me raportimin e SKZH-së. Për më tepër, qasja në sistemin e menaxhimit të informacionit të donatorëve është e kufizuar, duke reduktuar potencialin e tij për t'u integruar me platforma të tjera raportuese. Integrimi më i ngushtë i SKZH-së me informacionin e donatorëve në

monitorim dhe raportim mund të sigurojë një qasje më sistematike dhe më të strukturuar për koordinimin dhe bisedat e donatorëve.

5.0 REKOMANDIMET

134. Rekomandimet e vlerësimit bazohen në modelet që dalin nga gjetjet kryesore. Informatat kthyese mbi rekomandimet preliminare janë marrë nga ZPS dhe GRV përmes dy prezantimeve të punëtorive në Kosovë si për gjetjet ashtu edhe për rekomandimet. Në përgjithësi, rekomandimet janë të orientuara drejt hartimit të SKZH-së së ardhshme – veçanërisht për KNj1 të SKZH-së. Megjithatë, disa nga këto rekomandime mund të jenë të zbatueshme për të gjithë procesin e hartimit të SKZH-së. Nënrekomandimet duhet të konsiderohen si rrugë të mundshme për arritjen e ndryshimit të dëshiruar të përshkruar në rekomandime. Rekomandimet bazohen në këto pesë përfundime kryesore:
135. **Mbështetja në arritjet e KNj1 të SKZH-së ekzistuese.** Edhe pse më i ngadalshëm nga sa ishte parashikuar, ka pasur progres drejt një numri masash dhe aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së aktuale. Një KNj1 e SKZH-së e re duhet të përfshijë një rishikim të pikave kyçe të progresit të deritanishëm në masat përkatëse, duke përfshirë një pasqyrë të gjendjes së progresit drejt secilës masë. Kjo mund të përfshijë identifikimin e hapave të ardhshëm që duhen marrë në secilën masë që duhet të merret parasysh në KNj1 të SKZH-së së ardhshme.
136. **Ristrukturimi i KNj1 të SKZH-së drejt një orientimi më strategjik të zhvillimit njerëzor.** Kjo përfshin ristrukturimin e arkitekturës së KNj1 të SKZH-së drejt një “strategjie të strategjive” dhe jo drejt një prioritizimi të prioriteteve. Riorientim të KNj1 të SKZH-së drejt zhvillimit njerëzor dhe jo ekskluzivisht në kapitalin njerëzor. Strategjia duhet të përfshijë më shumë sesa rritjen ekonomike. KNj1 e SKZH-së duhet të mbajë një fushëveprim shumëvjeçar për tejkalimin e mandateve dhe duhet të vazhdojë të jetë e përafruar me agjendat e vitit 2030 të BE-së dhe OZHQ-ve. Strategjia duhet t’i integrojë prioritetet transversale të gjinisë, barazisë, qasjes dhe qëndrueshmërisë mjedisore në mënyrë më të dukshme në të gjitha masat dhe aktivitetet e shtyllave.
137. **Integrimi më i ngushtë i KNj1 të SKZH-së në sistemet ekzistuese qeveritare.** Kjo përfshin sigurimin e integritetit të strategjive sektoriale të KNj1 të SKZH-së dhe planeve të punës përmes një mekanizmi më të fortë të kontrollit (*cross-check*), të përafruar me mekanizmat ligjorë ekzistues të kontrollit në ministri. Krijimi i Udhëzimeve Administrative për Departamentin e Buxhetit të MFPT mbi opinionet e kostimit të KNj1 të SKZH-së dhe prioritizimin e burimeve dhe rishikimin e ligjit të buxhetit për qartësimin e roleve dhe përgjegjësisë në departamentet e buxheteve në ministri. Në fund, të merret parasysh krijimi i Udhëzimeve Administrative nga Ministria e Pushtetit Lokal për Komunat për prioritizimin e buxhetimit për aktivitetet e KNj1 të SKZH-së në nivel komunal.
138. **Rritja e mekanizmave për llogaridhënie dhe raportim kundrejt KNj1 të SKZH-së.** Kjo përfshin zhvillimin e sistemeve për përcjelljen e progresit kundrejt aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së, duke përfshirë raportimin mbi përfundimin e aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së në planet e punës të Ministrive. Zhvillim i modeleve të monitorimit dhe raportimit që zbërthejnë arritjet dhe shpenzimet sipas masave dhe aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së e të cilat ndahen me ZKM-në dhe Kuvendin çdo vit. Rritje e përafrimit të të dhënave ekzistuese të menaxhimit përmes lidhjes së bazave të të dhënave dhe rritjes së shkëmbimit të të dhënave midis ministrive dhe departamenteve. Rritje e monitorimit publik të KNj1 të SKZH-së përmes publikimit të të dhënave të papërpunuara për platforma (ang. “dashboards”) publike.
139. **Sistematizimi i pronësisë politike të nivelit të lartë të KNj1 të SKZH-së.** KNj1 e SKZH-së aktualisht është shumë e varur nga motivimet individuale të cilat mund të luhaten gjatë tranzicioneve qeveritare. Vullneti politik për ta mbështetur KNj1 të SKZH-së duhet të

kërkohej të forcohet përmes sistematizimit të pronësisë së KNj1 të SKZH-së, duke përfshirë përfaqësimin e gjerë politik në nivele mbikëqyrëse dhe menaxheriale përtej ZKM-së dhe ZPS-së. Një mënyrë për ta bërë këtë do të ishte përmes formimit të një Komiteti Drejtues të KNj1 të SKZH-së, i përbërë nga një kombinim i përfaqësimit të ZKM-së dhe Kuvendit, duke përfshirë shoqërinë civile. Ky komitet do të duhej të kishte mandat për rishikimin vjetor të progresit të KNj1 të SKZH-së. Përveç mekanizmave të kontrollit të përafrimit ligjor të përmendur më parë, kjo mund të përfshijë fuqizimin e ZPS-së për koordinimin me organet tjera qeveritare përgjegjëse për shtjellimin e planeve të punës të qeverisë dhe sigurimin e burimeve për të zbatuar vëmendje më të madhe në integrimin e aktiviteteve dhe masave të KNj1 të SKZH-së në sigurimin e burimeve, planeve të punës dhe raportimin e qeverisë.

TABELA 8: REKOMANDIMET

| Ndryshimi i dëshiruar | Rekomandimi |
|--|--|
| Mbështetja në arritjet e masave dhe aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së ekzistuese | <p>Rekomandimi 1: Rishikimi i Progresit të Masave të KNj1 të SKZH-së. ZPS/ZKM duhet të mbështet një proces rishikimi në hartimin e KNj1 të SKZH-së së re që përshkruan piketat ekzistuese të arritura në secilën masë dhe identifikon se cilët hapa të tjerë kërkohen në secilën masë. Kjo mund të jetë pjesë e një analize SWOT por gjithashtu mund të bazohet në të dhënat e ofruara në këtë raport vlerësimi.</p> |
| Ristrukturimi i KNj1 të SKZH-së drejt zhvillimit strategjik njerëzor. | <p>Rekomandimi 2: Arkitektura e Strategjisë së Strategjive. ZPS/ZKM duhet të riorientojë fokusin e KNj1 të SKZH-së drejt theksimit të KNj1 të SKZH-së si një busulle strategjike për t'i orientuar strategjitë e tjera sektoriale. Kjo mund të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. Strukturimin e KNj1 të SKZH-së si strategji gjithëpërfshirëse për strategji sektoriale ii. Integrimin e KNj1 të SKZH-së në kornizën kombëtare të menaxhimit strategjik me të cilën strategjitë sektoriale duhet të përafrohen. <p>Rekomandimi 3: Orientimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm. ZPS/ZKM duhet të riorientojë fokusin e KNj1 të SKZH-së jo vetëm drejt rritjes ekonomike por gjithashtu të përfshijë një agjendë zhvillimi më tërësore që vizibilizon elementet e qëndrueshmërisë dhe mirëqenies. Kjo mund të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. Ndryshimin e fokusit të shtyllës KNj1 nga kapitali njerëzor në zhvillim njerëzor. ii. Ndryshimin e orientimit të përgjithshëm të KNj1 të SKZH-së nga rritja e pastër ekonomike në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik iii. Integrimin e dimensioneve joekonomike në KNj1 të SKZH-së duke përfshirë shëndetin, kulturën, kohezionin social, qëndrueshmërinë mjedisore, ndër të tjera, për të siguruar fokus më tërësor të zhvillimit. iv. Integrimin më të dukshëm të temave transverzale të gjinisë, përfshirjen e grupeve të marginalizuara, qasjes (rural/urban) dhe qëndrueshmërisë mjedisore në të gjitha aktivitetet dhe të gjitha masat. <p>Rekomandimi 4: Përafrimi i Kornizave të Jashtme. ZPS/ZKM duhet ta përmirësojë përafrimin e KNj1 të SKZH-së me OZHQ-të dhe zbatimin e kornizave të MSA-së nëpërmjet integritit dhe monitorimit më të mirë të këtyre kornizave. KNj1 e SKZH-së mund të bëhet mjet gjithëpërfshirës për lokalizimin e OZHQ-ve në harmoi me Rezolutën e OZHQ-së. Kjo mund të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. Ruajtjen e një fushëveprimi shumëvjeçar të përafruar me agjendat e BE-së dhe OZHQ-ve për vitin 2030 ii. Integrimin e treguesve të nivelit makro të OZHQ-ve dhe të BE-së në kornizën e rezultateve të performancës së KNj1 të SKZH-së iii. Përcaktimi i objektivave i të gjitha niveleve të treguesve bazuar në analizë adekuate <p>Rekomandimi 5: Rezultatet Strategjike dhe Plani i Veprimit. ZPS/ZKM duhet ta mbajë ekzistencën e një plani veprimi të KNj1 të SKZH-së dhe kornizës së</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>rezultateve të performancës në KNj1 të SKZH-së së re, por ato duhet të përafrohen me riorientimin strategjik të KNj1 të SKZH-së. Kjo mund të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. Zhvillimin e një kornize strategjike të llogaridhënies që krijon lidhje të qarta midis aktiviteteve, masave dhe shtyllave, por siguron fleksibilitet për t'u përshtatur me ndryshimin e prioriteteve sipas drejtimeve strategjike. ii. Integrimin e treguesve të nivelit makro që përfshijnë elemente në shëndetësi, kulturë, arsim, kohezion social dhe tregues të tjerë të mirëqenies. iii. Integrimin e treguesve të nivelit makro të OZHQ-ve dhe të BE-së në kornizën e performancës së KNj1 të SKZH-së iv. Kërkesën që të gjitha strategjitë sektoriale të shprehin një lidhje të qartë midis planeve sektoriale të punës me rezultatet, masat dhe shtyllat e KNj1 të SKZH-së, duke përfshirë identifikimin e TKP-ve përkatëse për aktivitetet e planit të punës sektorial të lidhura me KNj1 të SKZH-së. |
| <p>Integrimi i KNj1 të SKZH-së në sistemet dhe proceset ekzistuese qeveritare.</p> | <p>Rekomandimi 6: Integrimi i Planifikimit Sektorial. ZPS/ZKM duhet ta përforcojë mënyrën se si KNj1 e SKZH-së integrohet në sistemin kombëtar të planifikimit të vazhdueshëm dhe KNj1 e SKZH-së duhet të shërbejë si bazë për zhvillimin e strategjive sektoriale dhe planeve të punës. Kjo mund të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. Nxjerrjen e një udhëzimi administrativ për ministritë duke siguruar që strategjitë sektoriale janë të lidhura me objektivat strategjike të KNj1 të SKZH-së ii. Sigurimin e një mekanizmi në të cilin aktivitetet pasuese sektoriale operacionale dhe të planit të punës mund të lidhen në një zinxhir të qartë shkakësor me objektivat e përgjithshme të KNj1 të SKZH-së. <p>Rekomandimi 7: Mekanizmi sektorial i verifikimit të kryqëzuar. ZPS/ZKM duhet t'i përditësojë udhëzuesit dhe udhëzimet administrative për zhvillimin e strategjive për të krijuar një mekanizëm të përforcuar të kontrollit (<i>cross-check</i>) për të siguruar që strategjitë sektoriale dhe planet e punës janë në përputhje me KNj1 të SKZH-së. Kjo mund të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. ZPS/ZKM duhet t'i përditësojë Udhëzimet Administrative dhe udhëzuesin në shabllonet për zhvillimin e strategjive për të siguruar që strategjitë pasuese sektoriale të përputhen me masat dhe rezultatet specifike të KNj1 të SKZH-së. ii. Nëpërmjet këtyre UA dhe udhëzuesve, të sigurohet që departamentet ligjore në secilën ministri përfshijnë në kontrollin e tyre të strategjive sektoriale kundrejt legjislacionit aktual nëse strategjia sektoriale është në përputhje me KNj1 të SKZH-së. iii. Krijimin e një mekanizmi të kontrollit të ZKM-së – të kryer nga ZPS – për të krijuar një kodim me ngjyra të strategjive sektoriale sipas përafrimit me KNj1 të SKZH-së (brenda, në linjë, në konflikt, jashtë por jo në konflikt, e paparashikuar por e rëndësishme). <p>Rekomandimi 8: Integrimi i Burimeve. ZPS/ZKM duhet të krijojë një mekanizëm të përforcuar për të siguruar financimin e aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së përmes ndarjes së buxhetit ministror. Kjo mund të përfshijë⁸³:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. Krijimin e një procesi të rishikimit për vlerësimin e kostimit të KNj1 të SKZH-së dhe burimet e mundshme për mbështetje, përfshirë qeverinë e brendshme dhe donatorët e jashtëm. ii. Krijimin e një Udhëzimi Administrativ me departamentin e buxhetit për të nxjerrë opinione mbi realizueshmërinë e kostimit të KNj1 të SKZH-së siç dëshmohet në strategjitë sektoriale dhe planet e punës. iii. Krijimin e një udhëzimi administrativ me departamentin e buxhetit për të kërkuar prioritizimin e ndarjes së burimeve nga ministritë për aktivitetet e planit të punës të lidhura me masat e KNj1 të SKZH-së. iv. Përcaktimin e rishikimit të kodimit të kodeve burimore të KNj1 të SKZH-së që do të përafrohet me kodimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve |

⁸³ Ky do të ishte një rekomandim i rëndësishëm për të gjithë SKZH-në për të gjitha shtyllat në kuadër të Kornizës Kombëtare të Menaxhimit Strategjik. Fokusi i vlerësimit është në KNj1 dhe ky rekomandim duhet të shërbejë si një listë kontrolli për të siguruar që mekanizmat e nevojshëm janë të pranishëm diku për të siguruar integrimin e burimeve.

| | |
|---|---|
| | <p>për të lejuar gjurmimin më të mirë të alokimit të burimeve kundrejt KNj1 të SKZH-së.</p> <p>v. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të Punës dhe Transfereve, rishikimin e strukturës buxhetore për të lidhur më mirë buxhetimin e linjës me buxhetimin e programit dhe të performancës.</p> <p>Rekomandimi 9: Integrimi nën-kombëtar. ZPS/ZKM duhet të krijojë një mekanizëm të përforcuar për të siguruar lidhjen e strategjive të KNj1 të SKZH-së me planifikimin dhe burimet komunale. Kjo mund të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. Krijimin e një udhëzimi administrativ me Ministrinë e Pushtetit Lokal për të siguruar që Komunitat janë buke prioritizuar burimet për mbështetjen e aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së përmes departamenteve përkatëse komunale. ii. Komisionimin e studimeve të kostimit për zbatimin e KNj1 të SKZH-së në nivelet komunale. iii. Përcaktimin e punës për ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për orientimin e ministrive dhe departamenteve në nivel kombëtar dhe komunal mbi implikimet e objektivave të KNj1 të SKZH-së për planet e punës dhe buxhetet komunale. |
| <p>Rritja e mekanizmave për llogaridhënie dhe raportim kundrejt KNj1 të SKZH-së</p> | <p>Rekomandimi 10: Forcimi i monitorimit të brendshëm. ZPS/ZKM duhet të krijojë një mekanizëm të përforcuar për të siguruar monitorimin e brendshëm sistematik të progresit të KNj1 të SKZH-së nëpërmjet ushtrimet e mandatuara të mbledhjes së të dhënave në lidhje si me alokimet dhe shpenzimet financiare ashtu edhe progresin e aktivitetit. Kjo mund të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. Zhvillimin e sistemeve të raportimit të buxhetit dhe aktiviteteve që lejojnë përcjelljen dhe raportimin e ndarjeve të kostos për aktivitetet e KNj1 të SKZH-së nga departamente dhe ministri të ndryshme. ii. Rishikimin e sistemeve të menaxhimit të të dhënave për të shtuar ndarjen dhe grumbullimin e të dhënave të menaxhimit nëpër bazat e veçanta të të dhënave për të përcjellë më mirë progresin e KNj1 të SKZH-së. iii. Zhvillimin e një kornize vjetore të raportimit brenda ZPS-së që i raporton ZKM-së për përqindjet e aktiviteteve të përfunduara nga Ministrinë kundrejt KNj1 të SKZH-së (krahas strategjive përkatëse sektoriale). <p>Rekomandimi 11: Vendosja e monitorimit të KNj1 të SKZH-së nga shoqëria civile. ZPS/ZKM duhet të krijojë një mekanizëm për të siguruar që ka monitorim publik të progresit të KNj1 të SKZH-së. Kjo mund të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. Komisionimin e një subjekti të shoqërisë civile për të krijuar dhe mbajtur një platformë (ang. “dashboard”) të aktiviteteve të KNj1 të SKZH-së të përditësuar çdo vit. ii. Krijimin e platformave të ndarjes së buxhetit publik të strukturuar për ta ilustruar ndarjen e burimeve të Qeverisë sipas objektivave dhe masave të KNj1 të SKZH-së. |
| <p>Sistematizimi i pronësisë politike të KNj1 të SKZH-së</p> | <p>Rekomandimi 12: Strukturat e Pronësisë Politike. ZPS/ZKM duhet të krijojë një mekanizëm të përforcuar për të siguruar që ka pronësi të mjaftueshme politike të KNj1 të SKZH-së duke përfshirë përfaqësimin e gjerë politik nga nivele të ndryshme në komitetet drejtuese të krijuara për ta shqyrtuar progresin kundrejt KNj1 të SKZH-së dhe për të udhëzuar për veprimet pasuese kur ndodhin vonesa në zbatim. Kjo mund të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. Themelimin e një komiteti drejtues të KNj1 të SKZH-së të përbërë nga përfaqësimi i gjerë politik i nivelit të lartë për të siguruar pronësi më të gjerë, përfshirë përfaqësim nga ZKM-ja, Kuvendi apo ministrinë, i cili takohet në baza vjetore për shqyrtimin vjetor të progresit të KNj1 të SKZH-së. ii. Krijimin e një mekanizmi të raportimit me anë të të cilit ZPS-ja grumbullon dhe raporton progresin në raport me KNj1 të SKZH-së dhe ia prezanton komitetit drejtues të KNj1 të SKZH-së duke theksuar vonesat në zbatim dhe veprimet e kërkuara që duhet të ndërmerren për përafrim. |

| | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> iii. Marrjen parasysh të përfshirjes së përfaqësimit të shoqërisë civile dhe sektorit privat në komitetin drejtues të KNj1 të SKZH-së për të ofruar perspektiva të jashtme mbi progresin e SKZH-së. iv. Kërkesën që ZPS-ja dhe Sekretariati Koordinues i Qeverisë (i cili koordinon zhvillimin e planeve të punës të qeverisë) të koordinohen për të kërkuar pajtueshmërinë e ministrive me objektivat e KNj1 të SKZH-së, duke përfshirë lidhjen e strategjive sektoriale dhe planeve të punës me objektivat e KNj1 të SKZH-së. |
|--|--|

6.0 SHTOJCAT

Shtojca 1: Termat e Referencës

Termet e Referencës për Vlerësimin e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim të Kosovës (2016-2021)

1. Hyrje

1.1. Vlerësimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim të Kosovës

Këto Terma të Referencës (TeR) janë hartuar për vlerësimin e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të Kosovës të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021, në tekstin e mëtejme referuar si Vlerësimi.

Planifikimi kombëtar në Kosovë mbështetet nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH), e cila ofron udhëzime të përgjithshëm strategjik. SKZH-ja 2016-2021 ishte strategjia e parë e tillë e zhvilluar nga institucionet e Kosovës, që synonte të përmirësonte cilësinë e politikave publike dhe të kontribuonte në procese vendimmarrëse efektive që do të integronin agjendën e përgjithshme të zhvillimit të Kosovës me agjendën e integritit evropian dhe burimet në dispozicion.

SKZH-ja është e ndarë në katër shtylla tematike: kapitali njerëzor, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, zhvillimi i industrive konkurruese dhe zhvillimi i infrastrukturës. Një plan zbatimi më i detajuar – udhërrëfyesi i SKZH-së – i cili përfshin një kostim të masave dhe treguesve për zbatimin dhe rezultatet, u përgatit në gjysmën e parë të vitit 2017. Udhërrëfyesi i SKZH-së (2016-2021) është në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara për të matur kontributin e politikave kombëtare ndaj Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Zhvillimi dhe zbatimi i SKZH-së (2016-2021) udhëhiqet nga Zyra e Planifikimit Strategjik brenda Zyrës së Kryeministrit (ZPS/ZKM). Një raport progresi mbi zbatimin e SKZH-së u krye në vitin 2018, i cili theksoi rezultatet e arritura dhe kontributin e SKZH-së drejt caqeve globale të OZHQ-ve. Raporti i progresit shërbeu gjithashtu si një vlerësim në mes të vitit për të informuar disa nga rekomandimet për zhvillimin e SKZH-së së ardhshme e cila do të përfshijë një periudhë kohore deri në vitin 2030.

Ndërsa ekziston një numër strategjish sektoriale dhe tematike, planifikimi i bazuar në dëshmi, hartimi dhe zbatimi i strategjive dhe politikave mbetet një sfidë kryesore që pengon ndërhyrjet strategjike dhe progresin në treguesit kryesorë të zhvillimit në Kosovë. Prandaj, në përputhje me planet dhe përgatitjen për zhvillimin e SKZH-së së re 2030, ZPS-ja/ZKM-ja ka kërkuar mbështetjen e UNICEF-it për të ndërmarrë një vlerësim përmbledhës të Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të Kosovës të SKZH-së 2016-2021 për të vlerësuar progresin e bërë me një fokus kah e ardhmja, duke u mbështetur në mësimet e bazuara në dëshmi për të informuar hartimin dhe zbatimin e SKZH-së 2030.

1.2 Arsyetimi i Vlerësimit

SKZH-ja (2016-2021) është strategjia e parë që përshkruan prioritetet kryesore kombëtare dhe synon të integrojë planifikimin dhe ndërhyrjet strategjike në Kosovë. Përveç raportit të progresit të vitit 2018 për zbatimin e SKZH-së (2016-2021), asnjë vlerësim nuk është kryer për të qartësuar progresin e bërë drejt zbatimit të masave. Prandaj, pasi SKZH-ja aktuale (2016-2021) hyn në vitin e fundit të zbatimit, një vlerësim përmbledhës i fokusuar është i nevojshëm dhe do të shërbejë për qëllime të të mësuarit, si dhe për të informuar zhvillimin dhe zbatimin e SKZH-së së ardhshme 2030 që pritet të përfundojë deri në vitin 2021. Vlerësimi përcakton të vlerësojë performancën dhe kontributin e seksioneve dhe institucioneve përkatëse drejt qëllimeve të zhvillimit kombëtar.

Vlerësimi do të vlerësojë rëndësinë, efektivitetin, qëndrueshmërinë, efikasitetin, sinergjitë dhe ndryshimet afatgjata të lidhura me SKZH-në, kontributin e saj në OZHQ-të, si dhe zgjedhjet programatike dhe strategjike të bëra në zbatimin e SKZH-së për t'i identifikuar praktikat premtuese, për të nxjerrë mësimet dhe rekomandime me fokus kah e ardhmja që mund të informojnë zhvillimin e

SKZH-së 2030. Ndërsa SKZH-ja mbulon një gamë të gjerë prioritetesh, Vlerësimi do të përqendrohet në mënyrë specifike në shtyllën "Kapitali Njerëzor" për t'i vlerësuar kriteret kryesore të vlerësimit për këtë fushë, ndërsa gjetjet e përgjithshme dhe rekomandimet do t'i identifikojnë mësimet që janë të zbatueshme për të gjitha shtyllat.

Vlerësimi është komisionuar nga ZPS-ja/ZKM-ja, dhe UNICEF-i do t'i japë udhëzimet teknike ekipit të vlerësimit dhe do të mbështesë ZPS-në/ZKM-në me menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë sipas nevojës. ZPS-ja/ZKM-ja dhe UNICEF-i do të punojnë ngushtë për të siguruar një zbatim dhe menaxhim të mirë të Vlerësimit.

1.3 Palët e interesit

Vlerësimi mund të përdoret nga një gamë e gjerë palësh interesi, disa prej të cilave kanë interes të drejtpërdrejtë në Vlerësim sepse janë të përfshira në zbatimin e SKZH-së (2016-2021) ose në kornizat, planet ose strategjitë programore që mbështesin zbatimin e SKZH-së (2016-2021). Përdoruesit përfshijnë zyra dhe departamente të veçanta brenda Zyrës së Kryeministrit, ministri përkatëse të linjës, organizata të shoqërisë civile, organizata të sektorit privat dhe të tjera sipas relevancës. Publiku kryesor i synuar për këtë vlerësim përfshin hartuesit e politikave të përfshirë në hartimin e politikave dhe strategjive në nivel kombëtar dhe lokal, me fokus të veçantë në adresimin e çështjeve që lidhen me zhvillimin e kapitalit njerëzor siç janë arsimiti, shëndetësia, politikat sociale dhe të mbrojtjes, tregu i punës dhe të tjera sipas relevancës. Për më tepër, gjetjet e vlerësimit janë për të informuar dhe për t'u përdorur nga palët e tjera përkatëse të interesit, siç janë organizatat e shoqërisë civile, agjencitë zhvillimore, organizatat e sektorit privat, mbajtësit e të drejtave dhe të tjerët sipas relevancës.

Palët kryesore të interesit, perceptimet e të cilave për SKZH-në duhet të pasqyrohen në Vlerësim dhe të cilat, në mënyrë ideale, duhet të informohen për procesin e vlerësimit, gjetjet dhe rekomandimet e tij që mund të mbështesin optimizimin e punës së përbashkët. Një grup i ri konsultativ dhe jozyrtar i palëve të synuara të interesit do të krijohet për të shërbyer si një Grup Referues i Vlerësimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në Institucionet e Kosovës, Agjencitë Publike, Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), Sektorin Privat, Akademinë, Agjencitë Zhvillimore. Për më tepër, palët kryesore të interesit që do të konsultohen si pjesë e këtij vlerësimi do të përfshijnë ministrinë përkatëse të linjës si: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Drejtësisë, Departamentet specifike të Ministrisë së Integritimit Evropian brenda Zyrës së Kryeministrit, Organizatës së Shoqërisë Civile, agjencitë përkatëse, organizatat e sektorit privat dhe academia. Një hartë më e detajuar e palëve të interesit do të bëhet gjatë fazës fillestare të vlerësimit, ndërsa institucionet kryesore dhe mbështetëse që janë përgjegjëse për zbatimin e Kapitalit Njerëzor të SKZH-së parashihen në seksionin 1.3.

Roli i UNICEF-it do të jetë të mbështesë komisionimin e Vlerësimit dhe të sigurojë mbështetje teknike të vazhdueshme për ZPS-në/ZKM-në, me fokus të veçantë në sigurimin e cilësisë në kryerjen e Vlerësimit.

2. Konteksti

2.1 Pasqyrë e përgjithshme socio-ekonomike

Popullsia e përgjithshme e Kosovës vlerësohet në 1.8 milion, me rreth 60 për qind që jetojnë në zonat rurale. Kosova ka popullsinë më të re në rajon, me gjysmën e popullsisë nën moshën 30 vjeç dhe 31 për qind vlerësohet të jetë nën moshën 18 vjeç.¹

Kosova është kategorizuar si me të ardhura të ulëta të mesme me një BPV për kokë banori të vlerësuar në 4,458 dollarë amerikanë, në vitin 2019.² Gjatë dekadës së fundit, Kosova ka gëzuar një rritje ekonomike relativisht solide. Edhe pse projeksionet e rritjes kanë qenë mjaft pozitive, Kosova ka mbetur një nga vendet më të varfra në Evropë, me 18 për qind të popullsisë që vlerësohet se jeton nën kufirin

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Vlerësimi i Popullsisë 2017

² Banka Botërore: Kosovo Overview

kombëtar të varfërisë së konsumit dhe 5.1 për qind nën kufirin e varfërisë së skajshme. Së bashku me treguesit e tjerë sociale, grupet specifike të popullsisë, përfshirë gratë, fëmijët dhe ata që jetojnë në zonat rurale janë të prekur në mënyrë disproporcionale nga varfëria. Në zonat rurale, niveli i varfërisë u vlerësua në 19 për qind krahasuar me 16 për qind në zonat urbane, dhe gratë jetojnë më shumë në varfëri (19 për qind) në krahasim me burrat (17 për qind). Fëmijët preken në mënyrë disproporcionale (23 për qind) në krahasim me popullsinë e përgjithshme (18 për qind), me 7.2 për qind të fëmijëve që jetojnë në varfëri të skajshme.³ Të dhënat më të fundit tregojnë për një pjesë të madhe të fëmijëve nën moshën pesë vjeç (1 deri në 4) që jetojnë në familje që i përkasin kuintilit më të varfër të pasurisë.⁴

Kosova ka përqindjen më të lartë të numrit total të popullsisë ekonomikisht joaktive në Evropë.⁵ Shkalla e përgjithshme e papunësisë në Kosovë vlerësohet të jetë 29.6 për qind. Pabarazi të konsiderueshme vërehen midis grave dhe burrave, me 45.3 për qind të burrave të raportuar si të punësuar, krahasuar me 12.3 për qind të grave. Shkalla e lartë e papunësisë është regjistruar edhe tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, në 55.4 për qind, me normën e papunësisë deri në 63.5 për qind te femrat dhe 48.4 për qind te meshkujt.⁶

Shpenzimet e përgjithshme publike për shërbimet sociale janë rritur me kalimin e kohës, por mbeten relativisht të ulëta dhe janë të pamjaftueshme për të siguruar qasje dhe mbulim universal. Shpenzimet publike për shëndetësinë nuk përmbushin rekomandimet globale për financimin e sektorit shëndetësor. Shpenzimet për kujdesin shëndetësor parashikohen në vetëm 3.8 për qind të BPV-së, që është dukshëm më e ulët se mesatarja e BE-së (7.1 për qind). Në mënyrë të ngjashme, shpenzimet publike për kokë banori për arsim janë të ulëta në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Shpenzimet e vlerësuara të lidhura me arsimin për vitin 2019 janë në 4 për qind të BPV-së, me shpenzimet që dominohen nga pagat.

Që nga viti 2009, ofrimi i shërbimeve sociale është decentralizuar. Megjithatë, procesi i decentralizimit nuk është lidhur sistematikisht me ndarjen e burimeve. Nuk ekzistojnë parametra për krijimin e një formule financiare specifike për ofrimin e shërbimeve sociale që do t'u ndahet komunave nga qeveria qendrore. Si rezultat, burimet e kufizuara financiare dhe kapacitetet e kufizuara njerëzore, si dhe mungesa e planifikimit të duhur, rezultojnë në ofrimin e dobët të shërbimeve sociale për njerëzit më të cenueshëm në Kosovë.

Arsimi dhe shëndetësia janë blloqe ndërtimi për zhvillimin e kapitalit njerëzor; ato janë thelbësore për të maksimizuar potencialin e individëve për të jetuar një jetë të begatë dhe të lumtur. Në Kosovë ka dështime të konsiderueshme në ofrimin dhe cilësinë e arsimit dhe shëndetit që ndikojnë në aftësinë e popullatës së Kosovës për të marrë pjesë në tregun e punës dhe për të jetuar një jetë të gjatë, të begatë dhe të shëndetshme. Sipas Indeksit të Kapitalit Njerëzor të përgatitur nga Banka Botërore, një fëmijë i lindur sot në Kosovë do të jetë vetëm 56 për qind produktiv në krahasim me sa do të ishte kur të rritet nëse do të gëzonte arsim të plotë dhe shëndet të plotë.⁷

Të dhënat nga i njëjti burim tregojnë se një fëmijë kosovar që fillon shkollën në moshën katërvjeçare mund të presë që të përfundojë 13.2 vjet shkollë deri në ditëlindjen e tij/saj të 18-të, por kur llogaritet ajo që mësojnë fëmijët, vitet e pritshme të shkollës janë vetëm 7.9 vjet. Nxënësit/studentët në Kosovë shënojnë 375 pikë në një shkallë ku 374 pikë përfaqëson minimumin dhe 625 pikë përfaqëson arritjen më të lartë të mundshme. Kjo mungesë në kapitalin njerëzor, që reflekton një mospërputhje midis rezultateve të sistemit arsimor dhe kërkesave të tregut të punës, është një sfidë me të cilën Kosova duhet të përballë. Në lidhje me rezultatet shëndetësore, raporti tregon se në të gjithë Kosovën, 91 për qind e

³ Banka Botërore dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. Varfëria në Konsum në Kosovë 2012-2017.

⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF-i. Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë 2020 me popullatën e përgjithshme dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

⁵ You, D. et al. (2016). Kosovo in its Early Demographic Dividend Stage.

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës 2018. Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë

⁷ UNICEF, 2019. Analiza e Situatës së Fëmijëve dhe Grave në Kosovë

15-vjeçarëve do të mbijetojnë deri në moshën 60 vjeç. Fillimi i mirë i jetës është një hap i parë thelbësor në këtë drejtim.⁸

Kosova nuk është anëtare e BE-së apo Kombeve të Bashkuara. Sidoqoftë, në prill të vitit 2016, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit e BE-së (MSA) hyri në fuqi si mjeti kryesor për të rregulluar tregtinë, stabilitetin dhe prosperitetin e Kosovës për të lehtësuar aderimin në BE. Për t'i përmbushur detyrimet e MSA-së, Kosova duhet të angazhohet në reforma të mëtejshme demokratike, të arrijë zhvillimin social dhe ekonomik, dhe të harmonizohet në mënyrë progresive me legjislacionin dhe standardet e BE-së, në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë plotësisht "acquis" të BE-së (grupi i akumuluar i të drejtës dhe obligimeve të BE-së që nga viti 1958 e deri më sot) pas aderimit.⁹

2.2 Strategjia Kombëtare për Zhvillim

SKZH-ja kishte për qëllim zhvillimin e një liste të prioriteteve, nën një strategji ombrellë, e cila do të lejonte ndërtimin e sinergjive midis nismave të ndryshme, parandalimin e mbivendosjes institucionale, arritjen e efikasitetit më të lartë të performancës, orientimin e mbështetjes së partnerëve zhvillimorë dhe krijimin e një baze të fortë udhëzuese për institucionet e Kosovës dhe llogaridhënien ndaj publikut. Ajo është e ndarë në katër shtylla tematike: kapitali njerëzor, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, zhvillimi i industrive konkurruese dhe zhvillimi i infrastrukturës. Një plan zbatimi më i detajuar - Udhërrëfyesi i SKZH-së - i cili përfshin një kostim të masave dhe treguesve për zbatimin dhe rezultatet, u përgatit në gjysmën e parë të vitit 2017.

Raporti i progresit të zbatimit përshkroi progresin e arritur, duke përfshirë katër tregues të nivelit makro, dhe nxori rekomandimet për shqyrtim në të ardhmen, e të cilat theksojnë se aspekte të rëndësishme shoqërore kritike për mirëqenien e popullsisë nuk janë përfshirë në SKZH-në aktuale (2016-2021). Raporti bëri thirrje që masa shtesë mbi punësimin, shëndetin dhe mirëqenien sociale të përfshihen si pjesë e SKZH-së. Për më tepër, raporti i progresit theksoi progresin e bërë në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Nga 17 OZHQ-të dhe 169 caqet e OZHQ-ve, 12 qëllime dhe 22 caqe u konstatuan se janë në përputhje me SKZH-në.

Në shtyllën e saj të parë, Kapitali Njerëzor, SKZH-ja (2016-2021) thekson nevojën për një fuqi punëtore produktive, të aftë dhe inovative, duke i vendosur këta faktorë si një nga përcaktuesit e zhvillimit. Sa më të avancuara të jenë aftësitë e punës, aq më të larta janë të ardhurat e punëtorëve dhe ekonomia në përgjithësi. Diskutimi mbi aftësitë përfshin jo vetëm aftësitë teknike, të tilla si prerja dhe formimi i një produkti, por edhe aftësitë kognitive të tilla si logjika dhe arsytimi, ose aftësitë e buta të tilla si aftësitë ndërpersonale ose etika e punës. Ndërtimi i këtyre aftësive varet tërësisht nga cilësia e arsimit, lidhja e tij me tregun e punës, kushtet e punës në tregun e punës, por edhe mundësitë për të fituar aftësi përmes migrimit ose, anasjelltas, kthimit të trurit nga diaspora.

Masat e SKZH-së nën Shtyllën e Kapitalit Njerëzor:

- 1. Rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore.** Kjo do të mundësojë sukses më të mirë në nivele më të larta arsimore, do të zvogëlojë pabarazinë dhe do të rrisë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Kjo do të thotë që një fëmijë mund të mësojë ndërsa nëna e tij ose e saj mund të punojë.
- 2. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm.** Ky është një parakusht për sukses më të mirë të sistemit arsimor dhe forcimin e aftësive të rinjve për tregun e punës. Kjo do të thotë që mësimdhënësit tanë, të cilët i mësojnë fëmijët tanë, janë të kualifikuar për punën që bëjnë.
- 3. Përmirësimi i ndërlidhjes midis shkathtësive të fituara në arsim dhe nevojave të tregut të punës.** Kjo do të kontribuojë në uljen e papunësisë dhe rritjen e ndërmarrjeve kosovare. Kjo do të thotë që një nxënës i një shkolle profesionale ose një student nga Universiteti mund ta ketë më të lehtë të gjejë punë praktike gjatë studimeve ose punësim me orar të plotë pas përfundimit të studimeve.

⁸ Banka Botërore 2020, Kosovo's Human Capital Index

⁹ UNICEF, 2019. Analiza e Situatsë së Fëmijëve dhe Grave në Kosovë

4. **Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit në sistemin arsimor.** Kjo do të mundësojë që shkollat dhe mësimdhënësit të mbahen përgjegjës dhe të shpërblehen për cilësinë e punës, gjë që do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit.
5. **Përmirësimi i planifikimit të shpenzimeve në sistemin arsimor.** Kjo do të mundësojë kursime në buxhetin e shtetit dhe do ta ridrejtojë financimin nga fushat me prioritet më të ulët në ato me prioritet më të lartë.
6. **Ulja e nivelit të punësimit joformal.** Kjo do të mundësojë mbrojtje dhe avancim më të mirë të punëtorëve. Gjithashtu, punëtori do të jetë në gjendje të përfitojë pensione, të gëzojë qasje në kredi dhe kushte më të mira për punë.
7. **Angazhimi konkret i ekspertëve dhe studentëve të diasporës.** Kjo do të mundësojë transferimin e njohurive praktike nga diaspora jonë dhe forcimin e lidhjeve të tyre me vendlindjen. Kjo do të thotë që një ekspert i teknologjisë mund të mbështetet financiarisht për të zhvilluar një projekt në institucionet e Kosovës ose kompanitë private dhe për të prodhuar diçka afatgjatë.

Palët kryesore të interesit të përfshira në zbatimin e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së përfshijnë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Institucionet mbështetëse përgjegjëse për zbatimin e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së përfshijnë, shkollat, Institutin Pedagogjik të Kosovës, Odën Ekonomike të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Akreditimit dhe Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Drejtësisë, UNDP, GIZ, Qendrën e Inovacionit në Kosovë, Universitetet Private dhe Publike, Rrjetin e Studentëve, Rrjetin e Profesionistëve, donatorët, bizneset.

Ndërlidhja me kornizat e tjera të planifikimit strategjik

Edhe pse fokusi kryesor i SKZH-së (2016-2021) ishte rritja ekonomike, zbatimi i SKZH-së (2016-2021) ishte menduar të shërbente si një mjet për të çuar përpara agjendën e integritit evropian të Kosovës. Në këtë kuptim, rëndësi e madhe iu kushtua harmonizimit të veprimeve të zbatimit të SKZH-së me Programin e Zbatimit të Marrëveshjes Kombëtare të Stabilizim Asociimit (MSA) dhe nevojës për miratim të mëtejshëm të acquis të BE-së. SKZH-ja (2016-2021) ishte gjithashtu e përafuar me Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe synonte të përshpejtonte agjendën e zbatimit të OZHQ-ve për Kosovën. Përveç kësaj, SKZH-ja (2016-2021) u përafua me strategjitë sektoriale që synojnë të rrisin rezultatet në fushën e zhvillimit ekonomik, arsimit dhe punësimit.

Zbatimi i SKZH-së

Zbatimi i SKZH-së (2016-2021) ishte parashikuar si një proces thelbësor i Sistemit të Planifikimit të Integruar në Kosovë, bazuar në parimet e mëposhtme: masat e SKZH-së (2016-2021) kanë përparësi në ndarjen e burimeve dhe do të monitorohen nga afër, përfshirë përmes vëmendjes direkte të Kryeministrit; masat e SKZH-së marrin mbulim të plotë financiar, me qasje preferenciale në çdo burim shtesë nga buxheti i shtetit dhe/ose partnerët zhvillimorë; Ministrat dhe institucionet përgjegjëse për prioritetet e SKZH-së do të hartojnë udhëzime të qarta për zbatimin e objektivave të SKZH-së. Ndryshimet e shpeshta politike dhe mungesa e përafritimit dhe përcjelljes së plotë të shpenzimeve në përputhje me aktivitetet e planifikuara brenda SKZH-së përbëjnë dy sfidat kryesore që kanë ndikuar në zbatimin e SKZH-së (2016-2021).

Raporti i parë mbi zbatimin dhe rezultatet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016–2021 – Shtylla e Kapitalit Njerëzor (2018)

Masat e Shtyllës 1 fokusohen në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe në lidhjen më të mirë të arsimit me nevojat e tregut të punës. Progres i fortë është arritur tashmë në fusha të rëndësishme, të tilla si zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe futja e provimeve kombëtare të nxënësve që matin arritjet e të mësuarit. Zhvillimi i një sistemi informativ arsimor është pothuajse i plotë. Përmirësimi i inspektimeve të shkollave gjithashtu ka përparuar, ashtu siç kanë përparuar përmirësimet në inspektimet e tregut të punës dhe masat përkatëse për zvogëlimin e punësimit joformal.

Raporti i parë theksoi se vonesat nën këtë shtyllë lidhen kryesisht me ndryshimet sistemike dhe zhvillimin institucional. Agjencia e Standardeve dhe Vlerësimit nuk është themeluar pasi që Qeveria e Kosovës, në kuadër të agjendës më të gjerë të reformës së administratës publike, do të ndërmarrë një rishikim të agjencive ekzekutive, përderisa kapaciteti dhe autonomia profesionale e Agjencisë Kombëtare të Kualifikimit dhe Agjencisë Kosovare të Akreditimit duhet të përmirësohen. Zbatimi i sistemit të gradimit dhe licencimit të mësimdhënësve nuk filloi në vitin 2017. Mjetet kryesore për zhvillimin e arsimit profesional, të tilla si për parashikimin e aftësive dhe rishikimin e formulës së financimit, janë vonuar. Së fundi, pak është bërë deri më sot për të tërhequr ekspertë dhe studentë nga diaspora në sistemin arsimor kombëtar.

3. Objektivat dhe fushëveprimi i Vlerësimit të Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të Kosovës të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim

3.1 Objektivat

Vlerësimi ka tre objektiva kryesorë, të cilët janë:

- 1) Vlerësimi i rëndësisë, efektivitetit, qëndrueshmërisë, efikasitetit, sinergjisë dhe ndryshimeve afatgjata që lidhen me SKZH-në, duke përfshirë zgjedhjet prioritare dhe programore të bëra në lidhje me strategjitë dhe prioritetet e tjera sektoriale dhe kontekstin socio-ekonomik gjithnjë në ndryshim në Kosovë.
- 2) Sigurimi i një vlerësimi të pavarur të performancës së Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së 2016-2021 që shihet në raport me rezultatet e pritura siç tregohet në kornizën e monitorimit të Udhërrëfyesit të SKZH-së, për të cilën promovimi i barazisë dhe barazisë gjinore konsiderohen se janë pjesë përbërëse.
- 3) Identifikimi i mësimëve dhe rekomandimeve me fokus kah e ardhmja nga vlerësimi i objektivave (1) dhe (2) më lart që mund të informojnë zhvillimin e SKZH-së 2030.

Vlerësimi do të përqendrohet në shkallën e arritjes së rezultateve dhe caqeve të planifikuara dhe reale lidhur me treguesit e nivelit të lartë të SKZH-së (2016-2021). Vlerësimi gjithashtu do të marrë parasysh burimet e ndara për zbatim, si dhe koherencën e shpenzimeve të tyre në lidhje me masat dhe objektivat e përcaktuar nga SKZH-ja (2016-2021).

Gjetjet e Vlerësimit do të informojnë zhvillimin e SKZH-së së ardhshme 2030 dhe do të ofrojnë mësimë dhe rekomandime kryesore për forcimin e mëtejshëm të zbatimit, kornizën e monitorimit si dhe burimet e ndara për të rritur rezultatet në përputhje me prioritetet e përcaktuara. ZPS-ja/ZKM-ja do të koordinojë rishikimin e raportit të Vlerësimit përmes Grupit Referues të Vlerësimit.

3.2 Fushëveprimi

Vlerësimi do të mbulojë **periudhën e zbatimit të SKZH-së e cila daton në vitin 2016**. Vlerësimi do të vlerësojë zbatimin e Kapitalit Njerëzor brenda SKZH-së (2016-2021).

Fushëveprimi organizativ i Vlerësimit fokusohet në rezultatet e nivelit kombëtar në përputhje me prioritetet e përgjithshme të SKZH-së (2016-2021).

Vlerësimi **mbulon Shtyllën e Kapitalit Njerëzor** duke përfshirë një rishikim të tërësisë së SKZH-së në kontekstin e procesit të zhvillimit dhe zgjedhjeve strategjike të ndërlidhura. Një fokus i veçantë i Vlerësimit do të vendoset në vlerësimin e çështjeve që lidhen me barazinë - veçanërisht pasi këto trajtojnë dhe kontribuojnë në të drejtat e njeriut, OZHQ-të, si dhe procesi i vlerësimit të integritetit gjinor nuk do t'i mbulojnë shtyllat e tjera të SKZH-së (Qeverisjen dhe sundimin e ligjit; Industrinë konkurruese dhe Infrastrukturën) as nuk do të vlerësojë SKZH-në e përgjithshme (2016-2021).

Fokusi programor i Vlerësimit do të përfshijë rishikimin e strategjive përkatëse dhe produkteve të njohurive të rëndësishme për shtyllën e Kapitalit Njerëzor, me fokus të veçantë në arsim, aftësi dhe nevoja të tregut të punës, punësueshmëri, dhe të tjera sipas relevancës.

3.3 Pyetjet e vlerësimit

Pyetjet që do të udhëheqin këtë vlerësim përputhen me kriteret e vlerësimit të zhvilluara nga Komiteti i Asistencës për Zhvillim (DAC)¹⁰ i OECD-së - rëndësia, efektiviteti, efikasiteti, qëndrueshmëria, sinergjitë dhe ndikimi afatgjatë. Një nënpyetje më e synuar do të përcaktohet gjatë fazës fillestare.

Rëndësia

1. Deri në çfarë mase SKZH-ja (2016-2021) në tërësi është përafuar me nevojat e Kosovës, duke përfshirë kushtet ekonomike, të barazisë dhe të kapaciteteve shoqërore që SKZH-ja synon t'i adresojë?
2. Deri në çfarë mase janë informuar me dëshmi masat e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021)?
3. Deri në çfarë mase Shtylla e Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021) u përshtat me prioritetet që evoluojnë?

Efektiviteti

- 4) Deri në çfarë mase janë realizuar masat e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021) kundrejt objektivave dhe çaqeve të përcaktuara?
- 5) Deri në çfarë mase është hartuar korniza e monitorimit për të informuar monitorimin sistematik dhe zbatimin e SKZH-së.
- 6) A është integruar gjinia në mënyrë efektive në zbatimin e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021) dhe, nëse jo, si mund të bëhet më mirë?

Efikasiteti

- 7) Deri në çfarë mase u përdorën burimet financiare në dispozicion në mënyrë efikase duke marrë parasysh efektivitetin e kostos dhe efikasitetin operacional të SKZH-së në lidhje me zhvillimin e kapitalit njerëzor?

Qëndrueshmëria

- 8) Deri në çfarë mase janë të përafuara masat e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021) me strategjitë sektoriale dhe strategjitë e tjera përkatëse dhe marrin parasysh situatat që evoluojnë me rreziqe dhe kompromise të mundshme¹¹?

Sinergjitë

- 9) Deri në çfarë mase janë të përafuara masat e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021) me OZHQ-të dhe prioritetet e BE-së?

Ndryshimi/Ndikimi Afatgjatë

- 10) Deri në çfarë mase mund të konsiderohet që Shtylla e Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021) ka dhënë kontribut në progresin e vërejtur në rritjen e kapitalit njerëzor, përfshirë pasojat e mundshme të ndërhyrjeve në të drejtat dhe barazitë e njeriut?

4. Metodologjia

Vlerësimi do të udhëhiqet nga "Normat dhe Standardet" dhe "Udhëzimet Etike për Vlerësimin" të zhvilluar nga Grupi i Vlerësimit i Kombeve të Bashkuara (UNEG)¹² dhe udhëzimet korporative të UNICEF-it për qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut dhe vlerësimet e fokusuara në barazi¹³. Do të

¹⁰Kriteret e vlerësimit të DAC u përcaktuan për herë të parë në vitin 1991 nën udhëheqjen e OECD-së. Në vitin 2019 ato janë aktualisht në proces të rishikimit.

¹¹Disa nga strategjitë kryesore përfshijnë: Strategjia dhe Plani i Veprimit për Arsimin në Kosovë (2017-2021); Strategjia Sektoriale e Mirëqenies Sociale (2018-2022); Strategjia për Rininë 2019-2023 dhe të tjera të identifikuara gjatë fazës fillestare.

¹² UNICEF 2017.

¹³ UNICEF 2011

planifikohet dhe zbatohet me një dizajn joeksperimental, duke përdorur metoda të përziera, dhe duke u mbështetur në të dhëna dytësore kur është e mundur. Ekipi pritet të gjenerojë të dhëna kryesore kryesisht përmes Intervistave me Informatorët Kyç (IIK), megjithatë, përdorimi i qasjeve alternative të gjenerimit të të dhënave që shtojnë më tepër vlerë është i mirëseardhur, p.sh., administrimi i anketave, grupeve të fokusit, vëzhgimi, përdorimi i të dhënave të mëdha, etj. Në përputhje me masat mbrojtëse kundër COVID-19, mbledhja e të dhënave do të përfshijë mënyra alternative të pranisë fizike. Prandaj, e gjithë mbledhja e të dhënave kryesore do të bëhet përmes mjeteve virtuale, duke përfshirë, dhe pa u kufizuar në zoom, skype, telefon, Viber, WhatsApp etj.

4.1 Kornizat e Vlerësimit dhe Teoritë e Ndryshimit (TOC-të)

Zbatimi i SKZH-së (2016-2021) është informuar nga “Udhërrëfyeni për Zbatimin e SKZH-së 2016-2021”, i cili përfshin informacion të detajuar mbi kostimin e masave dhe aktiviteteve. Ndërsa Udhërrëfyeni përcakton bazën për monitorimin e zbatimit të SKZH-së, Ekipi i Vlerësimit do të jetë përgjegjës për të punuar në ndërtimin e Teorisë së Ndryshimit (ToC) për të theksuar zinxhirin e rezultateve që do të informojë procesin e vlerësimit. Metodologjia e propozuar e vlerësimit duhet të pasqyrojë një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe të fokusuar në barazi duke përdorur të dhëna të ndara sipas gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, paaftësisë, etj., dhe duhet t'i kushtojë vëmendje të kujdesshme çështjeve etike.

Disponueshmëria dhe besueshmëria e të dhënave

Raporti i vitit 2018 mbi zbatimin dhe rezultatet e SKZH-së (2016–2021) thekson mungesën e disponueshmërisë së të dhënave për monitorimin e progresit të masave dhe rezultateve të SKZH-së (2016-2021). Udhërrëfyeni i SKZH-së (2016-2021) përfshin të dhënat e rezultatit, gjendjes fillestare të outputit dhe treguesit e synuar me përkufizime të qarta të treguesve të përshkruara në dokumentin Pasaporta e Treguesve. Kur nuk ka të dhëna në dispozicion për të vlerësuar rezultatin, treguesit e outputeve, të dhënat e përfaqësuara do të nevojiten për të siguruar një tregues ose drejtim mbi progresin e bërë. Kur janë të disponueshme dhe të zbatueshme, përdorimi i të dhënave të ndara është i nevojshëm për të siguruar analiza të thella për të theksuar çështjet e barazisë, gjininë, fëmijët, adoleshentët, të rinjtë dhe të tjerët sipas rëndësisë. Të dhënat e konsoliduara të monitorimit të mbledhura nga Zyra e Planifikimit Strategjik/Zyra e Kryeministrit do të shërbejnë si një kornizë udhëzuese për të informuar Vlerësimin.

Kufizimet

Mungesa e të dhënave të besueshme dhe sistematike si dhe dokumentimit të hartimit dhe zbatimit të disa ndërhyrjeve të programit mund të kufizojnë Vlerësimin. Gjatë fazës fillestare, ekipi i vlerësimit pritet të konfirmojë disponueshmërinë e të dhënave dhe të sugjerojë si do të plotësojë çdo zbrazëti. Situata e krijuar me pandeminë COVID-19 do të imponojë kufizim të pranisë fizike për mbledhjen e të dhënave nga ekipi i vlerësimit.

5. Procesi i Vlerësimit

Pasi ekipi i vlerësimit të fillojë punën, Vlerësimi do të strukturohet në tri faza kryesore të përcaktuara nga aktivitetet shoqëruese siç përshkruhen më poshtë:

Faza Fillestare

- **Ngritja e kapaciteteve për kryerjen e Vlerësimit për ZPS-në**
Ekipi i vlerësimit së bashku me UNICEF-in do të zhvillojnë dy punëtori me stafin e Zyrës së Planifikimit Strategjik, UNICEF-in në Kosovë dhe partnerët e tjerë relevantë për njohjen me vlerësimin, duke mbuluar parimet, standardet, qasjet dhe zbatimin e Vlerësimit. Punëtorja e parë do të zhvillohet gjatë Fazës Fillestare për të siguruar që anëtarët e stafit të kenë kapacitete të ngritura dhe t'i kuptojnë hapat bazë drejt zbatimit të vlerësimit. Punëtorja e dytë do të organizohet pas përfundimit të Raportit të Vlerësimit, duke u fokusuar në formimin e Përgjigjes së Menaxhmentit për Vlerësimin.

- **Rishikimi i dokumenteve në zyrë (ang. “desk review”)**
Ekipi i vlerësimit do të fillojë Vlerësimin me një rishikim të dokumenteve për të cilin do të krijohet një bibliotekë elektronike nga ZPS-ja/ZKM-ja që përfshin dokumentacionin përkatës që do të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme si nga ekipi i vlerësimit (EV) ashtu edhe nga ZPS-ja/ZKM-ja gjatë procesit të vlerësimit. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të ekipit mund të përfshijë por nuk do të kufizohet në: SKZH-në (2016-2021) duke përfshirë të gjitha dokumentet shoqëruese (udhërrëfyesin, kornizën e monitorimit etj.), strategjitë sektoriale siç është Strategjia e Arsimit të Kosovës dhe Plani i Veprimit (2017- 2021); Strategjia Sektoriale e Mirëqenies Sociale (2018-2022); Strategjia për Rininë 2019-2023; Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve (2019-2023), dokumentet kryesore përkatëse të politikave, analizën e situatës dhe raporte të tjera përkatëse të anketës që përfshijnë të dhëna dhe informacion mbi treguesit e lidhur me kapitalin njerëzor.
- **Informimet fillestare**
Përveç rishikimit të dokumenteve në zyrë, intervistat e shkurtra hyrëse me stafin nga ZPS-ja/ZKM-ja dhe Zyra e UNICEF-it në Kosovë do të informojnë prioritizimin e pyetjeve të vlerësimit dhe planifikimin e detajuar të metodologjisë së vlerësimit.
- **Një Raport fillestar (RF)**
Një raport fillestar (20 faqe) do të paraqitet që demonstron paanshmëri dhe që përputhet me standardet e cilësisë së UNICEF -it. RF-ja do t'i nënshtrohet sigurimit të cilësisë të kryer nga menaxheri i vlerësimit, një rishikimi të kryer nga palët e interesit të vlerësimit të brendshëm dhe GRV-ja, një shqyrtimi etik - nëse mbledhja e të dhënave e propozuar përfshin grupe të cenueshme, subjekte të ndjeshme dhe/ose përdorimin e të dhënave konfidenciale - dhe, në fund , një kontrolli të jashtëm të sigurimit të cilësisë që kërkon një vlerësim të kënaqshëm në mënyrë që të vazhdojë misionin në terren. Miratimi i RF-së shënon përfundimin e Fazës Fillestare.
- Bazuar në rishikimin e dokumenteve në zyrë dhe VIM, RF-ja do të sigurojë: një përshkrim kontekstual dhe përmbledhje të gjetjeve fillestare të disponueshme nga burimet dytësore; arsyetimet e ndryshimeve të propozuara në TeR -të e Vlerësimit; një përshkrim të metodologjisë së detajuar (përfshirë strategjitë e marrjes së mostrave për të gjithë mbledhjen e të dhënave parësore); kornizat teorike kundrejt të cilave do të vlerësohet SKZH-ja; një përshkrim të mekanizmit të sigurimit të cilësisë të ekipit të vlerësimit. RF-ja gjithashtu do të përshkruajë strategjitë e ekipit të vlerësimit për menaxhimin e boshllëqeve të të dhënave, ose çështjet e besueshmërisë së të dhënave, dhe do të përfshijë konsideratat etike në lidhje me gjenerimin e të dhënave parësore. RF-së do t'i bashkëngjitet një matricë vlerësimi që përshkruan pyetjet e vlerësimit, nënpyetjet, kriteret e gjykimit/treguesit, burimet e të dhënave dhe instrumentet/metodat; një analizë të palëve të interesuara; një afat kohor; TOC të SKZH-së; një plan pune; dhe biografite e anëtarëve të EV-së me një pasqyrë të ndarjes së punës midis anëtarëve të ekipit të vlerësimit kundrejt produkteve (rezultateve) të vlerësimit.

Faza e Misionit të Mbledhjes së të Dhënave Virtuale

Pas fazës fillestare, do të organizohet një mision dyjavor i mbledhjes së të dhënave virtuale me pjesëmarrjen e plotë të të gjithë anëtarëve të ekipit, gjatë të cilit të dhënat shtesë dytësore mund të identifikohen dhe të dhënat parësore do të gjenerohen. Rreth 70 palë të interesuara do të konsultohen nga ekipi vlerësues që përfshin kategoritë e mëposhtme: Institucionet dhe Agjencitë Publike të Kosovës, Sektori Privat, OShC -të, komuniteti akademik dhe Agjencitë Zhvillimore.

ZPS/ZKM dhe Zyra e UNICEF -it në Kosovë do të mbështesin EV-në, duke organizuar takime dhe logjistikë me kërkesë të Drejtuesit të Ekipit - por nuk do të marrin pjesë në asnjë nga intervistat e palëve të jashtme të interesit. Në përfundim të misionit në terren, Drejtuesi i Ekipit të vlerësimit do të paraqesë vëzhgimet dhe gjetjet paraprake te ZPS/ZKM dhe stafi i ekipit të vlerësimit të UNICEF-it, GRV-ja (GRV) dhe, nëse kërkohet, palët e tjera të interesit.

Faza e Raportimit

- Ekipi i vlerësimit do të përgatisë një draft raport të vlerësimit, i cili duhet të përfshijë një Përmbledhje Ekzekutive, që do t'i nënshtrohet një rishikimi të ndërmarrë nga ZPS-ja/ZKM-ja dhe stafi i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, anëtarët e GRV-së dhe menaxheri i vlerësimit; një sigurim i jashtëm i cilësisë që kërkon një vlerësim të kënaqshëm dhe, nëse kërkohet, një rishikim etik. Pas shqyrtimit të parë të brendshëm të draft raportit dhe sigurimit fillestar të cilësisë, grupi i vlerësimit do të përfshijë komentet e dhëna, sipas rastit, dhe do të përgatisë një draft raport përfundimtar. Draft raporti përfundimtar i vlerësimit ndahet me GRV-në për validim dhe ndonjë koment shtesë. Ashtu si me RF-në, është një kërkesë që raporti i vlerësimit të ketë një vlerësim të kënaqshëm para se të konsiderohet përfundimtar.
- Ose në fazën përfundimtare të draftit (për të mbështetur validimin e raporteve) ose sapo të përfundojë raporti i vlerësimit (për të mbështetur brendësimin e mëtejshëm dhe diskutimin mbi rekomandimet), Drejtuesi i Ekipit të Vlerësimit do të mbajë një takim virtual me ZPS-në/ZKM-në dhe stafin e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, GRV-në dhe, nëse është nevojë, akterë të tjerë kombëtarë. Raporti do të jetë në përputhje me standardet e raportimit të UNICEF-it dhe nuk do të jetë më i gjatë se 40-60 faqe duke përjashtuar përmbledhjen ekzekutive dhe anekset. Pas përfundimit të raportit të vlerësimit, ai do të vlerësohet në Sistemin Global të Vlerësimit dhe Mbikëqyrjes së Kërkimeve të UNICEF-it (GEROS), dhe do të publikohet në uebfaqen publike globale të UNICEF-it. Mësimet e nxjerra gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të Vlerësimit do të dokumentohen dhe ndahen për të informuar vlerësime të ngjashme në kontekste të ndryshme.
- **Konsideratat etike:** ekipi i vlerësimit duhet të identifikojë qartë çdo çështje dhe qasje të mundshme etike, si dhe proceset për rishikimin etik dhe mbikëqyrjen e procesit të vlerësimit në propozimin e tyre në lidhje me mbledhjen e të dhënave, rishikimin dhe proceset e tjera përkatëse.

Përgjigja e Menaxhmentit (PM)

- ZPS-ja/ZKM-ja është përgjegjëse për formulimin e një përgjigje zyrtare të menaxhimit ndaj vlerësimit të SKZH-së, duke marrë parasysh të dhënat e GRV-së. PM ofron një grup konkret veprimesh që institucionet e Kosovës angazhohen të ndërmarrin në përgjigje të rekomandimeve të vlerësimit që pranohen. PM do të ndahet me Komitetin e Planifikimit Strategjik për validim dhe do të informojë më tej hartimin e SKZH-së 2030.

6. Organizimi i Vlerësimit

6.1 Afati kohor, Plani i Punës dhe Produktet

Vlerësimi do të menaxhohet nga ZPS-ja/ZKM-ja në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë. Plani i punës dhe afati kohor jepen në Tabelën 2 më poshtë.

Tabela 2. Plani i punës dhe afati kohor

| Aktiviteti | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor |
|---|---------------|-------------|--------------|------------|----------------|
| Fillimi dhe rishikimi i dokumenteve në zyrë | X | | | | |
| Misioni fillestar | X | | | | |
| Raporti fillestar | | X | | | |

| | | | | | |
|---|--|---|---|---|---|
| Raporti i rishikuar nga akterët e vlerësimit, shqyrtimi etik dhe sigurimi i cilësisë i kryer. | | X | | | |
| Finalizimi dhe miratimi i Raportit Fillestar | | X | | | |
| Mbledhja e të dhënave | | | X | | |
| Prezantimi i vëzhgimeve dhe gjetjeve paraprake | | | X | | |
| Draft raporti i parë | | | | X | |
| Raporti i rishikuar nga akterët e vlerësimit, shqyrtimi etik dhe sigurimi i cilësisë i kryer | | | | X | X |
| Raporti Përfundimtar | | | | | X |
| Prezantimet përfundimtare dhe përgjigja e menaxhmentit | | | | | X |

Produktet kryesore të vlerësimit dhe ditët indikative të konsulencës janë të përshkruara më poshtë në Tabelën 3.

Tabela 3. Produktet kryesore të Vlerësimit dhe afatet përfundimtare

| Produktet e vlerësimit | Datat e Përfundimit | # ditë Udhëheqësi i ekipit |
|--|---|----------------------------|
| Misioni 2-3-ditor Virtual i Fillimit me prezantim | 1 javë para dorëzimit të RF | 4 |
| Raporti fillestar (maksimum 20 faqe pa përfshirë anekset). | 1 javë pas fillimit të misionit fillestar | 6 |
| Mbledhja dhe prezantimi virtual i të dhënave të ZPS/ZKM dhe UNICEF Kosovë, dhe GRV | 2-3 javë pasi RF të jetë përfunduar dhe qartësuar. | 10 |
| Draft Raporti (maksimum 40-60 faqe pa përfshirë përmbledhjen ekzekutive dhe anekset) | 2 javë pas përfundimit të misionit kryesor. | 8 |
| Raporti Përfundimtar (si më sipër) | 2 javë pas përfundimit të rishikimit të brendshëm dhe sigurimit të jashtëm të cilësisë në draft raport. | 4 |

| | | |
|---|--|-----------|
| Prezantimi virtual i vlerësimit për ZPS-në/ZKM-në dhe UNICEF-in në Kosovë, GRV dhe akterët e tjerë sipas kërkesës. Një Prezantim PowerPoint i vlerësimit, gjetjeve kryesore të tij, rekomandimeve dhe përfundimeve. | 1-2 javë pas miratimit të raportit përfundimtar. | 2 |
| Punëtori dy-ditore për ngritjen e kapaciteteve për kryerjen e vlerësimit dhe zhvillimit të përgjigjes së menaxhmentit për ZPS-në/ZKM-në | Punëtori një-ditore para Raportit Fillestar mbi Kryerjen e Vlerësimit; dhe Punëtori një-ditore pas Raportit Final mbi Zhvillimin e Përgjigjes së Menaxhmentit | 3 |
| Totali | | 37 |

6.2 Përbërja e Ekipit dhe Kërkesat

Kërkesat e Përgjithshme të Kompetencës për një Drejtues Ekipi Ndërkombëtar

Për qëllimet e këtij vlerësimi, kompania konsulente do të sigurojë një Drejtues Ekipi Ndërkombëtar. Drejtuesi i Ekipit do të mbështetet nga një konsulent kombëtar me kohë të plotë i angazhuar direkt nga UNICEF-i (*më shumë informacion më poshtë*).

Një Drejtues Ekipi Ndërkombëtar duhet të ketë përvojë profesionale të dokumentuar në kryerjen e vlerësimeve rigorozë të pavarura që plotësojnë standardet e vlerësimit profesional - dhe më shumë se 10 vjet përvojë profesionale. Drejtuesi i Ekipit, për më tepër, duhet të ketë një historik të fortë zhvillimi me një kuptueshmëri të thellë të zhvillimit dhe programimit të bazuar në të Drejtat e Njeriut. Kërket gjithashtu që Drejtuesi i Ekipit të ketë ekspertizë në planifikimin strategjik dhe të ketë përvojë vlerësimi nga Evropa dhe Rajoni i Azisë Qendrore ose një kontekst tjetër i vendeve me të ardhura të mesme. Si udhëheqës i vlerësimit, kandidati do të demonstrojë përvojën e mëparshme në menaxhimin e një ekipi shumëdisiplinor dhe dhënien e rezultateve cilësore të vlerësimit.

Përvoja e mëparshme në Kosovë e cila demonstroi të kuptuarit e politikave kombëtare të Kosovës si dhe njohja e gjuhës shqipe do të konsiderohen si aset me rëndësi kritike.

Konsulent për Monitorim i UNICEF -it në Kosovë

Një konsulent shtesë i UNICEF-it në Kosovë do t'i sigurojë mbështetje me orar të plotë drejtuesit të ekipit gjatë gjithë procesit të vlerësimit. Konsulenti kombëtar i UNICEF -it në Kosovë ka diplomën master dhe përvojë përkatëse në monitorimin dhe vlerësimin, përfshirë vlerësimet e mëparshme me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë.

Shoqërimi nga të rinjtë

Si pjesë e procesit të vlerësimit, katër deri në pesë studentë të universitetit do të shoqërojnë procesin e vlerësimit të cilët do t'i sigurojnë ekipit të vlerësimit mbështetje për detyra të veçanta, të tilla si marrjen e shënimeve gjatë intervistave dhe konsultimeve, sintetizimin e raportit dhe detyra të tjera shtesë sipas nevojës.

6.3 Qeverisja

Vlerësimi do të bashkëmenaxhohet nga Drejtori i ZPS-së/ZKM-së dhe Specialisti i UNICEF-it për Monitorimin e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë. ZPS-ja/ZKM-ja do të jetë përgjegjëse për

menaxhimin dhe koordinimin e përgjithshëm të procesit të Vlerësimit. Ai do të mobilizojë institucionet dhe partnerët për t'i dhënë informacion Ekipit të Vlerësimit dhe për të siguruar pjesëmarrjen e tyre të plotë gjatë gjithë procesit të zbatimit të vlerësimit. ZPS-ja/ZKM-ja do të përfshihet në diskutime sistematike me Ekipin e Vlerësimit gjatë gjithë procesit të planifikimit dhe zbatimit.

Zyra e UNICEF-it në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Rajonale të UNICEF-it për Evropën dhe Azinë Qendrore, do të jetë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së Vlerësimit dhe rekrutimin e Ekipit të Vlerësimit. Ai do të mbështesë ZPS-në/ZKM-në për menaxhimin dhe koordinimin e procesit të zbatimit. Vlerësimi do t'i përmbahet Politikës së Vlerësimit të UNICEF-it (2018) dhe standardeve dhe procedurave për sigurimin e cilësisë.

Drejtuesi i Ekipit do të jetë përgjegjës i përgjithshëm për cilësinë dhe dorëzimin e të gjitha produkteve kryesore të vlerësimit, për të cilat të gjithë anëtarët e ekipit do të kontribuojnë siç shpjegohet më poshtë.

Roli dhe Përgjegjësia - Drejtuesi i Ekipit

Drejtuesi i Ekipit ka përgjegjësinë e përgjithshme për CPE. Detyrat specifike të Drejtuesit të Ekipit do të përfshijnë por mund të mos kufizohen në:

- Drejtimin e rishikimit të gjerë të dokumenteve në zyrë të informacionit ekzistues mbi kontekstin duke përfshirë politikat dhe prioritetet kombëtare dhe të gjitha dokumentet dhe raportet përkatëse të programit, studimet e mëparshme, hulumtimet dhe vlerësimet.
- Zhvillimin dhe ofrimin e udhëzimeve të hollësishme metodologjike për ekipin në lidhje me zhvillimin e mjeteve dhe përcaktimin e drejtimin të përgjithshëm për analizën e të dhënave dhe sigurimin e cilësisë.
- Dhënien e udhëzimeve në përgatitjen e produkteve të vlerësimit.
- Rishikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës në lidhje me Vlerësimin e SKZH-së.
- Ndërmarrjen e një VIM-i për të verifikuar fushëveprimin e vlerësimit, ToC të SKZH-së, analizën e palëve të interesuara të zhvilluar gjatë rishikimit të dokumenteve në zyrë, paraqitjen e vlerësimit të ZPS/ZKM dhe UNICEF-i në Kosovë, GRV-ja dhe, nëse është e rëndësishme, palët e tjera të interesuara dhe organizimin e çështjeve praktike që lidhen me planifikimin e grumbullimit të të dhënave.
- Drejtimin e misionit të mbledhjes së të dhënave virtuale dhe vendimin për ndarjen e roleve dhe përgjegjësi midis anëtarëve të ekipit gjatë gjithë procesit të vlerësimit.
- Koordinimin e punës së ekipit të vlerësimit dhe konsolidimin e inpueteve nga anëtarët e ekipit për të siguruar shpërndarjen në kohë të produkteve të vlerësimit.
- Kryerjen e intervistave me një sërë akterësh dhe informatorëve kryesorë sipas raportit fillestar.
- Drejtimin e planifikimit dhe kryerjen e analizave dhe diskutimeve të pyetjeve dhe çështjeve të vlerësimit të përbashkëta për të gjithë ekipin.
- Drejtimin e konsolidimit të inpueteve të ekipeve për misionin fillestar dhe atë në terren.
- Ndërmarrjen e VIM-it dhe paraqitjen e vlerësimit të ZPS/ZKM, UNICEF-i, GRV-ja dhe, te akterët e tjerë përkatës, dhe verifikimin e produkteve kryesore që lidhen me misionin fillestar.
- Paraqitjen e RF-së, draftit dhe raporteve përfundimtare të Vlerësimit, dhe zhvillimin dhe dhënien e një prezantimi në power point mbi gjetjet dhe rekomandimet kryesore që dalin nga vlerësimi pasi raporti i vlerësimit të jetë miratuar përfundimisht.
- Menaxhimin e planit të punës së vlerësimit, duke respektuar afatet për aktivitete specifike dhe produktet.
- Mbajtjen e një niveli të lartë komunikimi me anëtarët e ekipit dhe ZPS-në/ZKM-në dhe stafin e UNICEF-it në Kosovë të përfshirë në menaxhimin e vlerësimit.

Grupi Referues i Vlerësimit (GRV)

GRV-ja nuk ka ndonjë përgjegjësi formale të menaxhimit të vlerësimit. Ai do të veprojë në një kapacitet këshillues dhe do të japë inpuete për të gjitha produktet kryesore të vlerësimit që pritet të forcojnë cilësinë dhe besueshmërinë e vlerësimit. Anëtarët e grupit referues pritet të:

- Jenë një grup këshillimi për komente kthyesë gjatë vlerësimit.
- Ofrojnë komente kthyesë mbi qasjen e vlerësimit të paraqitur nga Drejtuesi i Ekipit të Vlerësimit kur organizohet MF-ja.
- Lejojnë qasje tek informatorët kryesorë gjatë procesit të vlerësimit.
- Marrin pjesë në intervista me vlerësuesit sipas nevojës.
- Rishikojnë dhe komentojnë RF-në.
- Marrin pjesë në prezantimin e gjetjeve paraprake të vlerësimit.
- Shqyrtojnë dhe diskutojnë raportin përfundimtar, në veçanti, gjetjet dhe rekomandimet që kanë të bëjnë me ndryshimet e mundshme strategjike që duhet të bëhen në SKZH-në e ardhshme.

Shtojca 2: Bibliografia

SHËNIM: Në vijim pasqyrohet biblioteka e dokumentacionit në dispozicion për shqyrtim kundrejt kriterëve të vlerësimit. Dokumentet e hijezuara me ngjyrë të verdhë janë kërkuar nga agjencitë përkatëse por ende nuk janë marrë. Veprimet përcjellëse do të vazhdojnë të shtojnë dokumentacion gjatë gjithë fazës së mbledhjes së të dhënave.

| Titulli | Burimi | Vit |
|---|---|-----------|
| Dokumentet kryesore | | |
| 1.1 DOKUMENTET KRYESORE të SKZH-së 2016-2021 | | |
| Strategjia Kombëtare e Zhvillimit | Zyra e Kryeministrit | 2016-2021 |
| Udhërrëfyesi për zbatimin e SKZH-së 2016 2021 | Zyra e Kryeministrit | 2017 |
| Raporti i parë mbi zbatimin dhe rezultatet e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit | Zyra e Kryeministrit | 2018 |
| Modeli i Rritjes dhe Kohezionit i Kosovës | Zyra për Planifikim Strategjik / Zyra e Kryeministrit | 2015 |
| Krahasimi i masave dhe treguesve të SKZH-së dhe OZHQ-ve | Zyra për Planifikim Strategjik / Zyra e Kryeministrit | |
| Rezultatet në nivel makro | Zyra për Planifikim Strategjik / Zyra e Kryeministrit | |
| Rezultatet e SKZH-së (Excel) | Zyra për Planifikim Strategjik / Zyra e Kryeministrit | 2018 |
| Zbatimi i SKZH-së (Excel) | Zyra për Planifikim Strategjik / Zyra e Kryeministrit | 2018 |
| Analiza SWOT* | | |
| 1.2 PROJEKTI AT i BE-së: Mbështetje për Politikën dhe Planifikimin Strategjik të Kosovës 2014-2016 | | |
| Raporti Fillestar - Mbështetje për Politikën dhe Planifikimin Strategjik të Kosovës | CPM Consulting / Zyra e BE-së në Kosovë | 2014 |
| Raporti Përfundimtar - Mbështetje për Politikën dhe Planifikimin Strategjik të Kosovës | CPM Consulting / Zyra e BE-së në Kosovë | 2016 |
| Shtojcat (Korniza logjike, Plani i Operacionit, Plani i Performancës, etj.) | CPM Consulting / Zyra e BE-së në Kosovë | 2016 |
| 2. KORNIZA E MONITORIMIT | | |
Lidhja e rishikimit të dokumenteve dhe IIK-ve me dimensionin e vlerësimit. Anketa e profilizuar në Shtojcën 7 gjithashtu përshkruan lidhjen midis pyetjeve të veçanta për instrumentet dhe dimensionet e përgjithshme të vlerësimit. Matrica e Vlerësimit (Shtojca 5) ofron një përmbledhje të lidhjes midis secilit burim të të dhënave dhe treguesve që do të rishikohen si pjesë e procesit të ndërtimit të përfundimeve. Formati i IIK-së në Shtojcën 5 është i strukturuar në mënyrë që të ilustrojë lidhjen midis pyetjeve të veçanta të intervistës, pyetjeve të vlerësimit të TOR-it dhe dimensioneve përkatëse të vlerësimit.

Përzgjedhja e akterëve

Një kriter mbizotërues është **pasuria e informacionit e bazuar në marrjen e mostrave selektive.**⁷ Përzgjedhja specifike do të varet nga marrja e mostrave selektive për intervistat cilësore. Kriteret përfshijnë: Pasuria e informacionit (*a janë të anketuarit mjaftueshëm të njohur me aktivitetet për të ofruar njohuri nga perspektiva të ndryshme duke përfshirë barazinë gjinore, etninë ose dinamikën rajonale?*), qasshmëria (*a mund të arrihen akterët nga ekipi i vlerësimit?*), dhe diversiteti (*A paraqet përzierja e akterëve diversitetin gjinor dhe etnik midis akterëve të SKZH-së?*). Për të konfirmuar pasurinë e informacionit, përzgjedhja përfundimtare e akterëve është bërë në konsultim me ZPS/ZKM dhe UNICEF-in në Kosovë.⁸ Shtojca 6 përshkruan listën e akterëve dhe klasave të akterëve që do të intervistohen gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave.

Metodat e analizës së të dhënave

Të tre llojet kryesore të të dhënave (dokumentet, sasore dhe cilësore) do të kenë menaxhimin dhe analizat e tyre shoqëruese. Për të siguruar qëndrueshmëri në kuptimin e objektivave të vlerësimit, një orientim paraprak i lehtësuar nga drejtuesi i ekipit do të sigurojë një të kuptuar të përbashkët të përdorimit të instrumenteve. Udhëzuesit gjysmë të strukturuar të intervistës me pyetësor përdoren për të siguruar formatimin e qëndrueshëm të intervistave. Shënimet e vlerësimit duhet të përpilohen në një model të standardizuar - të etiketuar nga akterët dhe aktiviteti dhe vendndodhja (Shtojca 5). Shënimet duhet të ndahen dhe rishikohen kolektivisht nga ekipi për cilësinë e të dhënave. Metodat e analizës së të dhënave përdorin analizën sasore përshkruese dhe krahasuese, analizën temative narrative, analizën cilësore të të dhënave përsëritëse dhe analizën e kontributeve. Të gjitha metodat do të triangulohen si brenda ashtu edhe në të gjitha metodat sipas mundësive.

Analiza sasore përshkruese dhe krahasuese. Të dhënat sasore para-ekzistuese do të analizohen përmes analizës përshkruese. Nëse është e realizueshme, kjo do të përfshijë analizën e frekuencës së modeleve kryesore me tabelim të kryqëzuar për dimensionet e interesit. Aty ku është e mundur, analiza do të kërkojë të identifikojë tendencat sipas kritereve ose kohës.

⁷Individët e pasur me informacion nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht individ që janë të njëanshëm për programin ose që janë të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e aktiviteteve - përkundrazi, pasuria e informacionit nënkupton individë që mund të flasin me njohuri për programin - ose si një marrës i synuar i programit ose vëzhgues i jashtëm me ekspozim të mjaftueshëm vëzhgues ndaj programit që ata të mund të japin një opinion kompetent.

⁸Zakonisht nuk është një përdorim i mirë i kohës së ET për të intervistuar persona që nuk kanë njohuri për një program, por një mënyrë shtesë për të kontrolluar paragjykimet është të përfshini gjatë intervistave palët e interesuara të njohura me një lloj programimi, cilat janë perceptimet e tyre për TJER programe të mbështetura nga UNICEF me të cilat nuk janë aq të lidhura ngushtë. Këto vëzhgime mund të integrohen në ushtrimet e triangulimit të përshkruara në seksionet e analizës së të dhënave.

Rishikimi i Dokumenteve: Rishikimi i dokumenteve do të mbështetet në **analizën tematike narrative** për të nxjerrë në pah temat kryesore të identifikuar në dokumente dhe t'i lidhë ato me pikat përkatëse në matricën e vlerësimit. Shtojca 5 përmban instrumentin e propozuar për analizën e tregimit tematik.

Analiza cilësore e të dhënave përsëritëse bazohet në një proces përsëritës të identifikimit të njëjësive kryesore të mendimit në lidhje me secilën pyetje vlerësimi nga IIK-të⁹, duke organizuar këto njësi mendimi në grupe dhe duke identifikuar temat kryesore brenda secilit grup. Këto më pas grupohen në kategori dhe tema të reja nga secila kategori për analiza të mëtejshme dhe ri-kategorizim për të identifikuar modelet kryesore.¹⁰ Dëshmitë për përfundimet duhet të ndërtohen përmes analizës së triangulimit. Temat ose modelet do të shqyrtohen për të përcaktuar nëse ato vijnë nga nivele të shumta të akterëve dhe kategori të shumta të akterëve. Vëzhgimeve ose komenteve që vijnë vetëm nga një burim i vetëm ose një kategori e vetme e akterëve do t'u jepet më pak peshë gjatë ndërtimit të analizës. Gjetjet e theksuara në raport do të jenë ato që dalin nga akterë të shumtë dhe nga kategori të shumta të akterëve.¹¹

Analiza e të dhënave do të bëhet përmes një sërë ushtrimesh sinkrone dhe asinkrone si gjatë vetë fazës së grumbullimit të të dhënave ashtu edhe më pas si pjesë e fazës së analizës. Seancat sinkrone mbahen duke kombinuar komunikimin verbal të Zoom me platformën Mural për organizimin vizual.¹² Në punën asinkrone, anëtarët e ekipit do të bëjnë punën e tyre asinkrone kundrejt matricës së vlerësimit dhe do të integrohen në Mural para çdo takimi.

Analiza e kontributit. Analiza e kontributit është një qasje për të nxjerrë në pah shkallën në të cilën veprimet e programit kanë kontribuar në rezultatet e perceptuara dhe bazohet në ndërtimin dhe analizën e teorisë së nënkuptuar të ndryshimit prapa SKZH-së. Ndërtimi i ToC-së është një nga ushtrimet e analizës së të dhënave që do të kryhet gjatë seancave sinkrone të Muralit të përshkruara më parë. Teoria e ndryshimit është gurthemeli i analizës së kontributit.¹³ Artikulimi i një teorie të ndryshimit dhe vlerësimi i mëvonshëm i marrëdhënieve të perceptuara midis lidhjeve të ndryshme dhe vlefshmërisë së supozimeve mund të përdoret për të gjeneruar një argument të besueshëm për kontributin e programit. Konstatimi i një analize kontributi nuk është domosdoshmërisht dëshmi përfundimtare, por siguron dëshmi të një linje arsyetimi që programi ka kontribuar në rezultatet e vëzhguara. Në përgjithësi, faktorët e rëndësishëm për një analizë të suksesshme të kontributeve përfshijnë:

Se ekziston një teori ndryshimi për ndërhyrjen

- Supozimet kryesore prapa lidhjes së pritshme të ndërhyrjeve kanë vlefshmëri në shikim të parë
- Aktivitetet në program u zbatuan siç përshkruhet në teorinë e ndryshimit
- Teoria e ndryshimit nuk është hedhur poshtë
- Faktorët e jashtëm që ndikojnë në rezultate janë vlerësuar dhe kontrolluar ose roli i tyre relativ në kontributin në rezultatin e dëshiruar është njohur.

Analiza e kontributit është e rëndësishme për të kuptuar lidhjen me efektet e vëzhguara të programit dhe do të luajë një rol në përfundimet në lidhje me efektivitetin, rëndësinë dhe qëndrueshmërinë. SKZH-ja nuk ka elaboruar një ToC të përgjithshme - as mbi të gjitha as si pjesë të secilës shtyllë. Sidoqoftë, shënimet e politikave të SKZH-së dhe udhërrëfyese i SKZH-së përshkruajnë një teori të nënkuptuar të ndryshimit e cila udhëhoqi përpunimin e objektivave dhe përzgjedhjen e aktiviteteve për arritjen e këtyre objektivave. Ky ToC implicit mund të përdoret për të konkluduar analizën e kontributeve.

Ky model pastaj mund të popullohet me dëshmitë aktualisht të disponueshme (cilësore ose sasiore) në lidhje me rezultatet dhe programin. Gjatë analizës, modelet e rezultateve vlerësohen kundrejt lidhjeve të ToC-së së nënkuptuar për të përcaktuar nëse modelet e vëzhguara përputhen me modelin ToC të nënkuptuar dhe për të identifikuar dobësinë ose boshllëqet e mundshme në ToC. Një pretendim i arsyeshëm i kontributit mund të

⁹ Udhëzuesi i intervistës gjendet në Shtojcën 5.

¹⁰ Patton, Michael Quinn. 2010. Hulumentim dhe Vlerësim Cilësor. Botimet Sage. San Francisko, Kaliforni.

¹¹ Kategoritë e akterëve do të ndahen gjithashtu për të kontrolluar ekuilibrin midis zërave. Për shembull, nëse 10 anëtarë të stafit nga një komunë e caktuar do të vërenin një model të caktuar - kjo do të merrte më pak peshë nëse dhjetë të anketuarit ishin të gjithë nga komuna të ndryshme. Kjo e fundit do të kishte më shumë përgjithësim në nivelin kombëtar, ndërsa e para do të ishte e rëndësishme vetëm për vëzhgimet nga burimi i vetëm.

¹² Mural është një platformë në internet e cila funksionon si një tabelë virtuale ku ekipi mund të postojë mendimet e tyre në "shënimet ngjitëse" virtuale të cilat më pas mund të zhvendosen dhe organizohen sipas kategorive dhe grupeve. Ndërtimi i Muralit së bashku lejoji që secili anëtar i ekipit të ketë pronësinë në këtë proces.

¹³ Gagnon, Yves-Chantal. (2010). Studimi i rastit si metodë kërkimore: Një doracak praktik. Presses de l'Université du Québec

bëhet nëse: a) ekziston një teori e nënkuptuar e ndryshimit që është e besueshme dhe mbështetet nga dëshmitë; b) aktivitetet e planifikuara që operacionalizojnë ndërhyrjen u zbatuan në përputhje me ToC-në; dhe c) janë vlerësuar faktorë të tjerë ndikues dhe roli i tyre relativ në kontributin ndaj rezultateve të dëshiruara është njohur dhe marrë parasysh.

Triangulimi. Për shkak të rëndësisë së triangulimit të gjetjeve nga burime të ndryshme në ushtrim, një komponent kryesor i analizës së të dhënave do të jetë prezantimi i analizave në fund të fazës së mbledhjes së të dhënave që do të përdoret për të vërtetuar gjetjet dhe për të zhvilluar përfundimet dhe rekomandimet në përgjigje ndaj pyetjeve të TOR. Triangulimi përfshin krahasimin e informacioneve nga burime të ndryshme, të mbledhura nga vlerësues të ndryshëm dhe të marra nga metoda të ndryshme.¹⁴ Në përputhje me parimin e vlerësimit të përqendruar në shfrytëzim, gjetjet dhe përfundimet fillestare do të ndahen me ZPS/ZKM dhe UNICEF-in dhe Institucionet e Kosovës në fund të fazës së mbledhjes së të dhënave për diskutim dhe nxjerrjen e reagimeve ose korrigjimin e fakteve.

Konsideratat dhe protokollet etike

Konsiderata Etike. Siç u përmend më herët, vlerësimi do të bëhet për të siguruar pajtueshmërinë me parimet etike dhe morale përmes aplikimit të Kodit të Sjelljes të UNEG për Vlerësimin dhe Udhëzimeve Etike për Vlerësim dhe procedurave të UNICEF-it për mbledhjen e të dhënave për kërkimin dhe studimet e vlerësimit.¹⁵ Këto kanë një rëndësi të veçantë në lidhje me vlerësimet duke përfshirë popullsitë e prekura dhe grupet e cenueshme.

Në rastin e vlerësimit të SKZH-së, procesi pritet të bazohet në dokumentacionin para-ekzistues dhe IIK me akterët e SKZH-së për të informuar rezultatet e SKZH-së. Nuk ka akterë potencialisht të prekshëm që ka të ngjarë të intervistohen, tani fëmijët për këtë SKZH. Meqenëse nuk ka fëmijë ose grupe të cenueshme të përfshira në mbledhjen e të dhënave të vlerësimit, vlerësimi nuk ka nevojë të kalojë përmes një rishikimi etik formal të Bordit të Rishikimit Institucional (IRB) si pjesë e procesit të hartimit. Sidoqoftë, vlerësimi do t'i përmbahet konsideratave etike që lidhen me sigurinë, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave në lidhje me trajtimin e tij ndaj pjesëmarrësve në procesin e vlerësimit.

Protokollet për sigurinë, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave. Parimet e **pëlqimit të informuar** dhe ruajtja e konfidencialitetit janë shtyllat kryesore të çdo ushtrimi të mbledhjes së të dhënave të vlerësimit. Në këtë rast, të intervistuarit do të informohen në fillim të intervistës në lidhje me qëllimin e vlerësimit, sigurimet për pjesëmarrje vullnetare dhe konfidencialitetin e të gjitha përgjigjeve.¹⁶ Të intervistuarit e mundshëm ka të ngjarë të kenë ngarkesë të madhe pune dhe ekipi i vlerësimit do të përdorë parimin e respektit reciprok duke siguruar që intervistat të jenë sa më koncize dhe sa më efikase të jetë e mundur. Përveç kërkesave standarde etike të çdo procesi të grumbullimit të të dhënave të vlerësimit, ky vlerësim i veçantë ka pesë faktorë shtesë me implikime etike në lidhje me parimin e "mos bërjes dëm" - si për ekipin e vlerësimit ashtu edhe për pjesëmarrësit në vlerësim.

Masat e mbrojtjes së të dhënave. Pasi të mblidhen të dhënat, masat për mbrojtjen e të dhënave do të përdoren për të siguruar konfidencialitetin e të anketuarve në të gjitha instrumentet e të dhënave. Të dhënave paraprake të monitorimit nga ato të disponueshme nga Qeveria e Kosovës ose UNICEF-i do t'u hiqen të dhënat personale para se të ndahen me ekipin e vlerësimit, edhe pse kjo nuk ka të ngjarë të jetë e nevojshme duke pasur parasysh natyrën strategjike të vlerësimit.

Për të dhënat cilësore, të gjitha shënimet e intervistës nga ekipi i vlerësimit mbahen në mënyrë elektronike në kompjuterët e koduar me fjalëkalim. Emrat personale dhe identifikuesit e tjerë të mundshëm personalë do të hiqen nga të dhënat para analizës. Analiza e të dhënave do të kryhet vetëm me anëtarët e ekipit të vlerësimit për të siguruar konfidencialitetin. Të dhënat e përpiluara në raportim do të grumbullohen në mënyrë që përgjigjet individuale nga IIK të mos gjurmohen në vende ose individë të veçantë. Informacionet sasiore dhe

¹⁴Shih ALNAP. Vlerësimi i Veprimit Humanitar: Udhëzues, ODI, 2013: 140 për përkufizimet e secilit lloj të triangulimit.

¹⁵ <https://www.unicef-irc.org/files/documents/d-4165-Final%20Procedure%20Ethical%20Standards%20Evidence%2004%202021.pdf>

¹⁶ Instrumenti i grumbullimit të të dhënave në Shtojcën 5 përshkruan më hollësisht pëlqimin e informuar dhe parimet e konfidencialitetit për ushtrimin e mbledhjes së të dhënave.

cilësore do të mbahen në kompjuterët e ekipit të vlerësimit vetëm deri në përfundimin e raportit, në të cilin kohë do të fshihen për të mbrojtur më tej individët nga identifikimi i mundshëm.

Bazuar në udhëzimet e Grupit të Vlerësimit të Kombeve të Bashkuara (UNEG) dhe bazuar në parimet e përshkruara në shënimin teknik të Treguesit të Performancës së Vlerësimit (EPI) të SWAP të OKB-së (prill 2018), qasja metodologjike do të integrojë më tej një lente barazie gjinore si pjesë e analizës së përgjithshme. Kjo përfshin adresimin e aspekteve thelbësore që lidhen me çështjet gjinore dhe të barazisë brenda aktiviteteve të shtyllës së kapitalit njerëzor të SKZH-së të përfshira në periudhën e vlerësimit.

Vlerësimet e të mësuarit dhe konflikti i interesit. Vlerësimi udhëhiqet nga një ekspert i pavarur ndërkombëtar. Anëtarë tjetër i ekipit të vlerësimit është një konsulent i pavarur i kontraktuar nga UNICEF-i. Ky nuk është një vlerësim i programimit të UNICEF -it, por përkundrazi ky vlerësim është porositur nga Zyra e Kryeministrit dhe është një shembull i një ushtrimi vlerësues të udhëhequr nga qeveria kombëtare. Si i tillë, ka shqetësime të kufizuara për konfliktin e interesit pasi që të dy anëtarët e ekipit vlerësues nuk janë të lidhur me Qeverinë e Kosovës ose SKZH-në.

Gjithashtu, edhe pse të gjitha vlerësimet përmbajnë elemente të llogaridhënies dhe të të nxënit, theksi relativ i këtyre dy dimensioneve do të informojë shkallën në të cilën akterët që mund të jenë pjesë e programit dhe strategjisë në shqyrtim duhet të marrin pjesë në proceset e vlerësimit. Konsideratat e konfliktit të interesit janë një pikë madhore e theksimit kur vlerësimet vënë theksin mbi aspektet e llogaridhënies. Në rastin e kësaj SKZH-je, ka një theks të fortë në aspektet e të nxënit, dhe kjo do të formësojë dizajnin dhe pjesëmarrjen e akterëve të brendshëm. Të nxënit arrihet më së miri kur më shumë akterë të brendshëm përfshihen në procesin e vlerësimit. Për këtë arsye, Menaxhmenti i Vlerësimit bashkëndahet ndërmjet ZPS/ZKM dhe UNICEF-it, dhe pritet që Grupi i Referencës të Vlerësimit të jetë i përbërë nga akterë të nivelit të lartë qeveritar për të siguruar nxënie të shtuar dhe zotërim të rezultateve të vlerësimit.

Kufizimet dhe rreziqet

Rreziqet e vlerësimit gjatë mbledhjes së të dhënave përgjithësisht përfshijnë katër faktorë të mundshëm: i) konsideratat e sigurisë, ii) paragjykimet e përgjigjeve (duke përfshirë paragjykimet gjinore), iii) qasjen, ose iv) kohën. Gjatë pandemisë, është shfaqur gjithashtu një konsideratë shtesë e kufizimeve dhe protokolleve të COVID-19. Në kohën e fazës fillestare, këto rreziqe u konsideruan relativisht minimale për mbledhjen e të dhënave, me përjashtim të kufizimeve të Covid-19. Këto kanë çuar në përdorimin e një metodologjie të intervistës në distancë dhe vlerësim virtual. Sidoqoftë, mund të ekzistojnë mundësi që ngjarjet me prani fizike të kryhen gjatë njëres ose të dyja punëtorive mësimore. Paragrafët e mëposhtëm rishikojnë secilin nga këto katër dimensionet për rrezikun.

Konsideratat e sigurisë. Nuk ka rreziqe specifike të sigurisë në Kosovë as për ekipin e vlerësimit, as për akterët e mundshëm të përfshirë në procesin e intervistës.

Zbutja: Nuk është e nevojshme. Megjithatë, meqenëse vlerësimi i porositur nga ZPS/ZKM, dhe UNICEF-i do të kryhet në mnëryre virtuale, çdo çështje e mundshme e rrezikut për ekipin e vlerësimit konsiderohet minimale.

Paragjykimi (anësia) i përgjigjeve: Duke pasur parasysh veçoritë dhe ndjeshmëritë e ngërthyera në kontekstin politik të Kosovës, ekziston mundësia që anëtarët e ekipit vlerësues të marrin informacione të njëanshme ose mund të mos jenë mjaftueshëm të vetëdijshëm për potencialet për paragjykim të përgjigjeve.

Zbutja: Një sërë masash janë integruar në qasjen metodologjike si reagim ndaj çështjeve të konsistencës dhe paragjyqimeve të mundshme. Së pari, përzgjedhja e akterëve që do të intervistohen do të përfshijë një përzgjedhje për të siguruar që zërat përkatës nga secili prej grupeve të akterëve të përfshihet në të dhënat. Së dyti, ekipi ka zhvilluar protokolle të standardizuara të intervistave të bazuara në pyetjet e vlerësimit për të siguruar që intervistat janë konsistente dhe mund të validohen lehtësisht. Protokollet do të sigurojnë që ndarja e gjinisë të integrohet në pyetjet për të anketuarit, por edhe në përzgjedhjen e të anketuarve dhe në analizën e përgjigjeve. Diversiteti do të merret parasysh në përzgjedhjen e të anketuarve dhe analizën e përgjigjeve.

Së fundi, vetë ekipi i vlerësimit përfaqëson një përzierje të kombësive, gjinive dhe ekspertizave. Anëtarë të ndryshëm të ekipit do të intervistojnë grupe të ndryshme të akterëve në mënyrë që të kufizojnë paragjykimet e mundshme të intervistuesit. Analiza e të dhënave do të bëhet në mënyrë kolektive për të siguruar vlerësime të trianguluara të përfundimeve dhe për të balancuar interpretimet ndërkombëtare dhe kombëtare të gjetjeve. Përdorimi i matricës së vlerësimit do të kërkojë më tej të balancojë interpretimet ndërkombëtare dhe kombëtare të gjetjeve.

Paragjykimi gjinor dhe integrimi gjinor. Rezultatet e ndjeshme gjinore të SKZH-së do të duhet të shkojnë përtej thjeshtë vlerësimit të pjesëmarrjes së vajzave dhe grave të ndikuara nga aktivitetet, por gjithashtu të kuptojnë shkallën e konsultimit dhe zërin në hartimin e procesit. Gjithashtu mund të ketë mundësi që përgjigjet të jenë të njëanshme në varësi të anëtarëve të ekipit të vlerësimit.

Zbutja: Për të zbutur paragjykimet e mundshme gjinore, përzgjedhja e akterëve që do të intervistohen do të përfshijë gjithmonë një gamë të grave dhe burrave për të siguruar që zërat përkatës të përfshihen në të dhëna. Aty ku është e mundur, anëtarët e ekipit do të intervistojnë grupe të ndryshme të akterëve në mënyrë që të kufizojnë paragjykimet e mundshme të intervistuesve ose ngurrimin e të anketuarve që pengon përgjigjet e femrave. Vlerësimi do të përqipet të zbatohet analizën e ndarë (disagreguar) në baza gjinore si të rëndësishme dhe të vlerësojë shkallën në të cilën nevojat, prioritetet dhe zërat e ndryshëm janë përfshirë në projektimin dhe zbatimin e SKZH-së. Barazia gjinore dhe etnike janë integruar në matricën e vlerësimit dhe më pas në udhëzuesin e intervistës për të kuptuar ndërhyrjet.

Pandemia e covid-19. Pandemia globale ende paraqet rreziqe jo vetëm për ekipin e vlerësimit, por edhe për akterët lokalë të përfshirë në intervistat e vlerësimit. Kufizimet globale të udhëtimit, mbyllja e kufijve dhe rregulloret e brendshme të distancimit shoqëror mund të parandalojnë ekipin e vlerësimit nga mundësia për të vizituar Kosovën ose nga kryerja e intervistave personale ose diskutimeve në fokus grupe me akterët.

Zbutja: SKZH-ja do të mbështetet kryesisht në një format vlerësimi virtual. Kjo shihet si e realizueshme për shkak të shkallës së lartë të depërtimit të internetit në mesin e akterëve të synuar dhe natyrës së pyetjeve të vlerësimit. Ndërrimet primare janë të bëhen të gjitha intervistat përmes thirrjeve Skype, WhatsApp, Zoom ose Cell Phone me akterët e synuar. Intervali i mbledhjes së të dhënave duhet të zgjerohet për të marrë parasysh ndërprerjet më të mundshme të intervistave. Sidoqoftë, cilësia e të dhënave ende pritet të jetë e lartë me këto rregullime. Analiza e të dhënave do të kryhet duke përdorur platformën Mural në internet, e cila lejon zhvillimin bashkëpunues në kohë reale të gjetjeve dhe përfundimeve nga pjesëmarrësit e shpërndarë në një hapësirë të vetme.

Sigurimi i Cilësisë

Cilësia e vlerësimit do të trajtohet në disa mënyra gjatë gjithë procesit. Së pari, përmes zbatimit të parimeve bazë GEROS në praktikën e tij; së dyti, përmes qasjeve që mbështesin besueshmërinë, konsistencën dhe saktësinë e të dhënave; dhe së treti përmes mbështetjes dhe mbikëqyrjes të ofruar nga KonTerra.

Sigurimi i cilësisë në vlerësim i referohet procesit me të cilin standardet e vlerësimit do të respektohen. Në këtë rast, UNICEF-i përdor sistemin e rishikimit GEROS. Ky vlerësim nuk është një vlerësim i UNICEF-it dhe si i tillë nuk do të kalojë përmes rishikimit formal të GEROS, por vlerësimi do të ndjekë parimet e cilësisë të përshkruara në GEROS dhe vlerësimi do të kalojë përmes një rishikimi të jashtëm për qëllime mësimore me ZPS/ZKM.

Aplikimi i GEROS. EV do të krijojë një listë kontrolluese që përdor standardet kryesore të UNEG/UNICEF (2010) dhe GEROS (2013) për secilin raport të prodhuar (p.sh. raporti fillestar, raporti draft/përfundimtar, prezantimi i sintezës). Për shembull, lista kontrolluese ndihmon në sigurimin se raporti:

- Specifikon mbledhjen e të dhënave, analizën dhe metodat e marrjes së mostrave.
- Specifikon burimet e të dhënave, arsyetimin e tyre për përzgjedhjen dhe kufizimet e tyre
- Përshkruan garancitë etike të ndërmarra për të siguruar konfidencialitetin, mbrojtjen e të drejtave të akterëve/pjesëmarrësve, duke siguruar pëlqimin e informuar, duke siguruar informata kthyesë për pjesëmarrësit dhe duke formësuar/kontrolluar sjelljen e vlerësuesve.

- Përfshin në masën e mundshme një qasje për të drejtat e njeriut, barazinë dhe drejtësinë gjinore në qasjen, analizën dhe gjetjet e të dhënave.
- Përkrahet në mënyrë adekuate fushëveprimin dhe shkallën e konsultimit me akterët
- Përkrahet në mënyrë adekuate kufizimet e EV dhe mënyrën e menaxhimit të tyre
- Paraqet qartë gjetjet dhe bazuar në dëshmitë e ofruara; kjo gjithashtu duhet të përfshijë një diskutim të gjetjeve të papritura
- Adreson të gjitha pyetjet kryesore në TeR

Aktivite për të siguruar besueshmërinë, konsistencën dhe saktësinë e të dhënave. Metodologjia siç përshkruhet në Seksionin 4.3 është krijuar për të mbështetur besueshmërinë e të dhënave përmes metodave të përziera, angazhimit të ndryshëm të akterëve dhe triangulimit, duke përfshirë sa vijon:

- Marrjen e informacioneve nga një gamë e larmishme e akterëve për të rritur saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave.
- Sigurimin që akterët janë përkatës dhe përfaqësojnë informatorët kryesorë të vërtetë.
- Sigurimin se udhëzuesi i intervistës përqendrohet në fushat e pritshme të ekspertizës së të intervistuarve dhe në cilësinë e parashtrimit të pyetjeve në udhëzuesin e intervistave me informatorët kyç (për shembull, sigurimin që pyetjet nuk janë udhëheqëse, supozimet janë eksplicite, paragjykimet e kërkimit zbuten, etj.).

Gjithashtu, cilësia e analizës së të dhënave do të mbështetet përmes triangulimit të rezultateve nga burime të shumëfishta të të dhënave (rishikimi i dokumenteve, intervistat me informatorët kyç të ndara sipas llojit të akterëve, anketa e studimit gjurmues (përcjellës) të të rinjve dhe mbledhja e të dhënave parësore përmes vizitave në terren)

Mbikëqyrja dhe ekspertiza e KonTerra. Drejtori i vlerësimit dhe të nxënit organizativ të KonTerra, Menno Wiebe, merr përgjegjësinë kryesore për sigurimin e cilësisë së kontratës. Ai do të ketë përgjegjësinë për mbajtjen e një marrëdhënieje pune efektive me drejtuesin e ekipit të vlerësimit dhe anëtarët e tjerë të ekipit. Belén Diaz, anëtare e ekipit KonTerra dhe specialiste e sigurimit të cilësisë, gjithashtu do të ofrojë mbështetje si një burim i pavarur. Drejtori dhe specialisti i sigurimit të cilësisë do të sigurojnë një rishikim të pavarur të të gjitha produkteve të prodhuara gjatë rrjedhës së kontratës. KonTerra është përfundimisht përgjegjëse për cilësinë e produkteve të vlerësimit dhe do të sigurojë cilësinë e të dhënave (vlefshmërinë, konsistencën dhe saktësinë) gjatë gjithë kohës. KonTerra do të bëjë ndryshimet e nevojshme me shpenzimet e tyre, për të sjellë produktet e vlerësimit në nivelin e kërkuar të cilësisë në rast të mosplotësimit të ndonjë standardi nga ekipi i vlerësimit.

Grupi Referencë i Vlerësimit (GRV). Grupi Referencë i Vlerësimit (GRV) është gjithmonë i integruar në një proces vlerësimi që shërben për të siguruar mbikëqyrje të procesit të vlerësimit dhe ratifikimin e rezultateve të vlerësimit. Vlerësimi i SKZH-së do të ketë një GRV, por përbërja e saktë nuk është finalizuar ende në kohën e fazës fillestare. Ai do të përbëhet nga akterët kryesor nga Qeveria e Kosovës, UNICEF-i dhe akterë të tjerë, që do të shërbejnë si komiteti drejtues parësor i mbikëqyrjes për procesin e përgjithshëm të vlerësimit. Aktualisht, qëllimi është që grupi referues të rishikojë dhe komentojë produktin përfundimtar të vlerësimit dhe të përfshihet në shtjellimin e përgjigjes së menaxhmentit. Grupi referues mund të jetë gjithashtu një audiencë për prezantimin e raportimit dalës të kryer në fund të fazës së mbledhjes së të dhënave (e parashikuar afër mesit të qershorit) për të paraqitur gjetjet dhe konstatimet paraprake. GRV-ja do të përbëhet nga 8-12 anëtarë në varësi të disponueshmërisë dhe të udhëhiqet nga një përfaqësues brenda Zyrës së Kryeministrit ose nivel të ngjashëm. Përbërja përfundimtare e GRV-së është në diskrecionin e ZPS/ZKM. EM i UNICEF-it do të koordinohet gjatë gjithë procesit të vlerësimit me akterët përkatës dhe do të shërbejë si lidhja kryesore e komunikimit midis EV-së dhe GRV-së.

Përbërja e Ekipit dhe Rolet Parësore

| Anëtarët e Ekipit | Roli Parësor | Detyra të veçanta në kuadër të vlerësimit | Produktet |
|-------------------|-----------------|--|--|
| Terrence Jantzi | Udhëheqës ekipi | <ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i qasjes dhe metodologjisë së vlerësimit, duke përfshirë instrumentet për mbledhjen e të dhënave. • Sigurimi që vlerësimi të përfshijë analizën gjinore në hartimin e tij dhe | Draft pakoja fillestare Finalizimi i pakos fillestare Udhëheq mbledhjen e të dhënave të vlerësimit |

| | | | |
|--|---------------------------|--|---|
| | | <p>që anëtarët e ekipit të jenë të përgatitur për ta zbatuar atë gjatë gjithë vlerësimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Koordinimi i procesit të vlerësimit dhe udhëheqja e ekipit - sigurimi që aktivitetet e anëtarëve të ekipit të jenë të koordinuara siç duhet dhe që anëtarët e ekipit të jenë në gjendje të kontribuojnë në mbledhjen e të dhënave, analizën dhe zhvillimin e konstatimeve. • Përfaqësimi i ekipit në takime • Mbikëqyrja e mbledhjes dhe analizës së të dhënave në terren dhe dokumenteve (intervista, takime të grupeve të diskutimit, fokus grupe, literatura) • Udhëheqja e procesit për hartimin dhe rishikimin e pakos fillestare, prezantimi i informatave kthyesë dhe raportet e draftit dhe vlerësimit përfundimtar në përputhje me standardet e përcaktuara • Udhëheqja e analizës së të dhënave • Paraqitja e gjetjeve paraprake për akterët kryesorë nga grupi referues i vlerësimit. • Dhënia e informatave kthyesë sipas nevojës për procesin e vlerësimit | <p>Udhëheq ushtrimet e analizës së të dhënave me ekipin e vlerësimit-maj-qershor</p> <p>Udhëheq raportimin dalës - Draft Raporti i Vlerësimit Raporti Përfundimtar i Vlerësimit</p> |
| Fiona Kelmendi | Anëtare e ekipit kombëtar | <ul style="list-style-type: none"> • Kryerja e rishikimit të dokumenteve në zyrë • Kontributi në procesin e fillimit • Kontributi në hartimin e metodologjisë dhe zhvillimin e instrumenteve, duke u fokusuar në fushat e specializimit • Sigurimi që çështjet gjinore të adresohen në fushat e mbuluara • Kryerja e punës në terren dhe pjesëmarrja në takime me ekipin e vlerësimit dhe akterët • Kontributi në hartimin/rishikimin e produkteve të vlerësimit: pakoja fillestare, prezantimi i informatave kthyesë, raporti(et) e vlerësimit. • Pjesëmarrja dhe kontributi në punëtorinë e analizës së të dhënave • Dhënia e informatave kthyesë sipas nevojës për procesin e vlerësimit. • Pjesëmarrja në punëtoritë mësimore | <p>Kryerja e rishikimit të dokumenteve në zyrë.</p> <p>Ndërlidhja me udhëheqësin e ekipit për logjistikën dhe identifikimin e akterëve.</p> <p>Kontributi në Pakon fillestare</p> <p>Dhënia e informatave kthyesë për përfundimin e Pakos fillestare.</p> <p>Pjesëmarrja si specialist i politikave në Kosovë në mbledhjen e të dhënave të vlerësimit.</p> <p>Pjesëmarrja në analizën e të dhënave.</p> <p>Pjesëmarrja në prezantimin e raportimit dalës (përfundimtar)</p> <p>Kontributi në hartimin e Raportit të vlerësimit</p> <p>Dhënia e informatave kthyesë për raportin përfundimtar të vlerësimit.</p> <p>Pjesëmarrja në punëtoritë mësimore</p> |
| Donjeta Jashari Vesa Ferizi Flamur Jashari | Vullnetarë të rinj | <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja në shqyrtimin e dokumenteve. • Pjesëmarrja në intervista dhe takime me ekipin e vlerësimit dhe akterët. • Kontributi në identifikimin e gjetjeve, analizën e të dhënave, raportet e vlerësimit dhe prezantimet. | <p>Kryerja e shqyrtimit të dokumenteve.</p> <p>Pjesëmarrja si vullnetarë të rinj të Kosovës në mbledhjen e të dhënave të vlerësimit.</p> <p>Pjesëmarrja në ushtrimet e analizës së të dhënave.</p> <p>Pjesëmarrja në Prezantimet e raportimit përfundimtar</p> |

| | | | |
|--|--|--|--|
| <p>Adnit Kamberi</p> <p>Elena Morina</p> <p>Arta Rexhepi</p> | | <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja në punëtori mësimore sa është e mundur | <p>Kontributi në hartimin e Raportit të Vlerësimit.</p> <p>Dhënia e informatave kthyesë për raportin përfundimtar të vlerësimit.</p> <p>Pjesëmarrja në punëtoritë mësimore</p> |
|--|--|--|--|

Shtojca 7: Mjetet për grumbullimin e të dhënave

7.1 Udhëzuesi i intervistës me informatorë kyç

Udhëzuesi i IIK-së për intervista gjysmë të strukturuar

Ky seksion paraqet parimet që do të udhëheqin ekipin e vlerësimit në përzgjedhjen e pjesëmarrësve Informatorë Kyç (IIK) dhe kryerjen e intervistave të IIK-së. Ekipi i vlerësimit do të kryejë IIK-të me pjesëmarrësit e përzgjedhur për njohuritë e tyre të dorës së parë për SKZH-në dhe programimin e saj.

Ky udhëzues është krijuar për të qenë një udhëzues për intervistat "gjysmë të strukturuar". Udhëzuesi për intervistat gjysmë të strukturuar është ai që ka për qëllim të sigurojë disa udhëzime për një bisedë, por me fleksibilitetin për t'u modifikuar sipas nevojës. Si udhëzues gjysmë i strukturuar, lehtësuesit mund të angazhohen në hetime teksa shfaqen tema dhe lehtësuesit duhet të kenë lirinë të ndjekin temat emergjente që kanë të bëjnë me matricën e përgjithshme të vlerësimit dhe objektivat e vlerësimit. Është e rëndësishme të theksohet se jo të gjitha pyetjet do të konsiderohen të rëndësishme për të gjitha grupet e akterëve. Kështu, intervistuesi duhet t'i ri formulojë pyetjet sipas gjykimit të tij për t'i bërë ato të përshtatshme për audiencën e tyre.

Është zhvilluar një udhëzues i vetëm. Numrat në kllapa duhet të tregojnë lidhjen midis secilës pyetje intervistimi të udhëzuesit dhe temave përkatëse në matricën e vlerësimit. Të gjitha shënimet regjistrohen në një matricë përgjigjesh dhe të gjitha përgjigjet për një temë të veçantë të matricës së vlerësimit do të analizohen në kombinim në fund të fazës së terrenit për të përcaktuar temat dhe modelet emergjente nëpër përgjigje.

Çdo seksion mbulon një segment të ndryshëm të TeR dhe Matricës së Vlerësimit. Intervistuesi duhet të mbulojë një segment vetëm nëse i anketuari ka përvojë ose njohuri të mjaftueshme për të adresuar segmentin.

Intervistuesi duhet të parashikojë mesatarisht 1 orë për secilën intervistë të IIK. **Jo të gjitha pyetjet mund të bëhen në të gjitha intervistat**, prandaj, është e rëndësishme t'i jepet përparësi se cilat seksione janë më të pasura me informacione me grupe të veçanta akterësh.

Intervistuesi duhet të prezantohet dhe të qartësojë qëllimin e vlerësimit, si dhe konfidencialitetin e intervistës (p.sh. kur citohen IK-të, atribumi do t'i bëhet kategorive të akterëve, jo individëve ose organizatave)

Udhëzime të Përgjithshme për IIK-të

Themelimi i raportit. Filloni me një shpjegim të qëllimit të intervistës, përdorimit të synuar të informacioneve dhe garancive të konfidencialitetit (Shih hyrjen më poshtë). Përveç gjatë intervistimit të ekspertëve teknikë, pyetësit duhet të shmangin zhargonin.

Formuloni pyetjet me kujdes për të nxjerrë informacion të detajuar. Shmangni pyetjet që mund të përgjigjen me një po ose jo të thjeshtë. Për shembull, pyetje të tilla si "Ju lutem më tregoni për aktivitetet e programeve rinore?" janë më të mira se "A keni njohuri për aktivitetet e programit rinor?"

Përdorni teknikat e hetimit. Inkurajoni informatorët të detajojnë bazën për përfundimet dhe rekomandimet e tyre. Për shembull, komenti i një informatori, si "Programi i të rinjve vërtet i ka ndryshuar gjërat këtu", mund të hetohet për më shumë detaje, të tilla si "Çfarë ndryshimesh keni vënë re?" "Kush duket se ka përfituar më shumë?" "A mund të më jepni disa shembuj specifik?"

Mbani një qëndrim neutral. Intervistuesit duhet të jenë dëgjues të kuptueshëm dhe të shmangin përshtypjen e të pasurit pikëpamje të forta mbi temën në diskutim. Asnjënjësia është thelbësore sepse disa informatorë, duke u përpjekur të jenë të sjellshëm, do të thonë atë që ata mendojnë se intervistuesi dëshiron të dëgjojë.

Minimizoni vështirësitë e përkthimit. Ndonjëherë është e nevojshme të përdoret një përkthyes, gjë që mund të ndryshojë dinamikën dhe të shtojë vështirësi. Për shembull, ndryshimet në status midis përkthyesit dhe informatorit mund të pengojnë bisedën. Shpesh informacioni humbet gjatë përkthimit. Vështirësitë mund të minimizohen duke përdorur përkthyes që nuk janë të njohur për informatorët, duke informuar përkthyesit për qëllimet e studimit për të zvogëluar keqkuptimet dhe duke i bërë përkthyesit të përsërisin komentet e informatorit fjalë për fjalë.

Mblidhni dokumente shtesë. Gjatë intervistës, informatori kryesor mund t'i referohet dokumenteve. Kërkoni kopje mundësisht në formë digjitale, por nëse nuk janë të disponueshme atëherë kopje fizike. Kjo mund të ndihmojë në plotësimin e boshllëqeve dhe shtimin e dokumenteve ekzistuese.

Falënderoni informatorin kryesor. Falënderoni informatorin kryesor për kohën e dhënë për intervistë dhe informacionin e dhënë. Sugjeroni që nëse është e pranueshme, mund t'ju duhet t'i kontaktoni përsëri për të konfirmuar deklaratat ose për të kërkuar më shumë informacione.

Konsiderata etike dhe të sigurisë

Kryerja e punës së kësaj natyre kërkon standarde të larta etike për të siguruar që pritjet nuk rriten, ruhet konfidencialiteti dhe të anketuarit trajtohen me dinjitet dhe respekt, dhe kurrë nuk detyrohen të marrin pjesë ose inkurajohen të flasin për tema që mund të jenë traumatizuese ose mund t'i vënë ata në rrezik. Kjo nënkupton:

- **Respekt dhe dinjitet:** Informatorët kryesorë kuptojnë qëllimin e ushtrimit, llojet dhe përdorimin e synuar të të dhënave që do të mblidhen. Ata sigurohen se nuk do të ketë pasoja nëse ata zgjedhin të mos marrin pjesë.
- **Konfidencialiteti:** Informatorët kryesorë janë të vetëdijshëm se çdo referencë do të jetë e përgjithshme për ta bërë të pamundur gjurmimin e informacionit në burimin e tij individual. Sidoqoftë, informacioni i dhënë gjatë intervistës do të regjistrohet dhe përdoret për qëllime të vlerësimit.
- **Siguria:** Vendndodhja dhe koha janë vendimtare. Diskutimi mbahet në një vend privat, jo kërcënues dhe lehtësisht të arritshëm dhe të sigurt, dhe në një kohë që është e përshtatshme për nevojat dhe orarin e informatorit kryesor.

Prezantimi në Intervistën IIK

Ne jemi një ekip vlerësues i porositur nga Zyra e Planifikimit Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit me mbështetjen e UNICEF-it për të kryer një rishikim të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim të Kosovës (2016-2021) për Shtyllën e Kapitalit Njerëzor të SKZH-së. Qëllimi i këtij ushtrimi është të vlerësojë progresin, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet për ciklin e ardhshëm të SKZH-së në Kosovë. Ne po ju kërkojmë të merrni pjesë në rishikim sepse jeni në gjendje të kontribuoni me një perspektivë të rëndësishme dhe të vlefshme mbi funksionimin e SKZH-së deri më tani dhe lidhjet e saj me sistemet qeveritare. Nëse vendosni të merrni pjesë, intervista ka të ngjarë të zgjasë për rreth 1 orë.

Pjesëmarrja është vullnetare: Pjesëmarrja juaj në intervistë është vullnetare. Ju mund të tërhiqeni nga intervista pasi ajo të ketë filluar, për çfarëdo arsyeje, pa asnjë ndëshkim. Pjesëmarrja ose mos pjesëmarrja në intervistë nuk do të ndikojë në përfitimet e organizatave ose komuniteteve nga SKZH-ja, ZPS-ja ose UNICEF-i.

Rreziqet dhe përfitimet: Ky rishikim është krijuar për të ndihmuar në përmirësimin e programit duke mësuar nga perspektiva e të gjithë personave të përfshirë. Ju nuk mund të përfitoni personalisht nga të qenit në këtë rishikim kërkimor. Mund të ketë rreziqe të pazakonta ose të panjohura më parë. Ju duhet të raportoni çdo problem tek [_____].

Konfidencialiteti: Raportet nga ky dhe takime të tjera do të mbledhin dhe përmbledhin pikëpamjet dhe opinionet e pjesëmarrësve pa i lidhur ato me individë të veçantë dhe pa përdorur emra asnjëherë. Çdo raport i këtij hulumtimi do të prezantohet në atë mënyrë që e bën sa më të vështirë për këdo që të përcaktojë identitetin e individëve që marrin pjesë në rishikim.

Gjithashtu, për të siguruar që të gjitha reagimet tuaja janë të transkriptuara siç duhet dhe kështu ekipi ynë i vlerësimit të sigurohet që të mos keqinterpretojë atë që po ndani, do të doja të kërkoja lejen tuaj për të incizuar zërin e këtij diskutimi. Ky incizim i zërit nuk do të ndahet me askënd tjetër përveç anëtarëve të ekipit të vlerësimit, të cilët marrin përsipër të mbajnë të fshehtë çdo koment.

Nëse keni ndonjë pyetje, tani ose në çdo kohë në të ardhmen, mund të telefononi _____

A jeni gati të jeni pjesë e këtij diskutimi? (kërkohet vetëm përgjigje verbale)

I anketuari: _____

Titulli dhe funksioni: _____

Emri i intervistuesit: _____

Data: _____

Vendndodhja: _____

SHËNIM: Janë 14 pyetje kryesore (me ngjyrë blu) dhe të shoqëruara me një sërë pyetjesh shtesë. Pyetjet me ngjyrë blu duhet të kenë përparësi së pari në intervista, ku të tjerat përfshihen në varësi të kohës.

| Pyetjet dhe nënpyetjet për vlerësim | Pyetjet e intervistës ¹⁷ |
|--|--|
| 0.0 TË PËRGJITHSHME Pyetje hyrëse-Cilat kanë qenë rezultatet, sukseset, sfidat më të theksuara në hartimin dhe zbatimin e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH 2016-2021? | |
| 0.1 Roli dhe lidhja | 1. Cila është pozita juaj aktuale dhe në çfarë mënyrash keni ndërvepruar me shtyllën e kapitalit njerëzor të SKZH-së në hartimin ose masat e saj? 2. |
| 0.2 Rezultatet | 3. Duke u kthyer pas në vitet 2015 dhe 2016 kur filloi kjo fazë e SKZH-së. Çfarë ndryshimesh keni parë në situatën e kapitalit njerëzor në Kosovë si rezultat i masave dhe prioritetëve të SKZH? |
| 0.3 Ndryshimet | 4. Cilat kanë qenë disa nga ndryshimet kryesore në zbatimin e SKZH-së dhe mënyrën e punës që nga fillimi i ciklit (që nga viti 2016)? |
| 0.4 Pikat e forta dhe të dobëta | 5. Çfarë shihni në SKZH që ka qenë veçanërisht e dobishme për këtë cikël? 6. Çfarë shihni si sfida të veçanta për SKZH-në në këtë cikël? |
| RËNDËSIA - Për të vlerësuar harmonizimin e SKZH-së me nevojat ekzistuese të Kosovës duke përfshirë strategjitë, politikat dhe ndryshimet në kushtet. | |
| 1.1 Harmonizimi i nevojave | 7. Deri në çfarë mase është harmonizuar SKZH-ja (2016-2021) në tërësi me nevojat e Kosovës, duke përfshirë barazinë ekonomike dhe kushtet e kapaciteteve sociale që SKZH kërkon të adresojë? 8. Deri në çfarë mase janë kryer konsultimet e akterëve në hartimin e SKZH-së për të identifikuar boshllëqet dhe barrierat? |

¹⁷Jo të gjitha pyetjet mund të bëhen në të gjitha intervistat. Seksione të ndryshme do të duhet të kenë përparësi nga akterë të ndryshëm. Pyetjet e koduara blu duhet të kenë përparësi në çdo seksion

| | |
|---|--|
| | <p>9. Deri në çfarë mase shihni që SKZH-ja ka përfshirë çështjet e barazisë ekonomike dhe sociale në masat dhe prioritetet për kapitalin njerëzor?</p> <p>10. Në përvojën tuaj, çfarë shihni si përparësi parësore krahasuese të SKZH-së për mbështetjen e zhvillimit të kapitalit njerëzor në Kosovë?</p> |
| 1.2 Bazuar në dëshmi | <p>11. Deri në çfarë mase janë informuar me dëshmi masat e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së (2016-2021)?</p> <p>12. Sa i keni parë rishikimet dhe analizat strategjike të nevojave të Kosovës të përdoren për informimin e dizajnit të SKZH-së?</p> <p>13. Deri në çfarë mase dhe cilësie, janë përdorur të dhënat sasiore dhe të dhënat makro-treguese për të informuar strukturën e shtyllës së kapitalit njerëzor të SKZH-së?</p> <p>14. Deri në çfarë mase janë përdorur mësimet e nxjerra ose reflektimet për të informuar hartimin dhe përshtatjet e SKZH-së?</p> |
| 1.3 Përshtatja dhe pozicionimi | <p>15. Deri në çfarë mase Shtylla e Kapitalit Njerëzor e SKZH-së (2016-2021) është përshtatur me prioritetet evoluese?</p> <p>16. Deri në çfarë mase e keni parë procesin e SKZH-së të porosisë ose të bazohet mbi një vlerësim të ri për të marrë parasysh ndryshimin e kontekstit?</p> <p>17. Deri në çfarë mase e keni parë procesin e SKZH-së të mbështetet në dëshmi për të informuar përshtatjet ose rregullimet gjatë zbatimit aktual të aktiviteteve ose rregullimeve në udhërrëfyes?</p> |
| 3.0 EFEKTIVITETI¹⁸ - vlerësimi i shtrirjes së zbatimit të aktiviteteve dhe ndërhyrjeve të SKZH-së.¹⁹ | |
| 3.1 Arritjet e Objektivave dhe Synimeve | <p>18. Deri në çfarë mase janë arritur masat e Shtyllës së Kapitalit Njerëzor të SKZH-së kundrejt objektivave dhe synimeve të përcaktuara?</p> <p>19. Sa efektive ka qenë SKZH-ja si nxitëse për financimin e aktiviteteve të ndryshme? A ka shërbyer prania e SKZH-së si një efekt katalitik për rritjen e fondeve nga donatorët apo burime të tjera?</p> <p>20. Cilët kanë qenë disa faktorë të brendshëm ose të jashtëm të cilët mund të kenë ndikuar në arritjen e aktiviteteve dhe objektivave?</p> <p>21. Sa mendoni se kanë ndikuar faktorët politikë, ekonomikë ose të sigurisë në zbatimin e SKZH-së?</p> <p>22. Cilat lloje të masave zbutëse janë kryer gjatë gjithë periudhës së zbatimit për të adresuar këta faktorë?</p> <p>23. Në kuadër të shtyllës së kapitalit njerëzor të SKZH-së, janë promovuar lloje të ndryshme aktiviteteve. Cilën nga këto shihni se është aktiviteti më efektiv dhe i qëndrueshëm? Pse?</p> |
| 3.2 Korniza e monitorimit | <p>24. Deri në çfarë mase është hartuar korniza e monitorimit për të informuar monitorimin sistematik dhe zbatimin e SKZH-së?</p> <p>25. Sa i lehtë apo i vështirë ka qenë për procesin e monitorimit të raportojë mbi arritjet në nivel aktiviteti?</p> <p>26. Cilat sfida kanë ekzistuar për monitorimin sistematik të aktiviteteve dhe masave?</p> <p>27. A mendoni se monitorimi i aktiviteteve të SKZH-së kanë çuar në përshtatje në udhërrëfyesin e SKZH-së?</p> <p>28. Sa i përket aktiviteteve të monitorimit, cilat aktivitete monitorohen më lehtë? Dhe pse?</p> |

¹⁸Gjatë parashtrimit të pyetjeve të vlerësimit, është mirë të filloni me diskutimet e ndryshimeve dhe efektivitetin para se të kaloni në zbatim. Prandaj, për dimensionet pyetjet bëhen jashtë rendit nga Matrica e Vlerësimit, por numërimi mbahet në përputhje me numërimin e matricës.

¹⁹Efektiviteti si parim i OECD -së zakonisht përqendrohet në kontributin e aktiviteteve dhe ndërhyrjeve në rezultatet e menjëhershme. Në kontekstin e këtij vlerësimi, kjo interpretohet si efektiviteti i procesit të zbatimit të SKZH.

| | |
|--|---|
| 3.3 Integrimi gjinor | <p>29. Si është bërë integrimi gjinor në Shtyllën e Kapitalit Njerëzor të SKZH -së?</p> <p>30. Çfarë shembujsh mund të citoni se si integrimi gjinor çoi në rregullime në aktivitetet e SKZH-së gjatë zbatimit?</p> <p>31. Çfarë përshtatjesh mund të bëhen për të përmirësuar integrimin gjinor?</p> |
| 2.0 EFIKASITETI – Për të vlerësuar efektivitetin e kostos dhe efikasitetin operacional të SKZH-së. ²⁰²¹ | |
